



**ME EMRIN E ALL'LLAHUT,
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

DRITA E KUR'ANIT

REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

TIRANË, 2011

Drejtör: prof. Muhammed Reza Haj Kheizr

REDAKSIA:

Prof. dr. Bedri BYLYKU

H. Jetmir ÇELA (*sekretar i redaksisë*)

Prof. dr. Feti MEHDIU

H. Vullnet MERJA (*zëvendëskryeredaktor*)

H. Sulejman efendi REXHEPI

H. Selim STAF

Prof. dr. Hajri SHEHU (*kryeredaktor*)

Redaktore: Liseda RAMAJ

Përkthyes të përmblendhjeve: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA
Radhitja në kompjuter: Liseda RAMAJ

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

©: Fondacioni i Kur'anit 5 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

Del katër herë në vit

FOUNDATION OF QUR'AN
ALBANIA

THE LIGHT OF QUR'AN

QUARTERLY SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC
RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2011

PASQYRA E LËNDËS

Jasin T. AL Xhibouri: Kur’ani, mrekullia më e madhe	9
Kur’ani është libër unikal	21
Abduldaem Al - Kahiil: Argumente shkencore madhështore në historinë e profetit Nuh	31
Dr. M. Nurbaki: Ekuilibri delikat i jetës në Tokë	38
Prof. Hani El-Mubarek , Dr. Sheuki Ebu Halil: Astronomia	43
Dr. Hussein Riduan Al-Lubaidy: Ndërtimi i trurit në dritën e Kur’anit fisnik	50
Të reja shkencore	59
Muhsin Kara’ati: Drejtësia sociale në Islam	70
Prof. dr. Arqile Boti: Muaji i begative, muaji i shëndetit	77
Shiu i mëshirës	81
Vullnet Merja: Fjalor Kur’anor enciklopedik	94
Prof.dr. Hajri Shehu: Haxh, 2010	104
Aktivitete	117
Përmbledhje në gjuhën angleze	123
Përmbledhje në gjuhën arabe	128

TABLE OF CONTENTS

Jasin T. AL Xhibouri: Qur'an, the Greatest Miracle	9
Qur'an is a Unique Book	21
Abduldaem Al - Kahiil: Magnificent Scientific Arguments in the History of Prophet Noah	31
Dr. M. Nurbaki: Delicate Equilibrium of Life on Earth	38
Prof. Hani El-Mubarek , Dr. Sheuki Ebu Halil: Astronomy	43
Dr. Hussein Riduan Al-Lubaidy: The Structure of the Brain According to the Noble Qur'an	50
Scientific News	59
Muhsin Kara'ati: Social Justice in Islam	70
Prof. dr. Arqile Boti: The Month of Blessings, the Month of Health	77
The Rain of Mercy and Compassion	81
Vullnet Merja: Encyclopedic Qur'anic Dictionary	94
Prof.dr. Hajri Shehu: Hajj, 2010	104
Activities	117
Summaries in English	123
Summaries in Arabic	128

فهرس الموضوعات

9	القرآن أعظم معجزة	ياسين ت. الجبوري
21	القرآن الكريم هو كتاب فريد من نوعه	
31	أدلة علمية رائعة في قصة النبي نوح	عبدالدائم الكحيل
38	التوازن الدقيق للحياة على الأرض	الدكتور م. نورباقي
43	علم الفلك	أ. هاني المبارك و د. شوقي أبو خليل
50	بناء الدماغ في ضوء القرآن الكريم	د. حسين رضوان اللبيدي
59	مستجدات علمية	
70	العدالة الإجتماعية في القرآن	محسن قراءتي
77	شهر البركة - شهر الصحة	أ. د. أرُكَّله بوتّي
81	أمطار الرحمة	www.albanian.irib.ir
94	قاموس موسوعي قرآني	الشيخ فُلنُتْ (عباس) مَربَا
104	حج 2010	أ. د. خيرِي شَهو
117	نشاطات علمية قرآنية	
123	ملخص باللغة الإنكليزية	
128	ملخص باللغة العربية	

Kur'ani, mrekullia më e madhe

Abstrakt

Shumica e dijetarëve myslimanë kanë pikëpamjen se Kur'ani i Shenjtë, në tërësinë e tij, në urdhrat dhe rregullat që ai përmban, në renditjen dhe organizimin e tij, në urtësinë, elokuencën dhe qartësinë e tij, në Sheriatin që përmban, në njoftimet për të padukshmen dhe në konsideratat e tjera është, me të vërtetë, një mrekulli, që njerëzimi nuk mund t'i bëjë një të ngjashme. Ka shumë prova dhe aspekte të natyrës mrekullore të Kur'anit të Shenjtë, të mishëruara në vetë Librin. Një aspekt i tillë mrekullor është logjika dhe elokuenca e tij. Ai flet për të padukshmen, mrekullinë ligjore, mrekullitë shkencore në format e tyre të shumëllojshme - mjekësore, kozmike, gjeografike, fizike, numerike, informative dhe shumë të tjera.

Gjuhësisht, “mrekullia” është pamundësi, paaftësi, ose paimitueshmëri. Ai që është i aftë të bëjë diçka të cilën askush tjetër nuk mund ta bëjë, është ai që e bën mrekullinë. Askush tjetër përveç Allahut të Plotfuqishëm nuk mund ta bëjë atë. Ai, dhe vetëm Ai, është Ai i cili urdhëron, që shfaq fuqinë mbi të tjerët dhe mbi të tjerat, përfshirë, sigurisht, dukuritë natyrore dhe gjithë universin. Atëherë, mrekullia, është diçka të cilët të tjerët e konsiderojnë si të jashtëzakonshme dhe që nuk mund ta duplikojnë ose ta imitojnë. Mrekullia është diçka që sfidon atë që tashmë është bërë, që provon atë që është tej së zakonshmes e duke thyer rregullat e normalitetit.

Mendoni për mrekullitë e *israsë* (udhëtimi brenda një nate nga Meka në Jerusalem) dhe për *miraxhin* (ngjitje në qiell) ato janë një nga mrekullitë më të famshme të cilat qenë vetëm për Profetin Muhamed, duke u bërë i vetmi njeri që u ngrit kaq lart. Edhe kryemeleku Xhibril, kur arriti te loti më i largët (*Sidretul Munteba*), nuk mund të shkonte më tej, kur i tha Profeti Muhamed.



“Po të shkoj më tej, - tha ai, - unë digjem (*abhtarik*); po të shkosh ti më tej, do të mund të depërtosh (*takehtarik*) aty ku nuk ka shkuar askush tjetër ndonjëherë”. Drita e të Gjithëfuqishmit, që qoftë i Madhëruar, ishte aq e fuqishme në atë vend sa edhe më i madhi i melekëve të tij, Xhibrili, nuk mund ta përballonte atë. Si mund ta përshkonte i Dërguari i Allahut, krejt vetëm dhe vetëm për një pjesë të natës, largësinë e madhe nga Meka në Jerusalem pa asnjë mjet transporti? Për më tepër, si mund t’i përshkonte qiejt dhe të shkonte trupërisht nëpër të gjitha ato pengesa dhe distanca nga toka pa aeroplan, anije kozmike ose raketë? Dhe më tej, si mundet që i Dërguari ta përshkruajë me hollësitë më të imëta gjithçka që ai pa në shtatë qiejt në një natë të vetme: vëzhgimet e tij dhe vendet ku mbërriti? A ka ndonjë njeri që mund ta përgënjeshtrojë përshkrimin e tij, ose t’i kundërshtojë thëniet e tij, ose ta falsifikojë çfarë ai solli?

Sot, edhe anijet kozmike në distanca relativisht të kufizuara në krahasim me distancën që përshkoi i Dërguari i Allahut, kur shkoi nëpër shtatë palë qiejt, janë të prirura për të pasur keqfunksionime teknike, që nganjëherë, detyrohet shtyrja e lëshimit të tyre.

Kur’ani i Shenjtë mbetet mrekullia e përjetshme e profetit tonë Muhamed, me anë të të cilit ai sfidoi xhindet dhe njerëzimin për të bërë një libër si ai, ose një sure, ose madje dhjetë “ajete” të sajuara. Kjo ka ndodhur kur pothuajse gjithkush ishte një gjeni në zotërimin e gjuhës. Megjithatë, asnjë nuk ishte në gjendje të përballej me këtë sfidë; kështu arabët iu kthyen herë luftës kundër profetit, dhe herë ofertës për t’i dhënë pozitë dhe pasuri. Kur’ani i Shenjtë është një mrekulli në kuptimin e plotë të fjalës:

“Ata thanë: Përse të mos i ketë zbritur atij një mrekulli nga Zoti i tij?” Thuaj: ‘Çështja e mrekullive është vetëm në duar të Allahut e unë nuk jam tjetër përveçse tërheqës i vërejtjes dhe shpjegues. Po, a nuk u mjaftoi atyre që Ne ta shpallëm ty Librin, i cili u lexohet atyre e s’ka dyshim se kjo është dhuratë e përkujtues për njerëz që duan të besojnë”. (Kur’an, 29: 50 - 51)

Kur’ani i Shenjtë ishte dhe është mrekullia e qartë që i mjaftoi dhe i mjafton gjithë njerëzimit si provë që provon të vërtetën e mesazhit që u soll nga Muhamedi.



Çdo rrokje në të është një mrekulli më vete.

“Thuaj: Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhindet për të sjellë një Kur’an të tillë, ata nuk do të mund ta bënin si ky, sado që ta ndihmonin njëri-tjetrin. Ne u sqaruam njerëzve në këtë Kur’an shembuj (argumente) të çdo lloji, e shumica e njerëzve nuk deshi tjetër, vetëm mobimin”. (Kur’an 17: 88 - 89)

Asnjë qenie njerëzore nuk mund të njihet asnjëherë me gjithë dijen që përfshihet në Kur’anin e Shenjtë sepse ai është fjala e të Gjithëfuqishmit, të Lavdëruarit dhe të Madhëruarit. Ai ka thënë: *“Thuaj: ‘Sikur të ishte deti bojë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, ai (uji i tij) do të shteronte para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim e, edhe sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti).’”* (Kur’an, 18: 109) Mrekullitë në Kur’anin e Shenjtë janë të vazhdueshme, të përvetshme, gjithnjë të pranishme, mbresëlënëse nga brezi në brez: çdo brez do t’i zbulojë vetë mrekullitë e këtij Libri dhe mund të arrijë të kuptojë se mrekullitë e Kur’anit të Shenjtë asnjëherë nuk do të mbarojnë. Të gjitha mrekullitë që kanë shkelur ligjet e natyrës dhe me të cilat Allahu i ka fuqizuar të dërguarit dhe profetët e Tij, kanë ndodhur brenda sferës së Tokës dhe jo më shumë se kaq. Por i Gjithëfuqishmi i zbriti të dërguarit të tij, Muhamedit mrekullinë më të qëndrueshme nga të gjitha mrekullitë, atë që do të ndriçojë gjithmonë në çdo kohë. Librat e tjerë qiellorë janë shtrembëruar, ndyshuar, falsifikuar. Por, jo Kur’ani i Shenjtë. Kjo është, vërtet një mrekulli. Allahu i Gjithëfuqishëm ka thënë në Kur’an:

“Ne do t’ua tregojmë atyre shpejt Argumentet Tona në univers dhe në vetë vetet e tyre derisa t’u bëhet kreu e qartë atyre se ajo është e Vërteta.” (Kur’an, 41: 53)

Sfida e saj dhe fakti që ajo e gris perden që na ndan nga e ardhmja është një front tjetër i vështirë me të cilin do të përballen armiqtë e Allahut. Dija e së ardhmes mund të ndahet në dy periudha:

- 1) e tanishmja dhe e ardhmja e afërt, e cila nuk është e largët nga koha kur zbriti Kur’ani i Shenjtë;
- 2) e ardhmja e largët.



1) E tanishmja dhe e ardhmja e afërt

Kur'ani i Shenjtë thotë:

1. Elif, Lamë, Mimë.
2. Bizantinët (rumët) u mundën,
3. në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë,
4. brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen,
5. për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, Mëshirues. (Kur'an, 30: 1 - 5)

A mundet që profeti Muhamed ta parashikonte rezultatin e luftës që do të bëhej midis dy kombeve gjigantë të asaj kohe - romakëve dhe persianëve pas disa vjetësh dhe a mundet që udhëheqësi ta parashikojë fatin e luftës dhe sigurimin e fitores të një ushtrie kundër ushtrisë tjetër? Le të supozojmë se romakët e kishin humbur luftën pas disa vjetësh dhe se persianët ishin fitimtarët. Atëherë, cila do të ishte e ardhmja e Kur'anit të Shenjtë? Kur'ani i Shenjtë do të kishte bërë një gabim të rëndë po të ishin mundur romakët. Atëherë, si mundet që i Dërguari i Allahut, Muhamedi, ta vinte në rrezik besimin në Islam dhe të ardhmen e së vërtetës së Kur'anit të Shenjtë, duke bërë pohime të tilla se romakët do t'i mundin persianët? Por, nuk është ai që e thotë atë; është i Gjithëfuqishmi që e thotë. Lexuesi, me siguri e ka parë atë që përmendet në lidhje me këtë në suren që ka të bëjë me Hatixhen.

2) Një sfidë gjatë kohës së Profetit

Natyra e kësaj lloji sfide është se ajo përballet me jobesimtarët, përfshirë Ebu Lehebin, Allahu e dënoftë!, i cili nuk besonte dhe luftoi me egërsi kundër thirrjes islame. Për këtë arsye, i Gjithëfuqishmi zbriti ajetet e mëposhtme për Ebu Lehebin: *“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi! E, ai do të shkatërrohet! Atij nuk do t'i bëjë dobi pasuria e vet, as ajo që fitoi! Ai së shpejti do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E, edhe gruaja e tij, ajo që bart dru (ferra) e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur fort”*. (Kur'an, 111: 1 - 5)



Kur zbritën këto ajete, Ebu Lehebi ishte ende gjallë dhe ai asnjëherë nuk u tërhoq nga mosbesimi. Atëherë, çfarë e ndaloi atë të mos tërhiqej dhe të mos përqafonte besimin? Cilat mund të ishin pasojat e një gabimi të tillë? Por këto ajete nuk janë deklarime të Profetit Muhamed. Jo, ato janë fjala e Zotit të Muhamedit, e cila nuk pëson asnjë ndryshim. Faktet e Kur'anit nuk mund të ndryshohen asnjëherë, thjesht sepse ai sfidon të gjitha kohët deri në Ditën e Gjykimit.

Ka një sfidë tjetër të madhe që i jep fund çdo konfuzioni, duke i bërë jobesimtarët të njohin faktin që nuk ka asnjë dyshim në këtë Fjalë, në fjalën e Allahut që është Një dhe vetëm Një Zot dhe që e njeh të panjohurën për të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Kjo sfidë mishërohet në ajetin që thotë:

“Ju, patjetër do të udhëtoni nga një shtresë (sfere) mbi një shtresë tjetër”. (Kur'an 84: 19) Ky pohim është bërë para më shumë se një mijë e katërqind e pesëdhjetë vjetësh, kur nuk kishte aeroplanë, raketa, anije kozmike, kur nuk bëhej asnjë përpjekje për të hetuar sferën e jashtme të Tokës dhe kur mjetet e transportit ishin shpinat e kafshëve. Allahu i Lavdëruar dhe i Madhëruar ka përfshirë në mrekullinë e Tij, të quajtur Kur'ani i Shenjtë shumë mistere kozmike që ta bëjë Kur'anin e Shenjtë të përjetshëm deri kur të vijë Ora dhe që secili brez të mund të nxjerrë nga Kur'ani i Shenjtë atë që duhet. Ky është ajet kozmik dhe *“derisa t'u bëhet e qartë atyre se kjo është e vërteta”* do të thotë: derisa ata ta kuptojnë se Kur'ani i Shenjtë është e vërteta që zbriti nga Ai (Allahu). Atëherë, a mund të themi se mrekullitë kozmike vijnë në harmoni me ajetet e Kur'anit të Shenjtë? Thënia *“Ne shpejt do t'ua tregojmë atyre Shenjat Tona (mrekullitë, ajetet)”* përcjell kuptimin se Allahu i Gjithëfuqishëm do të na i zbulojë mrekullitë dhe misteret e universit dhe ato mund t'u paraqiten edhe besimtarëve, edhe jobesimtarëve, *“derisa t'u bëhet e qartë atyre se kjo është e vërteta”*.

Kjo e vërtetë e ka lëshuar përtokë vallon për të ardhmen, duke provuar të vërtetën e Kur'anit të Shenjtë se ai është fjala e Zotit të Botëve. Dhe ja, na vijnë ajetet e sures al Inshikak që thonë: *“(Betohem) për hënën kur ajo është e plotë.*



Ju, patjetër do të udhëtoni nga një shtresë (sfere) mbi një shtresë tjetër. E, çfarë kanë ata që nuk besojnë? Dhe, kur u lexohet atyre Kur'ani, nuk përulen (nuk bien në sexhde)! Përkundrazi, ata që nuk besuan, edhe përgënjeshtrojnë! E, Allahu e di më së miri se çfarë mbajnë fshehtë ata. Lajmëroji, pra me një dënim të dhembshëm. Përveç atyre që besuan e bënë vepra të mira, të cilët kanë shpërblim të vazhdueshëm.” (Kur'an 84: 18 - 25)

I Gjithëfuqishmi dhe i Madhëruari u ka premtuar njerëzve se ata do të udhëtonin nga një shtresë (sfere) mbi një shtresë tjetër, domethënë ata do përshkonin universin dhe do të lëviznin nga një orbitë sferike te një tjetër. Kjo citohet nga *tefsiri* (komentimi) i Ibn Abasit në librin e tij *Al Mikias li Ibn Abbas*. Krejt qartë, kjo ka të bëjë me eksplorimin e hapësirës. Atëherë, ku e mori Profeti Muhamed këtë dije?! Aeroplanët janë bërë tani një realitet dhe po përshkojnë shtresat e ajrit, duke i çuar njerëzit nga një shtresë te një tjetër, kurse anijet kozmike po i çojnë ata nga një sferë a orbitë te një tjetër. Le të sjellim tani një sfidë kur'anore, një mrekulli që e gris perden që na ndan nga e ardhmja. Kjo sfidë u flet atyre që merren me dije. Në të, Kur'ani i Shenjtë u provon atyre se ata nuk dinë asgjë përveç asaj që ua ka dhënë Allahu ta dinë, se nuk i mëson askush tjetër përveç Allahut të Gjithëfuqishëm, Atij që di të paditurën dhe se Kur'ani i Shenjtë është fjala e Tij, të cilit nuk mund t'i atribuohet absolutisht asnjë e metë. Në suren *al Dukkan* lexojmë: *“Ha, Mimë. Pafsha Librin sqarues (të së drejtës nga e kota)! Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (Natën e begatshme të Kadrut). Ne dëshiruam t'u tërheqim vërejtjen që njerëzit të jenë të gatshtëm. Atë (Natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë. Urdhër i përcaktuar nga Vetë Ne. S'ka dyshim se Ne dërguam të dërguar. (E zbritëm) nga mëshira e Zotit tënd; Ai është Dëgjuesi, i Dituri. Zoti i qiejve e i Tokës dhe çfarë ka ndërmjet tyre, nëse jeni të bindur. Nuk ka zot tjetër përveç Atij. Vetëm Ai jep jetë e vdekje, Zoti juaj dhe Zoti i prindërve tuaj të lashtë. Por jo, ata (idhujtarët) janë në dyshim, ata e marrin për lojë. Ti prite, atëherë Ditën kur qielli sjell një tym të dukshëm, që do t'i përfshijë njerëzit. Ky është një ndëshkim i dhembshëm. (Ata thonë) Zoti ynë, largoje prej nesh dënimin! Sigurisht, ne do të besojmë. ...Por atyre u pati ardhur i Dërguar që e bëri të qartë (të vërtetën), por i kthyen shpinën atij (të Dërguarit) dhe i thanë:*



'I mësuar prej dikujt, i çmendur.' Ne do t'ju largojmë për pak kohë dënimin, (por) ju me siguri, do t'i ktheheni (së keqes). (Kujto) Ditën kur do t'ju kapim me një rrëmbim të fuqishëm e të shpagubeni."

Allahu i Plotfuqishëm ka thënë këtu se Kur'ani i Shenjtë është fjala e Krijuesit, Allahu, i Lavdëruar dhe i Madhëruar qoftë Ai, që Ai i zbriti të Dërguarit të Tij Muhamedit, në një natë të bekuar me qëllim që t'i paralajmëronte të gjithë njerëzit, dhe që Ai të vendosë në të (shpallje) çdo urdhër që do të vijë. Skeptikëve, që dyshonin në të vërtetën e Mesazhit që i zbriti Muhamedit, Zoti i Dinjitetit dhe i Nderit, i Lavdëruar Zoti, u thotë, nëpërmjet robrit dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit: *"Ti, pra prite ditën kur qielli sjell një tym të dukshëm. Ai (tymi) i përfshtin njerëzit."* (Kur'an, 44: 10 - 11) Në një hadith, Profeti trajton shenjat që tregojnë afrimin e Ditës së Gjykimit, thotë: *"Më e para e shenjave të tilla është tymi (që përmendet në këto ajete)." Atë e pyetën çfarë tymi do të ishte. Ai tha: "Ai do të mbulojë lindjen dhe perëndimin e Tokës. Ai do të qëndrojë për dyzet ditë dhe net. Ai do ta prekë besimtarin mu siç e prek një rrufë. Sa për jobesimtarin, ai do të ndiehet sikur është helmuar; ai [tymi] do t'i dalë nga vrimat e hundës, veshëve dhe prapanicës."*

Imami Xhafer al - Sadik citohet se ka thënë: *"Do të jetë tymi që do të mbulojë të dyja skajet e Tokës, duke shkaktuar vdekjen e dy të tretave të popullsisë së botës."* Tani, thuhet se ky tym shkaktohet nga shpërthimi i bombave bërthamore dhe me hidrogjen dhe nga gazet e helmëta. Fjala "i dukshëm" në këtë ajet do të thotë se ai mund të shihet dhe të identifikohet lehtë. Ai do të mbulojë të gjithë njerëzit dhe do të mbushë Tokën. Ai do të jetë, siç e përshkruan ajeti, "një dënim i dhimbshëm". Si do t'i ndëshkojë ai njerëzit, shpjegohet më sipër te *hadithi* i Profetit, domethënë, ai do t'u dalë jobesimtarëve nga vrimat e hundës, veshëve dhe prapanicave dhe ata (dy të tretat e popullsisë së botës) do të vdesin të gjithë. Pikërisht, ashtu siç ka sfiduar të shkuarën dhe të ardhmen, Kur'ani i Shenjtë ka sfiduar edhe të tanishmen, duke e bërë krijimin të vështirë për ta kuptuar, duke u dhënë atyre mundësi të zgjedhin ose të nënshtrohen dhe të njohin Fuqinë e Allahut të Gjithëfuqishëm dhe të pranojnë se fjala e Tij që ia zbriti robrit dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit



është e vërteta nga Allahu, ose të mbesin në kryeneçësinë dhe në mosbesimin e tyre dhe të mohojnë të vërtetën e kështu, të vazhdojnë të jenë në rrugë të humbur; sytë dhe zemrat e tyre janë mbyllur për të vërtetën. A ka shembull tjetër që mund të sjellim për Kur'anin e Shenjtë që të sfidojë të tashmen? Po, ka.

Ka shumë shembuj për këto sfida në Kur'anin e Shenjtë; janë sfidat e kohës së tanishme. Ja një një sfidë për krijimin e njeriut. Allahu i Plotfuqishëm thotë në Kur'anin e Shenjtë: *"Le të shikojë njeriu se nga çfarë është krijuar. Ai është krijuar prej një uji që hidhet fuqishëm, që del midis kurrizit dhe brinjëve. E, s'ka dyshim se Ai ka fuqi ta rikthejë në jetë atë."* (Kur'an, 86: 5 - 8) Ai ka thënë, gjithashtu:

"Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkën e baltën) e bëmë pikë uji (farë) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngjizur e bëmë copë mishi e atë copë mishi e shndërruam në eshtra dhe eshtrave u veshëm mishin; pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, më i miri Krijues." (Kur'an, 23: 12 - 14)

A ka ndonjë përshkrim të krijimit tonë më elokuent se ky? A ka ndër krijimet e Allahut që mund ta ndryshojë këtë rrjedhë në krijimin tonë? A ka ndonjë që mund ta ndryshojë mënyrën sesi lind njeriu? A ka ndonjë njeri që mund t'u shmanget këtyre etapave? Nëse dikush mund ta bëjë këtë, atëherë, do të themi që ajo që u tha më sipër është fjalë njeriu. Por, nëse njerëzit nuk mund të vijnë në këtë botë ndryshe nga sa u tha në këto ajete, atëherë, ajo është fjala e të Plotfuqishmit, Krijuesit të krijesave, Zotit të botëve. I Lavdëruar dhe i Lartësuar është Ai nga ajo që i përshkruajnë.

Le të citojmë tani këto ajete: *"Çdo njeri do ta shijojë vdekjen."* (Kur'an, 3: 185) Dhe: *"Kudo që të jeni, vdekja do t'ju gjejë, edhe në qofshi në pallate të fortifikuara."* (Kur'an 4: 78)

Kjo në vetvete është një sfidë që Allahu i Plotfuqishëm përfshin në Kur'anin e Shenjtë: Është Ai që ka urdhëruar vdekjen për krijesat e Tij. E, atëherë, cili është ai njeri që mund t'i ikë vdekjes? A janë këto ajete fjalë njeriu? A përfundon kjo sfidë në ndonjë periudhë kohe? Tani, është koha të hyjmë në thelbin e temës



së madhe me qëllim që të provojmë se Kur'anit i Shenjtë është mrekulli e mrekullive. Çfarë u tha më sipër, është vetëm një hyrje. Shumica e dijetarëve myslimanë kanë pikëpamjen se Kur'anit i Shenjtë, në tërësinë e tij, në urdhrat dhe rregullat që ai përmban, në renditjen dhe organizimin e tij, në urtësinë, elokuencën dhe qartësinë e tij, në Sheriatin që përmban, në njoftimet për të padukshmen dhe në konsideratat e tjera është, me të vërtetë, një mrekulli, që njerëzimi nuk mund t'i bëjë një të ngjashme.

Ka shumë prova dhe aspekte të natyrës mrekullore të Kur'anit të Shenjtë, të mishëruara në vetë Librin. Një aspekt i tillë mrekullor është logjika dhe elokuenca e tij. Ai flet për të padukshmen, mrekullinë ligjore, mrekullitë shkencore në format e tyre të shumëllojshme - mjekësore, kozmike, gjeografike, fizike, numerike, informative dhe shumë aspekte të tjera.

Ndërmjet aspekteve mrekullore të Kur'anit të Shenjtë është fakti që asnjë libri tjetër - fetar ose laik nuk i është kushtuar kaq shumë vëmendje sa Kur'anit të Shenjtë. Që nga zbritja e tij, myslimanët i kanë mësuar ajetet dhe suret e tij përmendsh, kanë harxhuar kohë dhe përpjekje për t'i shpjeguar ato dhe kanë regjistruar çfarë ka komentuar i Dërguari i Allahut në lidhje me to dhe çfarë komentimesh kanë bërë dijetarë të tjerë. Me kalimin e kohës, u krijua një klasë e re dijetarësh të komentimit dhe u shkruan libra nga komentuesit. Ka tani libra që trajtojnë ajete, që kanë kuptim të ngulitur dhe ajete, kuptimi i të cilave është i ngjashëm dhe studime që merren me arsyet e Shpalljes dhe me klasifikime që i ndajnë suret e Kur'anit në mekase dhe medinase dhe studime që merren me artin e këndimit të tij e libra për metodat e leximit të tij dhe për aspektin e tij mrekullor. Ka libra të tjerë që merren me gramatikën e gjuhës së Kur'anit të Shenjtë; të tjerë, me figurshmërinë e saj dhe të tjerë që kalkulojnë ajete të tij dhe që i ndajnë suret dhe *hizbet* e tij, përveç librave që klasifikojnë ato ajete që abrogojnë të tjerat dhe ato ajete që abrogohen. Ka studime gjuhësore që merren me elokuencën e Kur'anit, organizimin e tij, qartësinë e argumentit, kuptimet e fjalëve dhe rrjedhën ligjërimore, theksimet fisnore



në recitim të tij e etiketën e këtij recitimi dhe vlerat e sureve e shpërblimet për recitim të tij. Vëmendja ndaj Kur'anit të Shenjtë arriti deri në atë shkallë sa u numëruan fjalët dhe shkronjat dhe u përcaktua raporti midis këtyre fjalëve dhe shkronjave, ajeteve dhe sureve. Në Medine, është një dorëshkrim i shekullit I (Hixhri). Ai citon një grup dijetarësh që shpjegojnë sesi i kanë llogaritur shkronjat e Kur'anit të Shenjtë, duke përdorur kokrra elbi dhe kanë regjistruar të dhënat e tyre në disertacion të vogël të vënë midis enëve të vjetra e që ruhen deri tani. Ky disertacion përmban numrin e përgjithshëm të ajeteve, të shkronjave dhe të karaktereve në Kur'anin e Shenjtë përveç të dhënave të tjera. E gjitha kjo provon kujdesin që kanë treguar brezat e kaluar për tekstin e Kur'anit të Shenjtë dhe kjo është ajo që ka thënë Al Kurtubi, duke cituar Selam Ebu Muhamed al - Hamani: “Dijetarët dhe ata që e dinin Kur'anin e Shenjtë përmendsh u mblodhën, dhe unë isha një ndër ta, kështu ne numëruam dhe nxorrëm që Kur'ani i Shenjtë kishte 340700 shkronja. Ku mbërrimë po ta ndajmë këtë shifër përgjysmë? Përgjigjia mbërrimë këtui: gjysma e tekstit të Kur'anit të Shenjtë është te fjala *fal jatalattaf* në suren 18 (*al - Kehf / Shpella*). Ku do të mbërrimë po ta ndanim tekstin në tri pjesë të barabarta? Do të gjenim se fillimi i së tretës së parë mbaron në fund të ajetit 100 të sures *Bara'a* (Surja 9 / *Teube*); e treta e dytë mbaron te fundi i ajetit 101 të sures *al - Shu'ara* (Surja 26 / *Poetët*); e treta e fundit përfshin pjesën e mbetur të Kur'anit të Shenjtë. Po ta ndanim tekstin e Kur'anit të Shenjtë në shtatë pjesë, do të na dilte si më poshtë:

- 1) E para shënohet me *dal* në “Po disa prej tyre i besuan atij (Muhamedit), e disa e refuzuan...[*sadd*]” (Kur'an, 4: 55).
- 2) E dyta shënohet me *ta* në “...ata asgjësuan veprat e tyre [*habitat*]” (Kur'an, 7: 147).
- 3) E treta shënohet me *elif* në “ushqimi i tij [*ukuluha*] dhe format janë të përjetshme” (Kur'an, 13: 35).
- 4) E katërta shënohet me *elif* në “Ne i kemi caktuar çdo popull vendtherrjen e (*kurbanit*) [*mansakan*]” (Kur'an, 22: 34).



5) E pesta shënohet me *ha* në “Nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje... [*mu'minah*]” (Kur'an, 33: 36).

6) E gjashta shënohet me *uau* në “...mendimi i të cilëve për Allahun ishte i keq” (Kur'an, 48: 6).

7) E shtata është pjesa që mbetet e Kur'anit të Shenjtë.

Fillimi i një të katërtës së tij është përfundimi i sures al-En'am; e dyta është në suren al-Kehf; e treta është në fund të sures al-Zumer; e fundit është pjesa e mbetur e Kur'anit të Shenjtë.

Po t'u hedhim një shikim katërmbëdhjetë shekujve të kaluar ose më shumë se katërmbëdhjetë shekujve, gjatë të cilëve Islami u luftua me luftra të llojllojshme, nga kombe të ndryshme në këtë tokë e, duke përdorur çdo armë të mundshme për të mos e pranuar sfidën e tij, provon se të gjithë kundërshtarët e tij treguan paaftësinë e tyre për të përballuar sfidën e Kur'anit të Shenjtë. E vetmja dije e saktë për Kur'anin e Shenjtë gjendet në vetë Kur'anin e Shenjtë dhe askush nuk mund ta fitojë këtë dije përveç atyre që u është dhuruar dhe gjokset e të cilëve i ka zgjeruar Allahu i Gjithëfuqishëm për ta rrokur dhe për ta përthithur këtë dije. Kur'ani i Shenjtë është mrekulli në gjithçka që përmban. Çdo kuptim i tij është një mrekulli në vetvete. Shprehjet e tij janë, gjithashtu, mrekulli. Kuptimi, kur bashkëlidhen me shprehjen na jep kuptimin e rrjedhës së tij ligjërimore. Ligjërimi i Kur'anit të Shenjtë, në mënyrën sesi është organizuar, është një mrekulli ndër mrekullitë e tjera, që e bën atë mrekullinë më të madhe.

Fjalët e tij na japin detaje të qarta e shkëlqimtare për mrekullinë e tij. Numri sesa herë përsëriten fjalët në të gjithë Kur'anin e Shenjtë është, gjithashtu, një mrekulli. Numri që tregon sesa herë përsëritet një fjalë, harmonizohet me numrin që tregon sesa herë përsëritet një fjalë tjetër, e cila ose pajtohet me të, ose e kundërshton atë, ose e kontraston atë, ose është në kontradiktë me të. Numri sesa herë përsëriten fjalët është një mrekulli në vetvete. Po kështu, ndodh me shkronjat, çka është një mrekulli tjetër shkëlqimtare dhe mrekullia e Kur'anit të Shenjtë nuk është vetëm tek ajetet e shenjta dhe te kuptimet e tij mrekullore,



te parimet dhe bazat e tij të drejta e te dija e së fshehtës, por edhe te vetë numri i herëve. Numri i herëve që tregon përsëritjen e një shkronje të veçantë është një mrekulli tjetër.¹

E përktheu nga gjuha angleze: **Bledar Shehu**



¹ Për dukurinë e paimitueshmërisë numerike të Kur'anit të Shenjtë shih te “Drita e Kur'anit”, II, 2011.

Kur'ani është libër unikal

Abstrakt

Kur'ani nuk është libër "fetar", siç kuptohet rëndom kjo fjalë. Edhe kur lexuesi e merr në dorë Kur'anin, duke e menduar si një libër të zakonshëm, ai mbetet i habitur nga stili dhe mënyra e parashtrimit. Ai sheh se në mjaft vende, nuk përmenden të dhëna plotësuese dhe as rrethanat në të cilat një pasazh i caktuar është shpallur. Kështu, lexuesi i zakonshëm nuk është në gjendje të përfitojë plotësisht nga thesaret e çmuara që përmban Kur'ani. Lexuesi do të shpëtojë nga të gjitha këto vështirësi nëse do ti bëhet e ditur më parë. Ai është i vetmi libër i këtij lloji në botë. Stili i tij letrar është krejt i ndryshëm nga a i librave të tjerë. Atëherë dhe vetëm atëherë, lexuesi mund ta kuptojë atë.

"Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës. Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje, në të cilën ndodhet një kandil; kandili është në një kristal dhe kristali është si një yll i shndritshëm. Ai (kandili) ndizet prej (vajit të) një peme të bekuar ulliri, që nuk është as lindore e as perëndimore. Vaji shkëlqen edhe pa e prekur zjarri. Dritë sipër dritës. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij kë të dojë dhe paraqet shembujt për njerëzit. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë." (Kur'an, 24:35)

Lexuesi që për herë të parë do të studiojë Kur'anin, duhet të ketë parasysh faktin se ai është një libër i pashok, ndaj edhe habitet, kur nuk gjen të shpallur në të temën apo ndarjen në kapituj dhe në pjesë, në përputhje me çështje të veçanta të udhëzimeve që jepen për aspekte të ndryshme të jetës, sipas një rregulli të caktuar.



Ai sheh diçka me të cilën nuk mund të jetë familjarizuar dhe që nuk i përshtatet konceptit të tij mbi kuptimin e librit. Ai vëren se Kur'ani trajton çështje të besimit, jep udhëzime morale, shtron ligje, fton njerëzit në Islam, këshillon ata që nuk besojnë, nxjerr përfundime nga ngjarje historike, jep paralajmërime, ofron lajme të mira dhe të gjitha këto të ndërtuara së bashku në një mënyrë të përsosur. Por, në të njëjtën kohë lexuesit i duket sikur përsëritet në mënyra të ndryshme dhe njëra temë ndjek tjetrën pa ndonjë lidhje të dukshme dhe po ashtu, i duket se një temë e re del midis tjetrës pa ndonjë lidhje të dukshme. Ngjarjet historike, probleme të filozofisë, të metafizikës nuk parashtrohen si në librat tradicionalë për këto tema. Njeriu dhe universi përmenden me një gjuhë të ndryshme nga ajo e shkencave të natyrës. Po ashtu, ai ndjek metodën e vet në trajtimin e problemeve kulturore, politike, sociale e ekonomike dhe merret me parimet dhe ligjet në mënyrë krejt të veçantë nga ajo e sociologëve dhe e juristëve. Morali jepet në një mënyrë të tillë që nuk ngjason me të gjithë literaturën mbi këtë subjekt. Kur'ani nuk është libër “fetar” siç kuptohet rëndom kjo fjalë. Ndaj edhe kur lexuesi merr në dorë Kur'anin, duke e menduar si një libër të zakonshën, ai mbetet i habitur nga stili dhe mënyra e parashtrimit në të. Ai sheh se në mjaft vende, nuk përmenden të dhëna plotësuese dhe as rethanat në të cilat një pasazh i caktuar është shpallur. Kështu lexuesi i zakonshëm nuk është në gjendje të përfitojë plotësisht nga thesaret e çmuara që përmban Kur'ani. Lexuesi do të shpëtonte nga të gjitha këto vështirësi nëse do t'i bëhej e ditur më parë. Ai është i vetmi libër i këtij lloji në botë. Stili i tij letrar është krejt i ndryshëm nga ai i librave të tjerë. Atëherë dhe vetëm atëherë, lexuesi mund ta kuptojë atë.

Udhërrëfyet e Zotit

Para së gjithash, lexuesi duhet të kuptojë natyrën e vërtetë të Kur'anit. Beson apo jo lexuesi, Kur'anin është një libër i shpallur dhe kjo duhet si pikënisje për leximin e tij. Kur'ani është Udhërrëfyet i Zotit. Allahu, Zoti i Universit dhe Krijuesi i tij,



krijoi njeriun dhe i dhuroi atij zotësinë e të mësuarit, të folurit, të kuptuarit të së drejtës nga e gabuara dhe të dalluarit të së mirës nga e keqja. Ai i dha njeriut të drejtën e të përfituarit nga përdorimi i sendeve që e rrethojnë. Shkurt, Ai i dha njeriut një lloj autonomie dhe e caktoi atë si përfaqësuesin e Tij në Tokë dhe e udhëzoi atë të jetojë në përputhje me Udhërrëfyesin e tij. Ai i organizoi të gjithë ata që ranuan Udhërrëfyesin hyjnor në një bashkësi, të cilës iu kërkuar të rivendoste mënyrën e të jetuarit në mbështetje të Udhërrëfyesit Hyjnor. Kur'ani që iu shpall Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), është Libri që përmban këtë ftesë dhe atë Udhërrëfyes të Zotit. Subjekti me të cilin merret është njeriu. Ai diskuton ato aspekte të jetës së tij që e çojnë drejt mirëqënies ose drejt dështimit. Tema qëndrore që përshkron gjithë Kur'anin është njohja e së Vërtetës dhe ftesa në Rrugën e Drejtë. Nëse lexuesi do të ketë parasysh këto tri gjëra themelore, do të shikojë se në Libër ka mospërshtatje në stil, mungesë vazhdimësie apo mungesë ndërlidhjeje midis temave të ndryshme që trajtohen. Është fakt se ky Libër është gjithmonë i lidhur me subjektin, temën qëndrore dhe qëllimin e tij. Ndaj ai thotë, diskuton ose citon vetëm aq sa i takon qëllimeve ose objekteve të tij, duke përjashtuar detajet e panevojshme, duke iu kthyer e rikthyer temës qëndrore dhe ftesës, rreth të cilave trajtohet çdo çështje. Kur Ku'ani studiohet në këtë prizëm, atëherë nuk ka më dyshime dhe e gjithë përmbajtja e tij është e mjaft e arsyeshme. Vërehet një vazhdimësi e subjektit në të gjithë Librin.

Stili

Shpallja e Kur'anit zgjati 23 vjet. Pjesë të veçanta të Kur'anit u shpallën në përputhje me fazat e ndryshme të Islamit. Prandaj dhe një Libër i tillë nuk mund të ketë të njëjtin stil që ndeshet në librat e zakonshëm për fenë apo tema të tjera. Duhet të mbahet parasysh gjithashtu se pjesë të ndryshme të Kur'anit, të gjata apo të shkurtra, në kohën e shpalljes së tyre, nuk kishin për qëllim të botoheshin në formë panfletësh, por jepeshin si ligjërata



dhe përhapeshin si të tilla. Kështu, ato nuk mund të ishin në stilin e fjalës së shkruar. Nga ana tjetër, këto ligjërata detyrimisht ishin të ndryshme nga stili i leksioneve të një profesori. Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ishte besuar një mision i veçantë: Ai duhet t'i drejtohet intelektit dhe ndjenjave të njerëzve. Atij i duhej të merrej me njerëz të mentaliteteve të ndryshme, të përballonte situata dhe përvoja të ndryshme gjatë misionit të tij. Atij i duhej të përgatiste dhe të rinformonte pasuesit e tij, t'u mbushte atyre shpirtin dhe t'u jepte guxim, të hidhte poshtë argumentat e kundërshtarëve dhe të vinte në dukje dobësitë morale të tyre. Kjo shpjegon edhe faktin pse të njëjtat çështje përsëriten në Kur'an. Natyrisht, një mision dhe një lëvizje kërkon vetëm temat që duhen në një moment të caktuar, duke mos i përmendur ato që i duhen një moment tjetër. Udhëzimet janë shprehur me fjalë e stil tjetër për të shmangur monotoninë, janë hartuar në një gjuhë të bukur dhe të denjë, për t'i bërë jo vetëm të efektshme, por edhe të të lënë përshtypje. Të gjitha suret e Kur'anit përmbajnë referenca ndaj besimit themelor: Njësia e Allahut, atributet e Tij, e ardhmja, përgjegjësia, dënimi dhe shpërblimi, profetësia dhe besimi tek Libri. Te gjitha këto të mësojnë për mëshirë, qëndresë, durueshmëri, besim tek Allahu, sepse këto virtyte nuk mund të lihen pas dore në asnjë shkallë të Islamit. Sikur, edhe njëra prej tyre të dobësohet, në cilëndo shkallë, qoftë edhe fare pak, lëvizja Islame nuk do ruante zhvillim.

Hartimi

Allahu, i cili e shpalli vetë Kur'anin, mori masat për ta siguruar atë përgjithmonë. Sapo shpallej një sure e Kur'anit, ajo shkruhej nën diktimin e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe ruhej me kujdes të veçantë. Përveç kësaj, disa nga shokët e Profetit i mësuat këto sure përmendsh, pasi recitonin gjatë faljeve. Por, menjëherë pas vdekjes së tij, një pjesë e njerëzve, nën ndikimin e kundërshtarëve, filluan të largoheshin nga besimi, ndërsa një pjesë e shokëve të tij të ngushtë



u vranë gjatë luftimeve që shpërthyen. Disa nga ata që e kishin mësuar Kur'anin përmendsh ndodheshin midis të vrarëve. Në këto kushte, Omarit i shkoi ndërmend që ta ruanin Kur'anin të paprekur në origjinalitetin e tij, dhe të mos varej çdo gjë vetëm te njerëzit që e kishin mësuar atë përmendsh. Ai arriti t'ia mbushte mendjen Ebu Bekrit dhe së fundi, Zaid bin Thabit, të cilit edhe ia besoi këtë punë, duke qenë se ai ishte më i përgatituri për këtë qëllim, sepse kishte qenë shkruar i Profetit dhe e kishte mësuar Kur'anin drejtpërsëdrejti prej tij. U morën masa për të mbledhur të gjitha pjesët e shkruara të Kur'anit të lëna nga Profeti, si dhe ato që kishin shkruar prej tij shokët. Të gjitha pjesët e shkruara u krahasuan me njëra-tjetrën fjalë për fjalë. Zejd bin Thabit nuk shkruante asgjë nëse nuk përputheshin me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, u arrit të hartohej një kopje e saktë, autentike dhe e plotë e Kur'anit. Në shumë vende Kur'ani e përmend veten si libër. P.sh.: Në suren “Muzzemil”, Allahu i thotë Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Kur'anin lexoje me vëmendje...”* (73:4) Kjo tregon që Kur'ani ishte paracaktuar të ishte libër që në fillimet e shpalljes së tij dhe se ky libër duhet të ndiqte një rregull të caktuar. Kur'ani që përdoret sot në të gjithë botën është kopje e saktë e Kur'anit që u hartua nën urdhrin e Ebu Bekrit dhe kopjeve që u dërguan zyrtarisht nga Othmani në vende të ndryshme. Edhe sot gjenden mjaft kopje shumë të vjetra të cilat ruhen në biblioteka të ndryshme të botës. Ndonjë skeptik mund edhe të ketë dyshime rreth shpalljes së Kur'anit nga Allahu, por askush nuk mund të vërë në dyshim autenticitetin, imunitetin dhe pastërtinë e Kur'anit nga çdo lloj shtese, mangësie apo ndryshimi, sepse nuk ka gjë më autentike në historinë njerëzore se sa fakti që Kur'ani është i njëjti Kur'an që iu paraqit botës nga Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Universaliteti

Të gjithë e dinë se në Kur'an thuhet se ai jep udhëzime për të gjithë njerëzimin. Por, duke e lexuar atë me kujdes, kupton se ai u drejtohet kryesisht arabëve që jetuan gjatë kohës së shpalljes së tij.



Edhe pse në mjaft vende iu drejtohet edhe popujve të tjerë dhe njerëzimit në përgjithësi, më tepër ai diskuton për ato gjëra që iu përshtateshin arabëve, të cilat lidheshin me mjedisin, historinë dhe zakonet e tyre. Fakti që Kur'ani hedh poshtë besimet blasfemike dhe dënon zakonet e këqija të një populli të caktuar, i cili jeton në një kohë dhe vend të caktuar dhe mbështet argumentat për njësinë e Allahut, mbi bazën e materialit të mbledhur në mjedisin e tyre, nuk përbën një provë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se shpallja ishte lokale dhe e përkohshme.

Kjo është çështje që duhet parë më thellë, nëse ajo çka thuhet për popullin blasfemues të Arabisë, është po njëlloj e vërtetë në çdo kohë dhe në çdo vend dhe se ato argument që paraqet Kur'ani për Njësinë e Allahut mund të përdoren ose jo gjithkund. Nëse pas kësaj përgjigja është pohuese, atëherë nuk ka arsye pse një shpallje e tillë universale duhet të konsiderohet lokale dhe e përkohshme thjesht pse i drejtohet një bashkësie të caktuar dhe në një periudhë kohe të caktuar. Nuk ka filozofi, mënyrë jetese apo fe në botë që të parashtrojë nga fillimi në fund çdo gjë në mënyrë abstrakte pa bërë asnjë referencë ndaj rasteve dhe shembujve konkretë dhe kjo, sepse është e pamundur të ndërtohet një mënyrë në një formë abstrakte. Edhe nëse do të pranojmë se kjo mund të arrihej, është mëse e sigurt që një sistem i tillë nuk do të ishte asgjë më shumë sesa një teori në letër që nuk do të kishte marrë kurrë formë praktike. Një sistem ideologjik i caktuar nuk bëhet kombëtar vetëm se është shfaqur për herë të parë te një komb i caktuar dhe kjo nuk pengon që argumentat e tij të mos i drejtohen edhe popujve të tjerë. Në fakt, ajo çka dallon një sistem kombëtar nga një ndërkombëtar, një sistem të përkohshëm nga një i përhershëm është kjo: Një sistem kombëtar ka si synim të vendosë epërsinë e tij ose kërkesa të posaçme mbi kombe të tjera, të paraqesë parime dhe teori të cilat për natyrën e tyre nuk mund të pranohen dhe të zbatohen nga kombe të tjerë. Nga ana tjetër, një sistem ndërkombëtar siguron një status dhe të drejta të njëjta ndaj gjithë qenieve njerëzore dhe nxjerr në pah parimet e zbatimit universal. Parimet e një sistemi të përkohshëm



bëhen të papraktikueshme me kalimin e kohës, ndërsa parimet e një sistemi të përhershëm janë të zbatueshme në çdo kohë.

Kod i plotë i mënyrës së të jetuarit

Një tjetër aspekt që tek disa njerëz shkakton një farë përshtjellimi mendor është pohimi që ndeshet shpesh se Kur'ani është “një kod i plotë i mënyrës së të jetuarit”. Por kur dikush e lexon, nuk gjen aty norma dhe rregulla të detajuara që i përkasin problemeve sociale, kulturore, politike dhe ekonomike. Ndonjëri habitet kur nuk ndeshet as me rregullat e detajuara rreth faljes dhe zekatit, që janë detyrime shumë të rëndësishme për besimtarin mysliman dhe që Kur'ani vetë u jep një rëndësi shumë të madhe. Kështu, një lexues i rastit, nuk arrin të kuptojë se si ky libër mund të quhet një kod i plotë i mënyrës së të jetuarit. Ky vjen ngaqë kundërshtuesi harron faktin se Allahu u dërgoi njerëzve jo vetëm Librin, por caktoi edhe Profetin e Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që të demonstronte mësimet e tij duke i vënë ato në praktikë.

Kur'ani është një libër i dërguar për të ftuar njerëzit të nisin një lëvizje dhe të drejtojnë pasuesit drejt përmbushjes së misionit. Njeriu duhet të shkojë në fushëbetejën e jetës për të mësuar kuptimin e saj të vërtetë.

Për ta ilustruar këtë le të marrim si shembull ngritjen e një ndërtese. Nëse paraqitet vetëm projekti i ndërtësës dhe nuk caktohet asnjë inxhinier për të mbikëqyrur dhe drejtuar ndërtimin e saj, atëherë së bashku me projektin duhet të jepet edhe një sqarim i vogël. Por, nëse krahas projektit caktohet edhe një inxhinier, këto sqarime të hollësishme nuk janë të nevojshme. Në këtë rast, një skicë me elementet themelore do të ishte mëse e mjaftueshme. Prandaj, përderisa Allahu dërgoi Profetin e Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bashkë me Kur'anin, ishin të mjaftueshme vetëm parimet themelore dhe udhëzimet thelbësore. Funkcioni kryesor i Kur'anit është të paraqesë në mënyrë të qartë bazat intelektuale



dhe morale të rrugës islame, t'i forcojë ato me argument dhe t'i thërrasë zemrës së njeriut. Ana praktike e ndërtimit të rrugës së jetës sipas Islamit, gjendet brenda kufijve dhe caqeve të çdo aspekti të jetës pa dhënë rregulla dhe norma të hollësishme. Puna konkrete, në përputhje me udhëzimet që përmban Libri, iu besua Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili u dërgua posaçërisht për të vënë rregullat e jetës të vlefshme për individët dhe gjithë shoqërinë. Një tjetër çëshje që shkakton paqartësi tek disa gjatë leximit të Kur'anit, janë ndryshimet në interpretimin e tij. Dhe nuk janë vetëm njerëzit e periudhave të vonshme, por edhe studiuesit e mëdhenj të periudhave të hershme, duke përfshirë edhe nga shokët e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e pasuesit e tyre që nuk ishin të një mendjeje me interpretimin e urdhërësave dhe ndalimeve që bënte Kur'ani. A meritojnë të gjithë këta njerëz dënimin e përmendur në Kur'an, meqë japin interpretime të ndryshme?

Lidhur me sa u tha më sipër, është e mjaftueshme të themi se Kur'ani nuk është kundër ndryshimeve të mendimeve në interpretimin e udhëzimeve të tij duhe patur parasysh se:

a) Edhe ata që ndryshojnë në mendime nga njëri-tjetri janë të një mendjeje përsa i përket parimeve themelore të Islamit.

b) Ata qëndrojnë të bashkuar brenda bashkësisë islame.

Kur'ani nuk miraton atë lloj divergjence që nis me adhurimin e vetes dhe pandershmërinë që të shpie drejt grindjeve dhe ndarjeve. Lloji i parë i divergjencës është thelbësor për progresin dhe është shpirti i jetës i çdo bashkësie dhe njerëzit me intelekt dhe mendimtarë duhet ta inkurajojnë atë. Prania e tij tregon vitalitet dhe vetëm një bashkësi e tillë mund të përballojë dhe të mposhtë dëshirën për gjëra të ndaluara.

Disa këshilla për studimin e Kur'anit



Kërkesa e domosdoshme për të që do të studitojë Kur'anin është që të fillojë studimin e tij me mendje të hapur, duke u shkëputur nga çdo gjë tjetër.

Nëse dikush nuk është i bindur që Kur'ani është një libër i shpallur nga Allahu, duhet ta çlirojë veten nga ky mendim, të lërë mënjane mendimet e paraformuara dhe ta lexojë me dëshirën për ta kuptuar.

Kush dëshiron të ketë njohuri të thella për Kur'anin, do t'i duhet ta lexojë atë disa herë. Njeriu duhet të kërkojë gjithashtu të zbulojë bazat dhe mënyrën e jetës që përpiqet të ndërtojë mbi to. Nëse gjatë këtij studimi lexuesit do t'i dalin pyetje, le t'i shkruajë ato dhe të vazhdojë leximin me qetësi, pasi përgjigjet e tyre do t'i gjejë vetë diku në Kur'an. Por, nëse nuk gjen ndonjë përgjigje gjatë leximit të parë, me qetësi le të nisë leximin për së dyti. Nga përvoja mund të themi se rrallë herë mbetet ndonjë përgjigje gjatë leximit të dytë.

Pasi të fitohet aftësia depërtuese në kuptimin e Kur'anit, duhet filluar studimi i detajuar i tij dhe të nxirren shënime mbi aspekte të ndryshme të mësimave që ai jep. Për shembull, duhet shënuar se çfarë ndalohet sipas Kur'anit. Duhet shënuar pranë e pranë, cilësitë e një njeriu të mirë dhe të një njeriu të keq. Po ashtu, duhet bërë edhe për ato porosi që të çojnë drejt suksesit dhe shpëtimit dhe atyre që çojnë drejt dështimit dhe shkatërrimit. Në të njëjtën mënyrë, duhet shënuar nëntituj të ndryshëm, mësimet e Kur'anit mbi besimin, moralin, detyrat, kulturën, ekonominë, legjislacionin, paqen, luftën dhe probleme të tjera të jetës njerëzore.

Libri i jetës

Pavarësisht nga këto, nuk mund të kapet shpirti frymëzues i Kur'anit, nëse nuk fillohet nga vënia në jetë e mesazheve të fituara, pasi Kur'ani nuk është libër idesh abstrakte, as libër enigmash fetare, që mund të sqarohen në shkollë të larta teologjike. Ai është një Libër që u është dërguar njerëzve për t'i ftuar ata në një lëvizje dhe t'i drejtojë ata drejt përmbushjes së misionit. Kështu njeriu duhet të shkojë në fushëbetejën e jetës për të marrë kuptimin e saj të vërtetë.

Është e qartë se nuk mund të kapim të vërtetat që përmban Kur'ani vetëm duke recituar fjalët e tij.



Për këtë duhet të marrim pjesë aktive në përplasjen mes besimit dhe mosbesimit, të vërtetës dhe gënjeshtërs. Mund ta kuptojmë atë vetëm nëse marrim Mesazhin e tij, i cili fton botën ta pranojë atë dhe të lëvizë vazhdimisht nën udhëheqjen e tij.



Argumente shkencore madhështore në historinë e profetit Nuh

Abstrakt

*Kur'ani nuk është si çdo libër tjetër. Nga ai njerëzit nxjerrin mësim. Një nga këto mësim është: Meqë Allahu i Gjithëfuqishëm shpëtoi Nuhun dhe besimtarët e popullit të tij, Ai, i Gjithëfuqishmi do t'i shpëtojë të gjithë besimtarët pa përjashtim. Allahu thotë: **“E, Ne pastaj i shpëtojmë të dërguarit tanë dhe ata që besuan. Kjo është detyra Jonë, t'i shpëtojmë besimtarët.”** (Sure Junus, 103) Për shumë vjet, njerëzit janë përpjekur të zbulojnë mekanizmin e rënies së shiut. Është zbuluar sekreti i shirave: atomet e avujve të ujit nga detet e oqeanet që ngrihen në lartësi të mëdha, ku temperatura është rreth zero, të cilat kondensohen për të formuar retë dhe më pas, shirat. Në kohën kur ka zbritur Kur'ani, askush nuk e njihje këtë të vërtetë. Në historinë e profetit Nuh ka shumë argumente. Qielli është një dëshmi për fuqinë e pakufishme të Allahut. Profeti Nuh përdorte një teknikë shkencore për ta ftuar popullin e tij të besonte në Allah, kur i urdhëronte të vështrojnë qiejt, Hënën dhe Diellin. Allahu thotë: **“A nuk e shihni se si Allahu ka krijuar shtatë qiej njëri përmbi tjetrin? (A nuk e shihni se Allahu) e ka bërë Hënën dritë dhe Diellin llambë?”** (Sure Nuh, 15-16) Shkenca e sotme ka provuar se Hëna pasqyron dritën e Diellit sepse nuk ka mundësi të ndriçojë si Dielli, i cili e ka këtë mundësi për të ndriçuar për arsye të nxehtësisë së stërmadhe dhe shpërthimit të tij të brendshëm bërthamor.*

Për shumë vjet, njerëzit janë përpjekur të zbulojnë mekanizmin e rënies së shiut. Është zbuluar sekreti i shirave: atomet e avujve të ujit nga detet e oqeanet që ngrihen në lartësi të mëdha, ku temperatura është rreth zero, të cilat kondensohen për të formuar retë dhe më pas, shirat. Në kohën kur ka zbritur Kur'ani, askush nuk e njihje këtë të vërtetë. Në historinë e profetit Nuh ka shumë argumente.



Shirat janë nga toka

Pas shirave të forta dhe daljes së burimeve, erdhi vërshima dhe i mbyti jobesimtarët dhe ateistët, por Allahu i Gjithëfuqishëm i shpëtoi profetin Nuh dhe besimtarët. Allahu thotë: ***“E, u pati thënë: ‘Oj Tokë, përpije ujin tënd! O qiell, ndërprite (shiu)! Dhe uji u tërhoq, urdhri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në (malin) Xhudij . E, u tha: Të shkatërruar qofshin njerëzit që janë zalimun (politeistë dhe keqbërës)!”*** (Sure Hud, 44)

Në këtë ajet ka një argument të madh për të vërtetat shkencore kur Allahu e urdhëroi Tokën ta përpinte ujin. Kjo do të thotë që uji shkon lart në qiell për të formuar shira dhe kthehet përsëri brenda në tokë.

Shpërthimi i burimeve

Në hidrologji ka një fakt shkencor se uji nën tokë është nën presion, por e rrethojnë shkëmbinjtë. Nëse rritet presioni, uji del menjëherë nga toka si një shpërthim. Shkencëtarët e përdorin fjalën *shpërthim* kur flasin për daljen e burimeve nga toka. Allahu thotë: ***“Populli i Nuhut e mohoi (të Dërguarin) e tij. Ata e përgënjeshtroan robin tonë (Nubun) dhe thanë: ‘I marrë!’ Dhe ai u qortua dhe u kërcënua me pafytyrësi. E, ai iu drejtua Zotit të vet: ‘Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!’ Dhe Ne i hapëm portat e qiellit me një shi të vrullshëm. Dhe, Ne bëmë që të shpërthejnë burime nga toka. Kështu, ujërat (e qiellit dhe të Tokës) u bashkuan për një çështje të paracaktuar. Dhe, Ne e bartëm atë (Nubun) në një anije të bërë me dërrasa dhe me gozhdë që lundronte nën Sytë Tanë, si shpërblim për atë që qe mohuar.”***

(Sure El-Kamer, 9 - 14)



Shpërthimi i furrës

Kur shohim që uji del sikur zien, do të thotë që burimi është duke shpërthyer. Në historinë e profetit Nuh, Allahu thotë:

“Kështu ndodhi derisa erdhi Urdhri Ynë dhe shpërtheu furra (uji si shatërvan). Ne i thamë: ‘Ngarko në të prej çdo krijese nga një çift; edhe familjen tënde, përveç atij për të cilin është marrë vendim i hershëm kundër tij; (merr) edhe këdo që ka besuar!’ Dhe, vetëm një pakicë i kishin besuar atij.” (Sure Hud, 40)

Dallgë si male

Allahu thotë: ***“Ajo (anija) lundronte me ta nëpër dallgë si male. E, Nuhu e thirri të birin, që rrinte veçuar diku: ‘O biri im! Hip (në anije) bashkë me ne e mos u bëj me jobesimtarët!’”*** (Sure Hud, 42)

Shprehja *“dallgë si male”* do të thotë se dallgët ishin shumë të larta. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se ka pasur stuhi dhe erëra të fuqishme. Ajo që thotë Kur’ani, ka të bëjë me lartësinë e dallgëve, që mund të kenë qenë qindra metra e ky është një tregues se çfarë ka ndodhur në atë histori, ka qenë e jashtëzakonshme.

Mësime nga historia e profetit Nuh

1. Kur’ani nuk është si çdo libër tjetër. Nga ai njerëzit nxjerrin mësim. Një nga këto mësimë është: Meqë Allahu i Gjithëfuqishëm shpëtoi Nuhun dhe besimtarët e popullit të tij, Ai, i Gjithëfuqishmi do t’i shpëtojë të gjithë besimtarët pa përjashtim. Allahu thotë: ***“E, Ne pastaj i shpëtojmë të dërguarit tanë dhe ata që besuan. Kjo është detyra Jonë, t’i shpëtojmë besimtarët.”*** (Sure Junus, 103)

2. Profeti Nuh ka qenë i duruar me njerëzit e tij kur i ka ftuar për 950 vjet të besonin në Allahun, si të vetmin Krijues. Allahu thotë: ***“Ai tha: ‘O Zoti im! Me të vërtetë, e kam ftuar popullin tim ditë e natë (për të pranuar doktrinën e monoteizmit islam).”***



Por, e tërë ftesa ime s'ka bërë asgjë, veçse të ikin (nga e Vërteta). Dhe, me të vërtetë, sa herë që unë them që Ti t'i falësh ata, ata zënë veshët me gishta, mbulohen me rrobat e tyre dhe ngulmojnë (në mobimin e tyre) dhe madhërojnë veten me mendjemadhësi.” (Sure Nuh, 5-7) Ashtu si Nuhu, edhe ne duhet të jemi të duruar me të tjerët kur i ftojmë për në Islam.

3. Profeti Nuh e paralajmëronte popullin e tij për Jetën e Përtejme dhe për dënimin e madh në Ditën e Gjykimit. Allahu thotë: *“Vërtet, Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet dhe ai tha: ‘O populli im, adhurojeni Allahun! Nuk keni zot tjetër, përveç Atij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një Ditë të Madhe.’”* (Sure El-A'raf, 59)

4. Profeti Nuh e këshillonte popullin e tij t'i kërkonte Allahut falje. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë:

“Unë u them atyre: ‘I kërkon falje Zotit tuaj sepse Ai është vërtet Falës! Ai do t'ju sjellë shi me bollëk dhe do t'ua shtojë pasurinë dhe fëmijët, do t'ju japë kopshte dhe lumenj.’” (Sure Nuh, 10-12) Pra, kush i kërkon falje Allahut, Ai, i Gjithëfuqishmi e fal.

5. Qielli është një dëshmi për fuqinë e pakufishme të Allahut. Profeti Nuh përdorte një teknikë shkencore për ta ftuar popullin e tij të besonte në Allah, kur i urdhëronte të vështronin qiejt, Hënën dhe Diellin. Allahu thotë: *“A nuk e shihni se si Allahu ka krijuar shtatë qiej njëri përmbi tjetrit? (A nuk e shihni se Allahu) e ka bërë Hënën dritë dhe Diellin llambë?”* (Sure Nuh, 15-16) Shkenca e sotme ka provuar se Hëna pasqyron dritën e Diellit sepse nuk ka mundësi të ndriçojë si Dielli, i cili e ka këtë mundësi për të ndriçuar për arsye të nxehtësisë së stërmadhe dhe shpërthimit të tij të brendshëm bërthamor.

6. Profeti Nuh iu lut Allahut t'i jepte fitoren mbi jobesimtarët dhe Allahu e urdhëroi atë të ndërtonte një anije që t'i shpëtonte atë dhe besimtarët dhe t'i fundoste jobesimtarët si ndëshkim për ateizmin dhe mosbesimin. Allahu thotë: *“E, Nuhut i qe shpallur: ‘Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre*



që kanë besuar (deri më tani). Pra, mos u brengos për atë që bëjnë ata! E, mbaroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me mësimin Tonë e mos m'u drejto Mua për ata që bënë keq! Ata, gjithësesi, janë të përmbytur.” (Sure Hud, 36-37)

7. Profeti Nuh nisi të ndërtonte anijen në fshatin ku nuk kishte det dhe kështu, populli nisi ta përqeshte. Allahu thotë: *“Dhe, ai ndërtonte anijen e paria e popullit të tij, sa herë që kalonte pranë tij, tallej me të. Ai u thoshte: ‘Në qoftë se talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju. Dhe më vonë do ta kuptoni se cili do të ketë dënimin e turpshëm dhe mbi cilin do të jetë dënimi i përjetshëm.’”* (Sure Hud, 38-39)

8. Allahu i Gjithëfuqishëm i dha profetit Nuh një shenjë për t'u përgatitur për t'u larguar. Shenja ishte uji si shatërvan që nisi të gufonte nga toka. Allahu thotë: *“Ngarko në të prej çdo krijese nga një çift; edhe familjen tënde, përveç atij për të cilin është marrë vendim i hershëm kundër tij; (merr) edhe këdo që ka besuar! Dhe vetëm një pakicë i kishin besuar atij.”* (Sure Hud, 40)

9. Kur filloi uji të gufonte nga toka, profeti Nuh e kuptoi se kishte zbritur urdhri për të lëvizur. Për këtë arsye, ai i urdhëroi njerëzit e tij të hipnin në anije. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: *“Dhe ai tha: ‘Hipni në të: Me emrin e Allahut, ajo lundron dhe ndalet. Vërtet, Zoti im është shumë Falës, më i Mëshirshmi.’”* (Sure Hud, 41) Prandaj, ne myslimanët duhet ta fillojmë çdo veprim duke thënë: *“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.”*

10. Allahu i Gjithëfuqishëm i urdhëroi shirat të binin dhe burimet të shpërthenin e kështu, nisi përmbytja. Allahu i Gjithëfuqishëm e përshkruan skenën duke thënë: *“Dhe, Ne i hapëm portat e qiellit me një shi të vrullshëm. Dhe, Ne bëmë që të shpërthejnë burime nga toka. Kështu, ujërat (e qiellit dhe të Tokës) u bashkuan për një çështje të paracaktuar.”* (Sure El-Kamer, 11-12)



11. Nuhu ishte profet i Allahut, kurse i biri ishte jobesimtar dhe nuk iu bind të atit, por iu bind ateistëve dhe jobesimtarëve, edhe pse i ati i tha të shkonte me të në anije. Allahu për këtë thotë: ***“Kështu, ajo (anija) lundroi me ta midis dallgëve si male. Dhe, Nuhu i thirri të birit që ishte veçuar diku: ‘O biri im, hip bashkë me ne e mos u bëj me mohuesit!’ Ai (djali) u përgjigj: ‘Unë do të ngjitem në një mal që do të më shpëtojë nga uji.’ Nuhu i tha: ‘Këtë ditë nuk ka të mbijetuar nga dënimi i Allahut, përveç atij që Allahu e ka mëshiruar.’ Dhe, dallgët hynë mes atyre të dyve dhe ai (djali) që midis të mbyturve.”*** (Sure Hud, 42-43)

12. Shirat ndaluan. Ndaluan edhe shpërthimet e burimeve. Toka nisi të thithte ujin. Anija u ndal në një mal që quhej Xhudij. Allahu thotë: ***“E, u pati thënë: ‘Oj Tokë përpije ujin tënd! O qiell, ndërprite (shium)!’ Dhe uji u tërhoq, urdhri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në (malin) Xhudij e u tha: ‘Të shkatërruar qofshin njerëzit që janë zalimun (politeistë dhe keqbërës)!’”*** (Sure Hud, 44) Ky është fundi i politeistëve dhe i keqbërësve.

13. Pasi mbaroi përmbytja, profeti Nuh kujtoi të birin që u mbyt bashkë me të tjerët dhe iu lut Allahut. Allahu, për këtë, thotë: ***“Dhe Nuhu iu lut Zotit të tij: ‘O Zoti im! Vërtet, djali im është nga familja ime dhe sigurisht, premtimi Yt është i Vërtetë dhe Ti je Gjykatësi më i Drejtë.’”*** (Sure Hud, 45) Por, Allahu e paralajmëroi Nuhun duke i thënë se i biri kishte qenë jobesimtar. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: ***“(Ai) tha: O Nuh! Sigurisht, Ai (djali) nuk është nga familja jote; ai është punëkeq; prandaj, mos më kërko Mua atë që nuk e di! Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga të paditurit.”*** (Sure Hud, 46) Tashmë, profeti Nuh e kuptoi se kishte bërë kërkesë të gabuar dhe u pendua e iu lut Zotit ta falte. Allahu thotë:

“Nuhu tha: ‘O Zoti im! Unë mbështetem në mbrojtjen Tënde nga ajo që të kërkoja, për të cilën nuk kam dije. Dhe, në qoftë se nuk më fal dhe nuk më mëshiron, unë do të jem vërtet nga humbësit.” (Sure Hud, 47)



14. Në fund, Nuhu i lutet Allahut me një lutje të madhe. Allahu na flet për këtë lutje të mrekullueshme. Allahu thotë: ***“(Nuhu tha): O Zoti im, më fal mua, fali prindërit e mi dhe atë që hyn në shtëpinë time si besimtar dhe të gjithë besimtarët dhe të gjitha besimtarët! Dhe zalimunëve (politeistëve, keqbërësve dhe jobesimtarëve) mos u jep asgjë, përveç shkatërrimit!”*** Edhe Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thoshte vazhdimisht: ***“O Zoti im! Më fal mua, fali edhe prindërit e mi dhe bekoji ata sepse janë kujdesur kur kam qenë fëmijë!”*** A nuk duhet t'i pasojmë këta profetë të mëdhenj? Allahu, për këtë, thotë: ***“Vërtet, në historitë e tyre (e të Dërguarve dhe të Profetëve) ka mësim për njerëzit që kuptojnë. Ai (Kur’ani) nuk është Libër i sajuar, por Vërtetues (i Librave të mëparshëm të Allahut - të Teuratit, Ungjillit dhe të Shkrimeve të tjera të Shenjta të Allahut) dhe Sqarues i hollësishëm i gjithçkaje dhe Udhërrëfyes e Mëshirë për njerëzit që besojnë.”*** (Sure Jusuf, 111)

E përktheu nga gjuha angleze: **Bledar Shehu**



Dr. M. Nurbaki

Ekulibri delikat i jetës në Tokë

Abstrakt

“Ne e kemi shtruar Tokën dhe në të kemi vënë male të fortë e të palëvizshëm dhe kemi prodhuar aty gjithçka me një ekulibër harmonik.” (El-Hixhr, 9)
Duhet të ekzistonte një kompjuter i Allahut që të mund të përcaktonte sasinë e bimëve të nevojshme për thithjen e tymrave të oxhaqeve dhe prodhimin e oksigjenit, që konsumojnë njerëzit dhe për sigurimin e oksigjenit të nevojshëm në ajër. Kjo llogaritje e pabesueshme është vetëm e Allahut. Kur’ani shpall: “Çfarë është krijuar në Tokë, i është nënshtruar një ekuilibri të saktë.” Ky mesazh diturie na vjen që para 14 shekujsh, kur asnjë prej këtyre fakteve nuk ishte i njohur.

“Ne tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vënë male të fortë e të palëvizshëm dhe prodhuam aty gjithçka në një ekulibër harmonik.” (Sure El-Hixhr, 159)

Është e vështirë që në leximin e parë, të kuptosh mesazhin që përmban ky ajet. Përshkrimi shkencor i dhënë në të për krijimin e Tokës është një sfidë për ata që e shohin krijimin e saj si asgjë më tepër se një aksident në univers. Ne e kemi përshkruar gjetkë zinxhirin e mrekullive të Zotit në ndërtimin e strukturës së Tokës. Pjerrtësia 23.5 gradë e boshtit të saj është një çështje njehësimi aq delikate, sa nuk mund të parallogaritet as nga fizika e as nga fizolofia. Për shembull, në qoftë se kjo pjerrtësi do të ishte 25 gradë, vetëm në pak qindra vjet akulli i poleve do të shkrinte dhe oqeanet do të mbuloheshin prej tij. Nga ana tjetër, në qoftë se pjerrtësia do të ishte 22 gradë akulli arktik do të pushtonte gjithçka. Jeta do të ishte e mundur vetëm në zonat ekuatoriale të Tokës. I Gjithëpushtetshmi e thekson këtë zbulim të rëndësishëm



në fillim të ajetit të shenjtë, ku përshkuan shtrirjen kudo të një rregullsie të përkryer. Kjo rregullsi e përgjithshme është e lidhur ngushtë dhe me rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj çdo 24 orë. Në qoftë se ky rrotullim do të kryhej në 30 orë, do të frynin erëra kaq të fuqishme, sa toka do të ishte bërë një shkretëtirë e pabanueshme. Në të kundërtën, në qoftë se toka do ta kryente rrotullimin e saj çdo 20 orë, shumë bimë nuk do të ishin në gjendje të kryenin veprimtarinë e tyre biologjike dhe do të bëheshin fli thatësisë. Shtrirja kudo e rregullit të përmendur në pjesën e parë të vargut të shenjtë është e vlefshme dhe për rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj me një pjerrtësi harmonike. Ky rezultat, nëse ndonjëherë do t'i lihej rastësisë do të mund të përftohej vetëm mbas miliona provash. Meqë zinxhiri është lidhur në këtë mënyrë, është e domosdoshme që përmbajtja e oksigjenit në ajër të mbetet afërsisht 20 %. Ky është momenti më delikat. I gjithë tymi dhe dioksidi i karbonit që kthehet nga bimët në oksigjen do të duhej një kompjuter për të llogaritur numrin e bimëve që duhen për të mbajtur masën e oksigjenit në ajër në sasinë 20%.

Duhet të ekzistonte një kompjuter që të mund të përcaktonte sasinë e bimëve të nevojshme për thithjen e tymrave të oxhaqeve dhe prodhimin e oksigjenit, që konsumojnë njerëzit dhe për sigurimin e oksigjenit të nevojshëm në ajër. Kjo llogaritje e pabesueshme mund të quhet vetëm si një llogari e Zotit. Kur'ani shpall: "Çka është krijuar në tokë, i është nënshtruar një ekuilibri të saktë." dhe ky mesazh diturie na vjen që para 14 shekujsh, në një kohë kur asnjë prej këtyre fakteve nuk ishte i njohur.

Miliona vjet më pare, një bimësi e madhe mbuloi Tokën. Qëllimi i saj ishte rritja e sasisë së oksigjenit në atmosferë. Dinosaurët, kafshët që përfitonin nga kjo bimësi, endeshin në tokë. Më në fund, raporti i oksigjenit filloi ta kapërcente 20%. Konsumi i bimëve prej dinosaurëve dhe nxjerrja e dioksidit të karbonit prej tyre, nuk ishte më në gjendje të balanconte prodhimin e madh të oksigjenit nga bimët.

Në këtë kohë ndodhi një ndryshim i madh dhe i menjëhershëm gjeologjik, si pasojë e të cilit flora dhe dinosaurët e zhdukën



nga faqja e dheut. Më pas, Zoti krijoi peshqit, zogjtë dhe gjetarët në të njëjtën kohë, (kjo është hipoteza më e vonë që tashmë është në fuqi dhe ka ndikuar edhe tek evolucionistët më këmbëngulës). Ashtu siç na e bën të qartë dhe ajeti, sasia e bimëve në Tokë është në një ekuilibër kaq harmonik sa që një pemë është caktuar për pastrimin e atyre ç'ka nxjerr një oxhak tymues. Njeriu, duke përfshirë edhe ata të cilët mendojnë se besojnë, është kaq i pavëmendshëm sa ai kurrë nuk mund t'i kuptojë këto llogaritje delikate të të Gjithëditurit, ndaj s'mund ta kuptojë menjëherë sekretin e Krijuesit të Botëve. Respekti, që tregohet për pemët në Islam dhe rëndësia që i kushtohet mbjelljes së pemëve të reja, përforcon faktet e mësipërme.

Më lejoni tani që t'ju paraqes disa llogaritje të tjera të pabesueshme. Pothuajse për çdo sëmundje, Zoti ka krijuar një bimë ose mikrob, (apo produkte të aktivitetit të tij biologjik), si mjekim. Si mundet një i paditur, pa patur asnjë provë, ta quajë këtë sistem një rastësi! Pasi krijoi Tokën dhe vendosi në të qëniet njerëzore, Zoti krijoi në laboratorët e natyrës ilaçet botanike dhe bakteriale për të gjitha sëmundjet.

Në botë ka mjaft bimë lulemustaku, që shërbejnë për të mjekuar të gjithë njerëzit që vuajnë nga zemra. Gjithashtu, ka mjaft bimë hashashi për të lehtësuar vuajtjet e mëdha të sëmundjeve, megjithëse ilaçi i kësaj bime nën presionin e të pa ndërgjegjshmëve është bërë mall i tregut të zi dhe përdoret për të sjellë kënaqësi dhe fitime nga grupe të caktuara njerëzish.

Një shembull tjetër i ekuilibrit harmonik: Deri njëqind vjet më parë, druri si lëndë djegëse, plotësonte nevojat e njeriut për ngrohje dhe energji. Në qoftë se nuk do të ishte zbuluar qymyrguri dhe nafta, pyjet nuk do të ekzistonin në Tokë. Por në momentin e duhur Zoti dha qymyrgurin dhe më pas naftën. Por, fatkeqësisht njeriu rob i mëndjemadhësisë së tij e ka kthyer naftën në një burim konfliktesh për luftra të përgjakshme.

Le të shohim tani ekuilibrin e saktë të metaleve që ndodhen në Tokë.



Ne nuk i dimë raportet e metaleve që përbëjnë bërthamën qëndrore të Tokës dhe as përbërjen e pjesës së lëngshme, që e rrethon atë. Por në sipërfaqen e banuar nga njeriu, elementët janë shpërndarë në raporte të tilla, që duket sikur një komitet shkencor, pasi ka miratuar numrin, raportet e këtyre elementeve, ka bërë të mundur prodhimin e tyre në një fabrikë jashtëzakonisht të fuqishme. Çdo substancë është e pranishme në koren e Tokës, në atë masë që ka nevojë niveli i jetës në Tokë. Përzierjet e silicit, hekurit e kalciumit, janë lëndët bazë për ndërtimin e banesave. Sikur edhe njëra prej tyre të mungonte, ne nuk do të kishim qytete.

Deri pak kohë më parë ne nuk dinim se ç'përmbajtje kishte uji. Sot ne dimë se bikarbonati i kalciumit në ujë është organizatori më i mirë i tretjes së ushqimit. Lëndë të tilla jetësore si kripa janë përhapur në tokë në raporte të tilla që njeriu ka arritur t'i krijojë vetëm në një laborator biologjik modern.

A keni menduar ndonjë herë se procesi i avullimit të ujit të detit dhe kthimi përsëri i tij në të me anë të lumenjve ndodh prej miliona vjetësh? Gjatë këtij procesi transportohen nga toka në det substanca të reja dhe megjithatë përbërja e ujit të detit nuk ndryshon kurrë. Vëreni madhështinë e kësaj mrekullie të kompjuterit të Zotit: Ndodhin miliona procese dhe megjithatë ekuilibri harmonik, që në saje të Zotit qëndron në themel të krijimit të gjithçkaje në Tokë, nuk ndryshon kurrë.

U rikthehemi metaleve. Emra të tillë si berilium, uranium, cadmium, tungsten, tantalum dhe gallium janë dëgjuar vetëm këto 150 vjetët e fundit. Kur u zbulua fillimisht, secili i konsideroi ato thjesht si një kuriozitet laboratorik. Vetëm më vonë u kuptua se ato ishin blloqet e nevojshme për krijimin e një teknologjie të përparuar. Nga përdorimi i energjisë atomike të aktiviteteve teknologjike në temperatura të larta, secili prej këtyre metaleve paraqet disa veçori thelbësore. Prania e tyre në Tokë është në pajtim me rolin, që ishte përcaktuar të luanin.

Një nga mrekullitë më të mëdha të planetit Tokë, me të cilin i Plotfuqishmi e pajisi atë përpara se të krijonte njeriun, janë substancat radioaktive, që gjenden në sipërfaqen e Tokës në



raporte aq të përsosura, sa që nuk mund t'i krijojë as shkenca. Nga njëra anë gjendet uranium-235, që siguron energjinë bërthamore, i padëmshëm në gjendje natyrale, por i rrezikshëm kur pastrohet. Nga ana tjetër, karboni-14 bën të mundur aktivitetin biologjik. Dhe sa të mrekullueshme janë llixhat, ujrato e të cilave përmbajnë sasira të lejueshme substancash radioaktive dhe kurojnë miliona njerëz në të gjithë botën.

Le ta shohim çështjen në një këndvështrim tjetër. Në qoftë se uraniumi do të ishte i pranishëm në Tokë vetëm në formën e izotopit të uraniumit-235, bota do të ishte shkatërruar shumë pak kohë pas krijimit të saj. Nga ana tjetër, në qoftë se uranium-235 nuk do të ishte i pranishëm në masën 0.7% në uraniumin-235, ne nuk do të mund të përfitonim energjinë atomike. Zoti i ka dhënë një veti të tillë uraniumit-235 që ai mund të kthehet në fuqi bërthamore, vetëm kur është i ndarë dhe nuk paraqet rrezik në matricën e tij natyrale, në uraniumin-238.

Shumë procese biologjike nuk mund të kryhen pa praninë e karbonit-14 në atmosferë. Në qoftë se kjo substancë, raporti i së cilës është një për milion, do të rritej sado pak, do të përbënte një rrezik vdekje-prurës. Në qoftë se izotopi natrium-24 do të ishte i pranishëm në ujërat minerale, larja në këto ujëra do të ishte njësoj sikur të ishte i pranishëm në Hiroshimë, ditën kur u hodh bomba atomike. Megjithatë, substanca kryesore në ujërat minerale është natriumi, izotopet e të cilit, përveç natrium-24, janë mbizotëruese. Në të vërtetë, ne nuk mund të pushojmë së komentuari këtë varg të shenjtë. Po të bëjmë këtë, do të duhet të shkruajmë volume të tëra.

“Ne kemi krijuar çdo gjë në Tokë në ekuilibër dhe në raporte të sakta.”



Prof. Hani El-Mubarek
Dr. Sheuki Ebu Halil

Astronomia

Abstrakt

Arabët e vjetër, të cilët banuan në hapësirat e Mesopotamisë (lumi Tiger dhe Eufrat) dhe të lumit Nil, janë prej popujve më të lashtë, që u popullorizuan me njohuritë kozmike. Indianët dhe grekët i morën ato njohuri prej tyre. Vul Djurant thotë: “Astronomia ishte shkencë me të cilën u shquan babilonasit dhe me të u popullarizuan në tërë botën e vjetër”. Mirëpo, babilonasit e studiuan qëllimin dhe u interesuan për të, që të bëheshin astrologë, me qëllim që të parashikonin të ardhmen përmes lëvizjes së yjeve. Si rezultat i studimeve, përvojave dhe vërtetimeve të tyre, ata arritën deri në njohuri të shumta astronomike. Kështu, që 2000 vjet p.e.s. ata kanë shënuar me saktësi lindjen dhe perëndimin e yllit të mëngjesit në raport me Diellin. Ata përcaktuan pozicionet e shumë yjeve. Babilonasit qenë të parët që dalluan qartë yjet statikë prej yjeve të lëvizshëm; ata përcaktuan datën e Tropikut të Cjapit (dimrit) dhe Tropikut të Gaforres (verës) dhe të barasditës së pranverës dhe të vjeshtës. Ata e ndanë vitin në 12 muaj.

Arabët e vjetër, të cilët banuan në hapësirat e Mesopotamisë (lumi Tiger dhe Eufrat sh.p.) dhe të lumit Nil, janë prej popujve më të lashtë të cilët u bënë të njohur me dijet kozmike dhe ato njohuri hindusët dhe grekët i morën prej tyre. Vul Djurant thotë: “Astronomia ishte shkencë me të cilën u shquan babilonasit dhe me të u popullarizuan në tërë botën e vjetër.” Mirëpo, babilonasit e studiuan qëllimin dhe u interesuan për të, që të bëheshin astrologë, me qëllim që të parashikonin të ardhmen përmes lëvizjes së yjeve. Si rezultat i studimeve, përvojave dhe vërtetimeve të tyre, ata arritën deri në njohuri të shumta astronomike.



Kështu, ata që 2000 vjet p.e.s. kanë shënuar me saktësi lindjen dhe perëndimin e yllit të mëngjesit në raport me Diellin. Ata përcaktuan pozicionet e shumë yjeve. Babilonasit qenë të parët të cilët i dalluan yjet statikë prej yjeve të lëvizshëm në mënyrë precize; ata e përcaktuan datën e tropikut të cjaipit (dimrit) dhe tropikut të gaforres (verës) dhe të ekuinoksit të pranverës dhe të vjeshtës. Ata e ndanë vitin në 12 muaj. Edhe përkundër përparimit të egjiptianëve në shumë sfera të civilizimit, ata në njohuritë astronomike nuk arritën atë që kishin arritur babilonasit. Për këtë tregon Vul Djurant, kur thotë: “Në këtë shkencë, në përgjithësi, ata (egjiptianët) ishin më mbrapa prej bashkohësve të tyre në tokën e dy lumejve.” Zigrig Honke gjatë bisedës së saj mbi astronominë dhe astronomët, thotë: “Astronomia te grekët ka qenë shkencë teorike (spekulative) rationale universale, larg metodës eksperimentale (empirike) në plotkuptimin e fjalës. Babilonasit përparuan me shquarjen e tyre praktike empirike. Në vitin 500 p.e.s. arritën në skicimin e kupës së dukshme të qiellit në formë teknike (arkitektonike) dhe skicimin e hartës së kozmosit në formë të rrumbullakët, në mes të së cilës qëndron Toka. Pastaj, shkencëtari grek Eristarikhfon Samusi, në shekullin 3 p.e.s. e vuri Diellin në vend të Tokës, në mes të hartës së kozmosit.” Po ashtu, shton se prej motiveve të mburrjes së arabëve ka qenë që të kontribuojnë në zhvillimin e astronomisë. Kur erdhi Islami, ajetet e Kur’anit iu qasën disa çështjeve si astronomia, gjë që e shtoi interesimin e myslimanëve për këtë shkencë.

Prej këtyre ajeteve është fjala e Allahut:

“Ai e bëri Diellin shndritës, e Hënë dritë dhe asaj (Hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë...”

(Sure Junus, 5); ***“...dhe nënshtroi Diellin e Hënë që çdo njeri të udhëtojë deri në një afat të caktuar...”*** (Sure Er-Rra’d, 2); ***“A nuk e dini se Allahu e fut (errësirën) natën në ditë, fut (dritën) në natë, i nënshtroi Diellin e Hënë (të lindin e të perëndojnë) dhe secili rrjedh (noton) deri në një afat të caktuar dhe se Allahu është i njohur hollësisht për atë që veproni.”***

(Sure Lukman, 29);



“Edhe Dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar), Ai është (udhëtim) përcaktimi i Ngadhënjyesit, i të Diturit. Edhe Hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut. As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën e as nata para ditës, po secili noton në një galaktikë.” (Sure JaSin, 38-40); ***“Ai krijoi qiejt e Tokën me qëllim të caktuar. Ai natën ia mbështjell (vendit të) ditës dhe ditën ia mbështjell natës. Ai nënshtroi Diellin dhe Hënën, që secili lëviz deri në një afat të caktuar, pra, Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi.”*** (Sure Ez-Zumer, 5); ***“A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej (në kate). Dhe në ta Hënën e bëri dritë, Diellin e bëri ndriqes.”*** (Sure Nuh, 15-16)

Po ashtu, kësaj i shtohet edhe lidhja e fortë e cila ka qenë mes disa dukurive galaktike dhe disa adhurimeve islame si, përcaktimi i pesë kohëve të namazit, përcaktimi i muajit të agjërimit, përcaktimi i ditës së qëndrimit në Arafat gjatë kohës së Haxhit, namazi që falet me rastin e zënies së Diellit dhe të Hënës, përcaktimi i drejtimit të Kibles (Qabes) në vendet e ndryshme të anëve të botës... E tërë kjo çoi në shtimin e interesimit të myslimanëve për njohuritë galaktike, për studimin në komentimin dhe sqarimin e domethënive të ajeteve të lartpërmendura kur'anore dhe zgjerimin në atë që është përmendur në to prej çështjeve lidhur me Diellin, Hënën dhe yjet. Përparimi i madh i njohurive astronomike nga ana e shkencëtarëve myslimanë, si rezultat i motiveve shpirtërore dhe i lidhjes së ngushtë mes disa ibadeteve dhe çështjeve galaktike, nuk e ndaloi lulëzimi e astrologjisë krahas astronomisë, saqë disa kalifë (udhëheqës shteti) mbështeteshin në astrologët e mëdhej të kohës së tyre që t'u profetizonin për çështje të cilat u interesonin, siç ishte rasti me Ebu Xhafer el-Mensurin dhe astrologun persian Nubehtin dhe birin e tij.

Në epokën emevite dhe abasite, në gjuhën arabe u përkthyen librat e astronomisë persiane, hinduse dhe greke. Studimet astronomike filluan të përparonin nga ana e shkencëtarëve myslimanë, të cilët i përmirësuan njohuritë e mëparshme astronomike si rezultat i studimeve dhe i eksperimenteve të tyre.



Prej kësaj ishte edhe përmirësimi i gabimeve të cilat i bëri Batlimosi në librin e tij “*El Maxbest*”. Në periudhën abasite, prej shkencëtarëve të astronomisë u popullorizua Musa Ibn Shakiri dhe djemtë e tij: Muhamedi, Ahmedi dhe Hasani; prej tyre po ashtu, është Muhamed Ibn Xhabir el-Harrani el-Bettani (vdiq v.317 h / 929 e.s.), i cili ka libra, zbulime dhe instrumente në fushën e astronomisë. Lalade, një prej astronomëve francezë, thotë për të: “El-Bettani është një prej njëzet astronomëve të shquar, të cilët dolën në tërë botën.” El-Bettani thotë: “Për çdo njeri është detyrim që ta njohë astronominë, siç është detyrim për myslimanin që të ketë njohuri për çështjet dhe ligjet fetare, sepse astronomia çon në argumentin e njëshmërisë së Allahut, në njohjen e Madhërisë së Tij, të Urtësisë së Tij, të Fuqisë së Tij të madhe dhe përkryerjes së krijesave të Tij.” Në këtë kuptim ka aluduar edhe Zigrid Honke duke thënë: “Interesimi i myslimanëve për dukurinë e Qiellit ka qenë maksimalisht i domosdoshëm, madje, më i domosdoshëm se sa vetë ushqimi ditor.” Prej astronomëve, po ashtu është edhe Ibrahim ez-Zurkali (vdiq në vitin 480 h/1087 e.s.). Ky është astronom spanjoll, i cili ka gëzuar autoritet botëror. Konsiderohet shkencëtari më i madh në kohën e vet, i cili i ka soditur yjet. Ai shpiku astrolab të ri i cili u quajt me emrin Pllaka e llamarintë e Zurkalit. Po ashtu, mori pjesë në vënien e parimeve të tabelave të Toledos të cilat u njohën me emrin tabelat astronomike të Toledos. Mbreti Kashtale urdhëroi që të përktheheshin të gjitha veprat e Zurkaliut në gjuhën e vendit dhe përkthimin e tabelës së tij në të cilën u bazuan më pas të gjithë astronomët e Europës. Prej dijetarëve të astronomisë është edhe Abdurrahman es-Sufi (vdiq 376 h / 986 e.s.), i cili ka përpiluar harta për yjet, në të cilat përmend mbi një mijë yje dhe për shkak të meritave të tija shkencore, emri i tij iu vu një qendre mbi sipërfaqen e Hënës. Prej tyre, po ashtu, është edhe Ebu-l-Vefa el-Buzexhani (vdiq në vitin 388 h / 988 e.s.). Ky është Muhamed Ibn Jahja, një prej dijetarëve të rrallë në astronomi dhe matematikë. Udhëtoi prej Buzexhani, afër Nejsaburit dhe u vendos në Bagdad. Atij i atribuohet zbulimi i ndryshimit dhe i lëvizjes së Hënës.



Prej atyre, po ashtu, është edhe Ibn Junus el-Misrij (vdiq në vitin 399 h / 1009 e.s.), i cili u dallua me shoqërimin e sundimtarit fatimit. Ai ishte përgjegjës për vëzhguesin e tij në malin el-Mukattam dhe autor i librit të tabelës vendimtare astronomike, që njihet me emrin “Tabela astronomike e Ibn Junusit”. Ajo ka katër vëllime. Në të, ai i përmirësoi gabimet e përpiluesve të tabelave astronomike të cilët i paraprinë atij. Gustav Leboni për të thotë se si ai me këtë bëri që të harrohet çdo tabelë astronomike në botë e përpiluar para tij. Disa kapituj të kësaj table janë përkthyer në frëngjisht. Ai ka shkruar edhe libra të tjerë, e prej tyre janë: tabelat e Zenitit, tabela për Diellin, për Hënën dhe të tjera. Po ashtu, përveç këtyre, ka edhe dhjetra emra prej dijetarëve të shquar të astronomisë. Disa prej tyre kanë bërë zbulime astronomike të cilat kondiserojnë triumf madhështor dhe përparim në fushën e kësaj shkence pas fillimit të shumicës së tyre për veprimet e soditjes së qiellit me Diellin, Hënën, yjet dhe planetet e tij dhe ngritjes së vëzhguesve për këtë qëllim në qytetet e mëdha të territoreve arabe dhe islame, prej të cilëve, më të njohura ishin ato në Damask, Bagdat, Kajro, Merakesh, Kordobë, Sevilje dhe Semerkand. Prej këtyre vëzhguesve, më i njohuri ishte ai, të cilin e themeloi dhe e mbikëqyri Nasirudin Et-Tusi, i cili njihet me emrin vëzhguesi Ilhan në Meraga - në rajonin e Azerbejxhanit Iranian - edhe atë në vitin 657 h / 1258 e.s. Ky vëzhgues u popullorizua me instrumentet e tij precize dhe me shkencëtarët me përvojë të gjerë të cilët punonin në të. Prej vëzhguesve më të njohur janë edhe vëzhguesi i El-Bettanit në Er-Rakka dhe ai i Ed-Dejnuri në Isfahan (Iran). Orientalistja gjermane Zigrid Honke, në këtë plan thotë: “Arabët maksimalisht u interesuan për instrumentet astronomike, kurse ajo që ata e trashëguan prej grekëve, ishte primitive dhe e pafuqishme që t’u ndihmojë atyre në garën e tyre drejt famave të cilat ia skicuan vetes. Për këtë, i përsosën ato, u shtuan gjëra të shumta dhe ofruan zbulime të cilat u ngjajnë mrekullive. Ato i mori Perëndimi prej tyre dhe i përdori për një kohë të gjatë.” Prej vëzhguesve të njohur arabe, janë përmendur edhe ai i Me’munit në Bagdat, ato të dy kalifëve fatiminj,



el-Aziz dhe el Hakim bi Emril-lah në Kajro, ai i Adudu-deule në kopshtin e pallatit të tij në Bagdad, vëzhguesi i Melikshah es-Selxhukit në Nejsabur në lindje të Iranit, ai i Holakut në Meraga. Ky është vëzhguesi të cilin e përmendëm më parë. Si mbikëqyrës të tij, Holaku caktoi matematikent dhe astronomin Nasirudin et-Tusi (vdiq në vitin 673 h / 1274 e.s.). Ky është ai, i cili e bindi Holakun që të caktonte një shumë të madhe pasurie për këtë vëzhgues, që u bë institut dhe qendër për studime kozmike. Biblioteka e tij përmbante afër 400 mijë vëllime, pjesa më e madhe e të cilave u sollën prej bibliotekave të Bagdadit, Damaskut, Teflisit, Mosulit dhe i vendeve të tjera. Ky vëzhgues apo institut u bë i mirënjohur. Ai u pajis me aq instrumente astronomike, sa që magjepsë vizituesi nga instrumentet dhe mundësitë astronomike të cilat i gjente në të. Dr. Abdul-Hamid Semaha, në një universitet amerikan thotë: “Nuk e teproj nëse e konsideroj se merita e arabëve në interesimin e tyre për vëzhguesit astronomike dhe për mbajtjen e saktësisë në to, si dhe shpikjes së instrumenteve të duhura për të, është i barabartë me meritën e tyre në ruajtjen e trashëgimisë shkencore të të vjetrave në këtë fushë.” Më pas, do të shohim se zbulimet astronomike kanë qenë dhe janë fryte të vëzhguesve. Ato vazhdojnë të ecin krah për krah me evoluimin (përkryerjen) e mjeteve të soditjes. Shumë prej shkencëtarëve të Lindjes dhe të Perëndimit arabë dhe joarabë, myslimanë dhe jomyslimanë kanë shkruar për rolin e shkencëtarëve arabë dhe myslimanë në përparimin e civilizimit njerëzor dhe për rolin e tyre në ndërtimin e qytetërimit evropian. Studiuesit e kësaj teme e shohin rolin e madh të arabëve në veçanti dhe të myslimanëve në përgjithësi në fushën e zhvillimit të astronomisë. Të shumtë janë ata që thanë se shkencëtarët arabë janë ata të cilët ua pregatitën rrugën të ngjashmëve si, Kopernikut dhe Keplerit. Duke u kthyer në atë që e kanë shkruar shkencëtarët arabë dhe myslimanë në fushën e astronomisë dhe atë që shpikën prej instrumenteve, zbulimeve, studimeve dhe eksperimenteve të cilat e konfirmojnë këtë, sukseset e tyre astronomike dhe rezultatet e tyre ende janë të pranishme në Perëndim. Për to shkruajnë shkencëtarët objektivë



dhe ata i artikulojnë gjuhët poetike, kështu që gjejmë shumë fjalë arabe në emrat e shumë yjeve, planetëve dhe termave astronomike.

(në gjuhën arabe)

Benatu Na'sh
Bejtu-l-xheuza' ve ibtu-l-xheuza'
Edh-Dheneb
Ed-Dubbetu
Et-Tenin
El-Ferkedan
Femu-l-hut
Kalbul Akreb
El-Keukeb
El-Merkeb
Re'su-l-xhadij
El-Xhebar
El-Xhedij
El-Xhanib
El-Gul
El-Gurab
El-Ferd
El-Feta
Et-Tair
Eth-Theur
Batnu-l-hut

(në gjuhët europiane)

Beneth-Nasch
Bete i Geuse
Denab
Dubhe
Etainin
Farcadin
Fomal Haut
Kalbol Acrab
Kochab
Markab
Rasul Gethi
Algebar
Algedi
Algenib
Algol
Al Gorab
Alpeheraz
Alpheta
Al-Tair
Ataur
Baten-Kaitos



Dr. Hussein Riduan Al-Lubaidy

Ndërtimi i trurit në dritën e Kur'anit fisnik

Abstrakt

Bota nuk ka qenë e vetëdijshme për asgjë në lidhje me ndërtimin e tërësishëm dhe kompleks të trurit. Kohët e fundit ka filluar t'i studiojë zonat e trurit të njeriut përgjegjëse për dëgjim, të parë, ndjenja dhe vendosmëri. Kjo ka ndodhur më shumë se një mijë vjet pas vdekjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Truri ka zona të lidhura me emocionet dhe shqisat. Ai dëgjon dhe e kupton atë që dëgjon dhe vepron. Ai sheh dhe kupton atë që sheh dhe vepron. Dëgjimi dhe shikimi orientohen nëpërmjet këtij veprimi. Ky kuptim i thellë nuk ekziston në makinat e përparuara që janë të mbajtura me potenciale të mëdha input dhe output, shënimeve hyrëse dhe dalëse. Sado që këto makina janë të sofistikuar, prapëseprapë mbesin trupa pa jetë të privuara nga emocionet dhe ndjenjat e përgjegjësitë.

Tërë bota nuk ka qenë e vetëdijshme për asgjë në lidhje me ndërtimin e tërësishëm dhe kompleksiv të trurit. Bota filloi në kohën e fundit t'i studiojë zonat e trurit të njeriut përgjegjëse për dëgjim, të parë, ndjenja dhe vendosmëri. Kjo ndodhi më tepër se një mijë vjet pas vdekjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Çfarë do të ishte komenti i bashkësisë ndërkombëtare të intelektualëve nëse të njëjtët studiues zbulojnë hartën gjithëpërfshirëse anatomike dhe ndërtimin funksional të zonave të larta komanduese të trurit të njeriut, ashtu siç është cekur në Kuranin fisnik?



Nuk ka dyshim, se përgjigjja logjike është: Ky do të jetë argument shkencor i saktësisë së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe mesazhit të tij, si dhe argument i pakontestuar se Kurani fisnik është e vetmja mrekulli e përhershme e mbetur, e cila ka ngecur që tërë njerëzimi ta pasojë dhe që të jetë ligj për ata që dëshirojnë ta pasojnë rrugën e drejtë. T'i zbulojmë, pra, fshehtësitë e trurit të njeriut (burimin e civilizimit dhe organit i cili njeriut i mundëson të gjykojë, bën zgjedhjen dhe bie vendime të lira).

Le ta vizatojmë hartën e trurit të njeriut me qendrat për urdhra kryesorë mental duke studiuar me durim ajetet që kanë të bëjnë me dëgjim, të parë dhe zemër në Kuranin fisnik (mrekulli e përhershme). Në komentet e periudhave të ndryshme të Kuranit fisnik kam vërejtur në vijim:

1. Përmendja e shqisës së dëgjimit dhe të parit në Kuranin fisnik: “Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, që të jeni falënderues.” (“En-Nahl”, 78)

Dhe: “Ne u patëm mundësuar atyre (fuqi, pasuri, jetë të gjatë), atë që nuk ua mundësuam juve, u patëm dhënë të dëgjuar, të parë edhe zemra (të menduar), por atyre nuk u bëri dobi asgjë, as të dëgjuarit e tyre, as të parit e tyre e as zemrat e tyre, pse ata ishin që i mohonin argumentet e Allahut, prandaj i përfshiu ajo me të cilën talleshin.” (“El-Ahkaf”, 26)

2. Fjala *dëgjim* vjen në njëjës, ndërsa fjala *të parët* vjen në shumës.

3. Fjala *zemër* gjithmonë vjen pas fjalës *dëgjim* dhe fjalës *të parë*: “Ai është që jua krijoi të dëgjuarit, të parët dhe të kuptuarit tuaj; sa pak jeni mirënjohës.” (“El-Mu’minun”, 78)

4. Fjala *memec* vjen në mes fjalës *i shurdhër* dhe *i verbër*:

“(Mbesin në errësirë) Të shurdhër, memecë dhe të verbër, prandaj ata nuk kthehen (nga ajo rrugë e tyre e keqe).” (“El-Bekare”, 18)

Komentuesit e Kuranit fisnik kanë ofruar argumentin personal në këtë ajet duke thënë: “Prioriteti i dëgjimit mbi të parët është për shkak të pozitës së lartë të dëgjimit, gjegjësisht veshit.



Veshi dëgjon nga të gjitha anët dhe ky është vegël perceptivë për shpallje, ndërsa personi i cili fle, zgjohet përmes veshit.”

Interpretimi i Kurtubiut thekson: *“Shumica e filozofëve thotë se të parët ka përparësi mbi dëgjimin, sepse dëgjimi mund të perceptojë vetëm zërin dhe të folurit, ndërsa të parët percepton tërë trupin, të gjitha ngjyrat dhe format.”*

Alusiu përmend në shpjegimin e tij: *“Vërtet, të gjitha shqisat janë të rëndësishme, nëse ekzistojnë në renditjen e tyre të rëndomtë. Mendohet se ai që humb një shqisë, i zvogëlohen mundësitë perceptivë, prandaj favorizimi i njëres shqisë mbi tjetrën është pakuptim. Ideja e dhënies përparësi dëgjimit mbi të parët për shkak të pozitës më të lartë është e padrejtë dhe e pabazë.”*

Pastaj paraqitet befasia, e cila orientoi tërë vëmendjen në fshehtësinë mahnitëse e cila qëndron në dhënien e përparësisë dëgjimit mbi të parët.

Këto janë ajetet që përmendin syrin dhe veshin. Në këto ajete mund të vërejmë se syri i paraprin veshit e që është situata e kundërt në krahasim me dëgjimin dhe të parët:

“Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët.” (“El-A’raf”, 179)

“A kanë ata (idhujt) këmbë të ecin me to, a kanë duar të rrëmbejnë me to, a kanë sy të shohin me ta, a kanë veshë të dëgjojnë me ta? Thuaj: “Thirrni shokët (zotat) tuaj e thurni kurtha për mua e mos pritni.” (“El-A’raf”, 195)

“Ne u caktuam atyre në të (në Teurat) masat ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti Allahu, ata janë mizorë (të padrejtë).” (“El-Maide”, 45)

Për këtë, nëse përparësia është për shkak të pozitës më të lartë, veshi do të duhet t’i paraprijë syrit si dëgjimi që është para të parit, sepse veshi është mjet i dëgjimit, ndërsa syri mjet vizual.

Pra, nuk është në pyetje pozita më e lartë e një organi mbi tjetrin, por diçka tjetër, mrekullia shkencore duke gjykuar sipas të gjitha gjasave.



Shkencëtarët kanë zbuluar qendrën për dëgjim dhe rrugët me të cilën vërejmë gjërat e dukshme dhe u japim kuptim. Kanë zbuluar se veshi është instrument i qendrës për dëgjim në kokën e njeriut, dhe qendra për dëgjim anatomikisht i paraprin qendrës për sy në trurin tonë. Këtu del në pah një mrekulli e vërtetë. Fjala *dëgjim* dhe *shikim* në ajetet kur'anore paraqiten në harmoni me renditjen e lokacioneve të qendrave për dëgjim dhe të parë në trurin e njeriut. Por, përveç që njeriu është i begatuar me dëgjim dhe shikim, ka aftësinë e prodhimit të elokuencës së stërholluar njerëzore. Shkencëtarët neurologë zbuluan vendin e quajtur *fornix*, i cili është në mes qendrës për dëgjim para dhe qendrës për të parë prapa. Kur qendra për dëgjim është në intereaksion me qendrën për të parë, atëherë vendi në mes këtyre dy qendrave përbën vendin e produksionit të elokuencës njerëzore.

Fjala *memec*, e cila është në mes fjalës *i shurdhër* në fillim dhe fjalës *i verbër* në fund të këtij vargu ka të bëjë me zonën e elokuencës në tru, e cila është e vendosur në mes të qendrës për dëgjim para dhe qendrës për të parë prapa. Nëse *shurdhim* quhet mosfunksionim i dëgjimit, dhe nëse verbëria është mosfunksionim i të parit, memecëria është mosfunksionim i të folurit.

E megjë ata që janë të përshkruar si të shurdhër, memecë dhe të verbër janë ateistët, që kanë dëgjim të shëndoshë, shikim të qartë dhe të folur elokuent, shurdhimi këtu d.m.th. mosfunksionimi perceptiv i shqisës së dëgjimit, verbëria paraqet mosfunksionimin perceptiv të shqisës së të parit, ndërsa memecëria paraqet defekt mental, i cili ka të bëjë me elokuencën perceptivë.

Në afrim të kësaj përkrahjeje kemi ajetin e Kur'anit fisnik:

“Allahu sjell shembull: dy njerëz, njëri prej atyre dyve është memec që nuk ka aftësi për asgjë (as për vete as për të tjerët) dhe vetë ai është barrë për kujdestarin e tij, pse kudo që ta orientojë, ai nuk sjell ndonjë dobi. A është ai i barabartë me atë që udhëzon për drejtësi e edhe vetë është në rrugën e drejtë?” (“En-Nahl”, 76)

Në këtë rast, fjala memec udhëzon në zonën elokuente e cila në tru ndodhet në mes qendrës për dëgjim dhe qendrës për të parë. Paraprakisht me këtë, kuptimi i fjalës *memec* dhe përdorimi i saj



në Kur'anin fisnik ka të bëjë me funksionimin e qendrës për elokuencë brenda trurit të njeriut. Të ndalemi këtu që të skicojmë dhe të përshkruajmë zonat e përmendura në ajete që kanë të bëjnë me dëgjim, të parë dhe elokuencë, e pastaj të shtrojmë pyetjen:

A thua zont mentale të larta brenda trurit të njeriut janë të kufizuara kryesisht me dëgjim, shikim, elokuencë dhe me të menduar, të ngjashëm me këto?

Shkencëtarët kanë zbuluar që zona e elokuencës në trurin e njeriut ndodhet në mes qendrës për dëgjim dhe qendrës për të parë

Përgjigjja ime është: Jo, truri në brendinë e tij përmban zona tjera të lidhura me emocione dhe shqisa. Brenda këtyre zonave truri i njeriut orientohet nga kompjuteri me memorie kah kuptimi fisnik në të cilin truri - kompjuter me memorien e tij bashkon ndjenjat. Ai dëgjon dhe kupton atë që dëgjon dhe vepron me kthim. Ai sheh dhe kupton atë që sheh dhe vepron me kthim. Dëgjimi dhe shikimi orientohen nëpërmes këtij veprimi.

Ky kuptim i thellë nuk ekziston në makinat e përparuara që janë të mbajtura me potenciale të mëdha input dhe output, shënimeve hyrëse dhe dalëse. Sado që këto makina janë të sofistikuara, prapëseprapë, mbesin trupa të pajetë të privuara nga emocionet dhe ndjenjat e përgjegjësisë.

A është e mundur të përcaktojmë lokacionin dhe funksionin e zonave përgjegjëse për ndjenja dhe emocione në bazë të ajeteve të Kur'anit fisnik?

Përgjigjja është: Po, kjo është e mundur. Por si?

Me studimin e vëmendshëm të ajeteve në të cilët përmendet fjala *Fuad* (zemra) zbulojmë vëzhgimet në vijim:

1. Fjala *Fuad* (zemër) në Kur'an gjithmonë është e vendosur pas fjalëve *dëgjim* dhe *shikim*.

2. Fjala *Fuad* (zemër) vjen në shumës (Ef'ide) si dhe fjala *shikim*:

“Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, kështu që të jeni falënderues.” (“En-Nahl”, 78)



3. Fjala *Fuad* (zemër) vjen në kuptim siç janë emocionet, instiktet dhe ndjenjat.

Emocionet:

“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të Shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që ta falin namazin, pra, bëj që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata, dhe për të falënderuar me mirënjohje, furnizoji ata me fruta.” (“Ibrahim”, 37)

Instiktet:

“Dhe kështu (sikurse edhe ty) çdo pejgamberi i bëmë armiq disa nga njerëzit dhe nga xhindet e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxitin njëri-tjetrin në mashtrime. E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do bënin atë (armiqësi), po ti lëri ata me ato trillime. Dhe që të anojnë (te ato fjalë mashtruese) zemrat e atyre që nuk besojnë botën e ardhshme dhe që të kënaqen e të ngarkohen me atë që janë duke u ngarkuar (ty nuk të dëmtojnë asgjë).” (“El-En’am”, 112-113)

Ndjenjat:

“Është zjarri i Allahut i ndezur fort që depërton deri në loçkë të zemrës.” (“El-Humeze”, 6-7)

Ndërsa fjala *Kalb* (zemër) vjen në kuptimin që përfshin mendimet dhe ndjenjat:

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë dhe veshë me të cilat do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në kraharor.” (“El-Haxh”, 46)

4. Njohja e Kalbit (zemër) në një anë dhe Fuad (zemër) në anën tjetër:

“E zemra e nënës së Musait agoi e zbrazët (kur kuptoi se ka rënë në duart e faraonit) dhe gati ta zbulojë atë (fëmijën), sikur të mos ia forconim Ne zemrën asaj që të bëhet e bindur (në premtimin e Allahut).” (“El-Kasas”, 10)



Gjithashtu, në hadithin e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) qëndron: “Jemenasit janë popull me zemër të butë dhe zemra të qetësuar” dhe “Allahu do ta bëjë zemrën tënde të patrembur dhe ta udhëzojmë zemrën tënde”.

Shkencëtarët kanë zbuluar që ekziston qendra për emocione dhe instinkte në tru.

Këto vëzhgime të qarta vënë në shenjë dallimin në mes zemrës (*Kalb*) në një anë dhe zemrës (*Fuad*) në anën tjetër. Kjo paraqet që Fuad organikisht është i lidhur me dëgjim dhe shikim dhe ka lidhje me ndjenjat, emocionet dhe instiktet.

Nëse të dëgjuarit i përshkruhet për dëgjimin, me të cilin perceptohen zërat dhe i jep kuptim, dhe nëse të parët ka të bëjë me qendrën e të parit, ku vërehen dhe kuptohen gjërat e dukshme, atëherë Fuad, i cili organikisht është i lidhur me dëgjim dhe shikim, ka të bëjë me qendrën për ndjenja dhe emocione.

Dr. Me'mun Mubejjid në veprën “Mësohu t'i mbizotërosh emocionet e tua” (Sarajevë, 2008), në faqen 33 prezanton funksionin amigdale, qendrën për emocione dhe thotë:

“Ky është stacion i bashkimit të qelizave nervore brenda trurit dhe kjo është qendër e veçantë për emocione dhe ndjenja. Nëse amigdale lëndohet, njeriu mund të humbasë dimensionin emocional të ngjarjeve jetësore. Atëherë bëhet qenie e ftohtë pa emocione dhe pa mundësi të kthejë ndjenjat, pak i interesuar për njerëzit tjerë. Të gjitha informatat të cilat nëpërmes shqisave të ndryshme arrijnë në tru, së pari, kalojnë nëpër amigdale, ku zhvillohet shikimi i shpejtë i tyre e ku do të vërehet nëse këto informata kanë diçka me rëndësi për këtë person. Informatat e përmendura te njeriu krijojnë ndjenjën e lumturisë, gëzimit, emocioneve, pikëllimit, hidhërimit, etj. Ky proces ndodh para se informatat të arrijnë te korja e trurit e cila zakonisht është përgjegjëse për analizën dhe kuptimin e informatave. Në rast se në mesin e informatave ka disa të dhëna të rëndësishme dhe emocionuese, këto nga amigdale dalin kah korja e trurit duke bartur me vete emocione të fuqishme. Këto emocione i mbizotëron me mendim të qetë logjik.”

Por, a është e mundur që përmes ajeteve kur'anore të identifikojmë lokacionin e Fuadit si zemër e trurit?



Përgjigjja është: Po, për arsye se Fuadi ekziston në vend të caktuar pas dëgjimit, e jo prapa, pas qendrës për të parë. Kjo kërkon nga ne që të drejtohem me thellë në strukturat e trurit meqë shkencëtarët kanë zbuluar zonat e ndjenjave dhe të emocioneve. Mirëpo, shtrohet pyetja: A thua ndjenjat dhe emocionet në të janë në kompetencën e njeriut? Përgjigjja është: Jo, sepse zemra pranon ndjenja të papritura dhe emocionuese dhe reagon ndaj ndjenjave të saj. Pra, shtrohet pyetja: Cila është ajo vlerë e lartë njerëzore, e cila e bën qenien njerëzore të kualifikuar për gjykim dhe urdhërim?

Përgjigjja është: Kjo është një forcë diskrete, e cila i mundëson të zgjedhë në mes opsioneve alternative. A ekziston një vend brenda trurit njerëzor në të cilin kjo vlerë e madhe njerëzore paraqitet? Përgjigjja është: Po, kjo është pjesa e përparme e lobit frontal të trurit të njeriut.

Shkencëtarët, para pak kohe, zbuluan lidhjen e tij me aftësinë që të zgjedhë në mes opsioneve alternative me relacionet mentale të larta.

A ekziston ndonjë referencë në Kur'an për lokacionin dhe funksionin e lobit frontal? Përgjigjja është: Po, por në çfarë mënyre?

Duke studiuar ajetet në vijim:

“Unë ju kam mbështetur Allahut, Zotit tim dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim, vërtet Zoti im është i drejtë.” (“Hud”, 56)

“A më tregon atë që pengon një rob kur ai falet?

Ç'mendon kur ai (robi) është në rrugë të drejtë?

A më tregon nëse ai përgënjeshton dhe zbrapset (nga besimi)?

A nuk e di ai se Allahu e sheh?

Jo, jo! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për flokësh mbi ballin. Floku rrenacak, mëkatar.” (“El-Alak”, 9-16)

Balluket në kuptim gjuhësor dhe terminologjik d.m.th. pjesa e ballit ku fillojnë flokët ose zona ballore. Ajeti i parë (surja “Hud”) përcakton ballin si vendin e nivelit më të lartë të udhëheqjes dhe të dirigjimit në trupin e njeriut. Ajeti tjetër (surja “El-Alak”) shpjegon që zona parabollore është lokacion për aftësitë e zgjedhjes në mes opsioneve alternative.



Në fund, mund të skicojmë pamjen tridimensionale të trurit dhe në të të përcaktojmë lokacionin dhe funksionin e qendrave për dëgjim, të parë, emocione, vendosmëri, në mënyrën si është shpjeguar me skicën vijuese. Imazhi tridimensional i trurit njerëzor i shpallur në ajetet që paraqesin mrekulli unike të Kur'anit fisnik është:

1. Kur fjala *sy* vjen me fjalën *vesh* në ajetin e njëjtë, syri i paraprin veshit në renditjen e fjalëve. Syri ndodhet në pjesën e përparme të kokës së njeriut, ndërsa veshi pason prapa.
2. Renditja e fjalëve *dëgjim* dhe *të parë* në gjithë ajetet kur'anore është identike me renditjen e lokacioneve të qendrave për dëgjim dhe të parë brenda trurit njerëzor. Pra, dëgjimi i paraprin shikimit në Kur'anin fisnik, ndërsa qendra për dëgjim ndodhet para qendrës për shikim në trurin njerëzor.
3. Fjala *Fuad* merr pozicionin fiks pas fjalës *dëgjim* dhe *shikim* në gjithë ajetet kur'anore. Në gjuhën arabe, kjo fjalë ka kuptimin e ndjenjës, e gjithashtu quhet edhe Kalb (zemër).
4. Fjala *memec* gjithmonë vjen në renditje në mes fjalës *shurdh* dhe *i verbër* në gjitha ajetet kur'anore. Shkencëtarët zbuluan qendrën kryesore të elokuencës e cila ndodhet në tru në mes qendrës për dëgjim dhe qendrës për të parë.



Të reja shkencore

Kur'ani dhe astronomia

Zbulohet planeti që sillet rreth dy diejve

Teleskopi “Kepler” i NASA-s ka zbuluar një planet që sillet rreth dy diejve, i pari në llojin e tij, njoftoi Agjencia Hapësinore Amerikane.

Zbulimi është publikuar në numrin e së premtes në revistës “Science”. Planeti i quajtur “Kepler-16b” mendohet të jetë një gjigant me gaz të ftohtë siç është edhe Saturni.

Objekti i ri i zbuluar ndodhet rreth 200 vite dritë larg Tokës. Edhe pse shkencëtarët kanë menduar se mund të ekzistojnë planetë që sillen rreth dy yjeve, kjo është hera e parë që diçka e tillë konfirmohet. Shkencëtarët thonë se kur përfundon dita në “Kepler-16b”, ka muzg të dyfishtë.

Dy diejt e “Kepler-16b” janë më të vegjël se ylli ynë – 69% dhe 20% i masës së diellit tonë – duke bërë që temperatura në sipërfaqe të planetit të jetë 100-150 F (-73 deri – 101 C). Planeti sillet plotësisht rreth dy diejve të tij çdo 229 ditë në një distancë 104 milionë kilometra larg.

Teleskopi “Kepler” i prodhuar në vitin 2009, është projektuar për zbulimin e planetëve të tjerë në Galaktikën e Rrugës së Qumështit.



Astronomët zbuluan planetin 'diamant'

Bëhet e ditur se është zbuluar një planet 4 mijë vjet dritë larg Tokës, i cili mendohet të jetë i përbërë nga diamantë.

Ekipi i astronomëve në universitetin teknologjik Swinburne në Melburn të Australisë ka zbuluar një yll të vjetër dhe të madh në galaktikën Rruga e Qumështit, i cili me kalimin e kohës është shndërruar në një planet diamantesh.

Kjo botë 'xhevahresh' është më e madhe se Jupiteri, planeti më i madh në sistemin tonë diellor. Sipas studimit të zhvilluar nga ekipi i përbërë nga shkencëtarë të ndryshëm amerikanë, australianë, italianë dhe anglezë, planeti zotëronte një masë të dendur dhe një sasi të madhe karboni. Për shkak të dendësisë me kalimin e kohës karboni është kristalizuar dhe struktura gjeologjike e planetit është shndërruar në diamant.

Procesi historik i planetit dhe dendësia e tij e paparë na ndihmon për të kuptuar më mirë të kaluarën dhe gjendjen e tanishme të tij' u shpreh prof. Mathew Bailes, drejtues i ekipit. Sipas Bailes dhe ekipit të tij planeti diamant është mbetje e një ylli të vdekur (pulsar) PSR J1719-1438, i cili ka humbur fuqinë dhe shtresat e jashtme. Planeti diamant e bën rrotullimin e tij rreth PSR J1719-1438 për 2 orë e 10 min. Ndërsa distanca në mes dy trupave qiellorë është vetëm 600 mijë km.

Të quajtur ndryshe yje neutron, pulsarët rrezatojnë duke u kthyer qindra herë në 1 sek në një fushë deri në 20 km. Këta rreze janë parë me ndihmën e teleskopëve në Australi, Angli dhe Havai. Rezultatet e studimit janë publikuar në revistën shkencore "Science".

Shfaqen trupa misteriozë nën zërin e lëshuar nga yjet



Teleskopi hapësinor "Hubble" i NASA-s ka zbuluar objekte të shpejta zëri të cilat mendohet se janë krijuar nga gazi dhe

përhapen në thellësi të hapësirës nga yjet e rinj.

Shkencëtarët pohojnë se këta trupa lindin nga yjet, janë të ngjashëm me kometat dhe mund të lëvizin 161 km në sekondë (708 mijë km në orë). Të dhënat e përfutuara tregojnë se trupa të ngjashëm mund të jenë përhapur 4.5 miliardë vjet më parë, gjatë lindjes së Diellit.

Shkencëtari Patrik Hartigan nga Universiteti Rice në Hjuston të SHBA-së dhe ekipi i tij, analizuan fotografitë e 3 yjeve të rinj, të bëra për 14 vjet me radhë nga teleskopi “Hubble”. Pas krahasimit të fotografive të vjetra me ato të reja, ekipi zbuloi ekzistencën e këtyre trupave supersonikë. Trupat e tregojnë veten e tyre në 100-mijëvjeçarin e parë pas lindjes së një ylli të ri.

Pas zbulimit të trupave HH1, HH2 dhe HH46, HH47, HH34 të shkëputur nga një yll i ri i cili gjendej në Orion Nebula, 1350 vite dritë larg Tokës, Hartigan dhe ekipi i tij po analizojnë ndikimin që shkaktojnë shpërthimet e shpejta të gazit në lindjen e yjeve. Studimi është publikuar në revistën “The Astrophysical Journal”.

Aktivizohen dunat e rërës në Mars

Janë vërejtur lëvizje tek dunat e rërës në pjesën veriore të Marsit, të cilat mendohet se ndodhen aty prej një kohe të gjatë.

Nga pamjet e marra me kamerën HIRISE (High Resolution Imaging Experiment) të Mars Reconnaissance të vendosur në orbitën e planetit të kuq, shihet se dunat e rërës të shtrira në polin verior të Marsit dhe që e mbështjellin atë si një bandë me një gjerësi sa zona e Teksasit, janë të lëvizshme.

Duke theksuar se para këtij vëzhgimi nuk kanë arritur të shohin lëvizje tek grumbujt e rërës së krijuar nga erërat e fuqishme të periudhave të mëparshme, shkencëtarët që publikuan studimin u shprehën për një revistë shkencore: “Numri dhe madhësia e ndryshimeve në këto duna rëre është shumë e habitshme”.

Studimi është realizuar nga pedagogë dhe profesorë të Universitetit



të Arizonës. Duke pohuar se katër vite të tokës janë të barabartë me dy vite të Marsit, specialistët theksuan se shkaku i ndryshimeve të dunave të rërës në planetin e kuq lidhet me stuhitë e forta dhe shkrirjen e dioksidit të karbonit në varësi të stinës.

CO₂ i ngrirë, i cili përfshin të gjithë zonën ranore gjatë dimrit në pranverë, me rritjen e temperaturave avullon dhe kthehet në trajtë gazi. “Këto fryrje gazi të cilat ndryshojnë sipërfaqen e Marsit bëhen shkak i shfaqjes së ortekëve të rërës që krijojnë rrafshnalta dhe humnera”, u shprehën shkencëtarët.

Shkencëtarët kryejnë numërimë në galaktikë

Në hamendësimin e parë të bërë në lidhje me numrin e planetëve në galaktikën tonë, shkencëtarët pohuan se në Rrugën e Qumështit gjenden të paktën 50 miliardë planete Sipas hamendësimeve të bëra bazuar në rezultatet e para të marra nga teleskopi Kepler i NASA-s, të paktën 500 milionë nga këta planetë paraqesin kushte të përshtatshme për jetesë, pra, nuk janë as shumë të nxehtë dhe as shumë të ftohtë

Drejtuesi i ekipit shkencor, Kepler William Borucki, pohoi se gjatë vitit të parë shkencëtarët kishin arritur të gjenin numrin e planetëve në një pjesë të vogël të studimeve mbi yjet dhe më pas ata hamendësuan se cilët ishin planetët e yjeve.

Në galaktikën Rrugë e Qumështit gjenden të paktën 100 miliardë yje.

Kur'ani dhe anatomia

A ndikohen sytë nga zëri?

Prof. Hugo Fastl, pedagog në Universitetin Teknik të Mühidut, në përfundim të studimeve të bëra pohoi se sytë ashtu si veshët ndikohen nga zhurmat dhe mund të



dëgjojnë.

Duke theksuar se sytë luajnë një rol të rëndësishëm në perceptimin e zërit, Prof. Fastl në një eksperiment të realizuar me nxënësit e tij, arriti të provonte se sytë perceptonin më pak zhurmën e trenit me ngjyrë të hapur jeshile dhe atij me ngjyrë të bardhë. Më pas, Fastl ka zhvilluar të njëjtin eksperiment, por kësaj radhe i ka ballafaquar nxënësit me një tren me ngjyrë të kuqe të theksuar dhe arriti në përfundimin se nxënësit dëgjonin më mirë zhurmën e këtij treni.

“Sipas rezultateve të marra nga eksperimentet e realizuara, ekziston një lidhje e rëndësishme në mes të shikuarit dhe frekuencës së zërit”, - u shpreh prof. Hugo Fastl.

Kur'ani dhe zoologjia

Kaq të zgjuar janë mikrobet?

Mund të themi se pjesa më e madhe e gjallesave në botë përbëhen nga mikroorganizmat. Këto gjallesa njëqelizore pasqyrojnë një shumëllojshmëri biologjike dhe mund të jetojnë në çdo ambient.

Edhe nëse mikroorganizmat mund të pranohen si më të thjeshta se gjallesat shumëqelizore, ata me anë të thjeshtësisë strukturore mund të zhvillohen në përmasa të habitshme dhe të ndërlikuara. Studiuesit na bëjnë të mendojmë se këta mikroorganizma, të cilët përngjasojnë me një lloj zgjuarsie, nuk janë aq të thjeshtë dhe primitivë.

Veprimet e mikroorganizmave, të cilët shihen si një produkt i zgjuarsisë ashtu si veçoritë e tjera, tregojnë një shumëllojshmëri. Sigurisht që është e pamundur të flasim për një zgjuarsi të vërtetë sepse ata nuk zotërojnë as dhe një sistem nervor. Këta veprime të tyre mendohet se pasqyrohen si rezultat i punës së një “kompjuteri kimik”. Bazuar në këtë model, qeliza pranon informacionin nga jashtë dhe e përdor për ta nxjerrë jashtë në trajtën e një veprimi. Njësitë operative këtu janë proteinat që



punojnë në mënyrë të ngjashme me dyert e logjikës së kompjuterit. Informacioni i marrë nga jashtë mundëson ndryshimin e formës së proteinave, bashkimin e tyre dhe ndryshimin e tyre kimik brenda hallkave të sistemit operativ. Dhe si rezultat, proteinat krijojnë reagimin ndaj veprimt.

Ja disa nga veprimet dhe sjelljet e mikroorganizmave të cilat të ngjallin përshtypjen se janë të vetëdijshme ndaj ambientit dhe reagojnë si të tilla:

1. Mikrobet komunikojnë me njëri-tjetrin

Dihet se bakteret duke përdorur sinjalet kimike lidhen me të afërmit e tyre, bëjnë marrëveshje me aleatët ose luftojnë mirë armikun. Mikrobiologët mendojnë se kjo lloj “bisede” kimike u jep mundësinë baktereve të solidarizohen me bashkësinë e komplikuar të kafshëve, të specifikohen si gjallesa shumë qelizore dhe të pasqyrojnë veprime sociale.

Një shembull i rrallë i komunikimit mes baktereve shihet tek bakteri “*Bacillus subtilis*”. “*Bacillus subtilis*” ndahet në mënyrë të pavarur nga të tjerët në një ambient të pasur nga ana e ushqimit dhe krijon një koloni në trajtë rrethore nga pika e fillimit.

Por, kur pakësohet sasia e ushqimit, fillojnë të tregojnë një lloj solidariteti në mes njëri-tjetrit. Sipas pamjeve të marra, qelizat e shumuara marrin lëndët kimike të përfutuara nga fqinjët e tyre dhe përpiqen të largohen veçanërisht prej tyre. Kjo situatë krijon më pak rivalitet për burimin ushqimor. Kur pakësohet ushqimi, krahët e gjatë të kolonisë mbështillen fort rreth qendrës. Ndërsa në rastet kur ushqimi pakësohet edhe më shumë, krahët hollohen dhe kolonia merr një pamje shumë të rregullt. Studiuesi i cili imitoi këtë model në krijimin e modeleve matematikore, Ben-Jacob pohon se modeli punon shumë realisht kur hyjnë të dhëna në lidhje me përhapjen e lëndëve kimike dhe mbështet mendimin se bakteret komunikojnë vërtetë me njëri-tjetrin.



2. Mikrobet vendosin

Shumë mikroorganizma mund të pasqyrojnë ndryshime në veprime në varësi të numrit të specieve të llojit të tyre. Dhe kjo u jep mundësinë gjallesave të zhvillojnë një lëvizje të përbashkët. Një nga mënyrat që mundëson punën e koordinuar në grup të mikroorganizmave është dhe dukuria e njohur si konceptimi i shumicës së mjaftueshme.

Bakteri i njohur si “*Vibrio harveyi*” është një nga gjallesat që e pasqyron këtë dukuri. Këta baktere prodhojnë në mënyrë rutinë një molekulë të njohur si nxitëse dhe më pas, e përhapin përreth. Në shumicën e rasteve, në fund nuk ndodh asgjë, por nëse arrihet një dendësi e lartë në ambientin molekular “*Vibrio harveyi*” krijon një reagim kimik në qeliza dhe qelizat fillojnë të shkëlqejnë. Kjo lidhet me numrin e baktereve të gjendura në dendësinë molekulare dhe si rrjedhojë kur numri i baktereve rritet mjaftueshëm bakteret shkëlqejnë me një dritë të zbehtë bojëqielli. Si përfundim, qelizat “*Vibrio harveyi*” nuk shkëlqejnë vetëm, por kur janë në grup. Nuk dihet akoma se cili është avantazhi i kësaj sjelljeje të “*Vibrio harveyi*”-t, por ky mister është zbuluar për kushëririn e tij “*V. fischeri*”, i cili pasqyron sjellje të ngjashme. Jashtë laboratorit “*V. Fischeri*” zakonisht jeton në trajtë kolonish të dendura brenda një peshku sepje në Havai. Ndërkohë që peshku Sepje u mundëson një ambient të përshtatshëm për të jetuar e shumëzuar, edhe bakteret me anë të rrezatimit e ndihmojnë peshkun të fshihet ose maskohet në botën nënujore.

Koncepti i shumicës së mjaftueshme përdoret edhe në shumë mikroorganizma tjerë për qëllime të ndryshme, përfshirë këtu edhe mikroorganizma infektues sëmundjesh si p.sh. mikroorganizma me emrin *P. Aeruginosa* kur ndodhet tek mëlçia e të sëmurëve me fibrozë me anë të rrugës së konceptimit të shumicës së mjaftueshme vendos të hyjë në qeliza, apo kur duhet të përdorë lëndët e veçanta të cilat lehtësojnë vendosjen e saj kundër sistemit imunitar. Me ndihmën e këtij sistemi të aktivizuar



brenda një kohe të shkurtër, kolonia arrin të shmangë zgjimin e hershëm të sistemit imunitar të të sëmurit. Në këtë mënyrë, ato janë forcuar dhe shumëuar mjaft para se të fillojnë sulmin.

Zbulimi i mekanizmit të konceptimit të shumicës së mjaftueshme tek mikroorganizmat e sëmundjeve hapi një rrugë krejt të re kundër sëmundjeve mikrobike. Në luftën me bakteret që sa vijnë e bëhen më rezistente ndaj antibiotikëve, specialistët mendojnë se më logjike është të gjejnë mënyrën, rrugën e ndërprerjes së komunikimit mes baktereve sesa t'i mbysin ata. Në këtë mënyrë gjatë kohës së fituar nga ndalimi i mekanizmave të konceptimit të shumicës së mjaftueshme të baktereve janë përfutur të dhëna rreth mënyrës së çaktivizimit të kolonisë duke zgjuar sistemin imunitar.

3. Mikrobet gjejnë drejtimin e tyre

Aftësia e gjetjes së drejtimit të parë në shumë shembuj nga bota e kafshëve shihet edhe tek mikroorganizmat. Algat “Chlamydomonas” që jetojnë në ujë, mund të lëvizin në drejtim të dritës. Por kjo shihet vetëm në rast se rrezja e dritës është në përmasat e një dallge të përshtatshme për fotosintezë.

Ndërsa bakteret “Escherichia coli” në kushte normale zhvillojnë lëvizje të drejta, por ka raste që kthehen papritmas dhe vazhdojnë përsëri në trajtë drejtvizore. Lëvizja e bakterit realizohet me ndryshimin e këtyre dy tipe lëvizjesh.

Por nëse në ambientin ku jeton bakterit i shtohet pak ushqim, përfundon lëvizja e sjelljes rreth vetes dhe bakteri fillon të lëvizë në një vijë të drejtë drejt erës së ushqimit.

Këto lëvizje të quajtura ndryshe si “Taksi”, punojnë të lidhura me mekanizma të ndryshëm molekularë. Sipas mekanizmës së shërbyer për lëvizjen kemotaksi (drejtim kimik) të bakterit “Escherichia coli”, marrësit e gjendur në pjesën e jashtme të bakterit luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e lëvizjes.

Ashtu si çelësat në qarqet elektrikë edhe këta marrës punojnë kur janë të hapur dhe të mbyllur. Hapja ose mbyllja e marrësve nxit njërën nga lëvizjet. Në kushte normale, mesatarja e hapjes apo



e mbylljes së marrësve është 50 me 50.

Në rast se një nga trajtat mbizotëron mbi tjetrën, atëherë kjo mund të ndikojë në ndryshimin e llojit të lëvizjes. Por, kur molekulat ushqyese kapen tek marrësit, i kyçin ata në një pozicion të caktuar dhe bëhen shkak të një lëvizjeje të drejtë.

Një nga shembujt më të mahnitshëm në lidhje me aftësinë e gjetjes së drejtimit të mikroorganizmave shihet tek kërpudha pelte. Është zbuluar se kërpudha pelte mund të gjejë rrugën më të shkurtër në mes hyrjes dhe daljes së një labirinti. Kërpudhat pelte përbëhen nga qeliza të pavarura të ngjashme me amebat të cilat lëvizin si një organizëm i vetëm. Në eksperimentin e realizuar nga studiuesi japonez, Toshiyuki Nakagaki, ai ndau në pjesë të vogla një njësi të kërpudhës pelte dhe çdo pjesë e vendosi mbi pjesë të ndryshme të një labirinti të krijuar me filma plastikë në të cilin kishte vendosur dhe një gjel laboratorik mbi të cilin rriteshin mikroorganizmat. Në hyrjen dhe daljen e labirintit kishte vendosur blloqe agari të mbushur me tërshërë. Në fund të eksperimentit, ai pa se pjesët e ndara të kërpudhës u bashkuan si të ishin një organizëm i vetëm. Por ndërkohë që kërpudha rritej, ajo krijoi një tub të trashë në mes hyrjes dhe daljes duke u tkurrur nga pikat pa kalim. Krahës kësaj, megjithëse ai kishte vendosur katër rrugë për të dalë, kërpudha çdo herë zgjodhi rrugën më të shkurtër.

4. Mikrobet mësojnë dhe kujtojnë

Mikroorganizmat kanë një lloj kujtese dhe duke shfrytëzuar gjërat e “mësuar” mund të ndryshojnë edhe lëvizjet.

Studimet e zhvilluara kanë treguar se lëvizjet e mikroorganizmave nuk mund të jenë të rastësishme, përkundrazi, ata zotërojnë strategji të përsosura lëvizjeje.

P.sh. një studim i realizuar mbi amebat tregon se kur amebat janë në lëvizje, nëse në fillim kthehen nga e djathta, kthesën tjetër do ta bëjnë nga e majta. Dhe ky fakt i bën studiuesit të mendojnë se ato zotërojnë një kujtesë primitive me anë të së cilës kujtojnë anën e kthesës së mëparshme.



Ndërsa tek bakteret “*Escherichia coli*” shihet diçka më interesante. Këta baktere e kalojnë një pjesë të jetës së tyre në sistemin tretës të njeriut dhe ndërkohë që përparojnë brenda tij, ato përballen me ambiente të ndryshme. Bakteri, në fillim, takohet me sheqerin laktoz, më pas, me sheqerin maltozë. Në takimin e parë me laktozën, ai aktivizon mekanizmin biokimik për të tretur laktozën dhe në të njëjtën kohë, aktivizon pjesërisht dhe mekanizmin tjetër biokimik që do të tresë maltozën më vonë.

Për të treguar se kjo nuk është një veçori e lindur por e mësuar më vonë, specialistët rritën për disa muaj bakterin “*Escherichia coli*” në një ambient ushqyes në të cilin kishte vetëm laktozë dhe jo maltozë. Në fund, ato panë se bakteret duke ndryshuar lëvizjet e tyre e harruan aktivizimin e mekanizmit tretës së maltozës.

Përmasat e tyre jashtëzakonisht të vogla dhe pamundësia e shfaqjes para syve tanë, jetesa në ambiente të ndryshme, vështirësia e vëzhgimit dhe analizimit na bënë të mendojmë se ekzistojnë akoma shumë dukuri interesante dhe të jashtëzakonshme në lidhje me botën e mikroorganizmave. Në rast të zbulimit dhe të verifikimit të këtyre mikroorganizmave, do të heqim dorë edhe nga përdorimi i termave “primitive” apo “të thjeshta”.

Ja si e thur merimanga rrjetën e saj

Edhe pse asnjëri nga ne nuk dëshiron të shohë rrjeta merimange në tavan, në shumë eksperimente është vërtetuar se këto rrjeta janë shumë të forta.

A e dini si e thur merimanga një rrjetë të tillë?

Sipas një lajmi të publikuar në revistën “BBC Focus”, në barkun e merimangës gjenden gjëndrat e fijeve të quajtura “spinneret” që përbëjnë gjëndrat e sekrecioneve. Kur merimanga vihet në kontakt me ajrin, prodhon një mëndafsh të lëngshëm, të ashpërsuar. Ky mëndafsh hollohet ose trashet, zbutet ose forcohet në lidhje me nevojat e merimangës

Madje, ndonjëherë, struktura e rrjetës së saj thahet plotësisht për të mundësuar ecjen e merimangës mbi të. Merimanga nxjerr



jashtë mëndafshin me ndihmën e këmbëve të prapme dhe fija e parë fillon t'i japë formë mëndafshit pasi mbështjell një objekt. Vendet në mes spiraleve janë në përpjesëtim të drejtë me distancën në mes majës së këmbëve dhe vendit të fijeve në bark. Dhe kjo do të thotë që merimanga përdor trupin e saj për të plotësuar hapësirat boshe. Specialistët pohojnë se merimangat i thurin instiktivisht rrjetat e tyre në mënyrë perfekte. Gjendja e komplikuar e rrjetës krijohet me ndihmën e lëvizjes së secilës prej këmbëve të merimangës pa pasur nevojën e një modeli tjetër.

Ja sekreti i merimangës së ujit

Shkencëtarët kanë zbuluar misterin e merimangës që mund të jetojë në ujë (*Argyroneta aquatica*).

Si mundet merimanga e ujit të kalojë gjithë jetën e saj në fund të detit, ndërkohë që për shumë lloje tjera merimangash qëndrimi në ujë është i barabartë me vdekjen? Si mund të thurë rrjetën e saj në ujë? Dhe pikërisht në këtë pikë, biologët zbuluan mënyrën e jetesës së merimangës e cila kalon pjesën më të madhe të jetës në ujë.

Bazuar në një lajm të revistës “BBC Focus”, merimanga e gjetur në Evropë dhe Azi, brenda fijeve të vogla mbledh ajrin e marrë nga sipërfaqja dhe e përdor atë për të krijuar një këmbanë zhytjeje nën rrjetën e thurur mes bimëve. Por ambientalistët dhe fiziologët në Gjermani e Australi zbuluan se kjo këmbanë zhytjeje, në të njëjtën kohë, shërben edhe për thithjen e oksigjenit dhe për ta ndihmuar merimangën të qëndrojë sa më gjatë nën ujë.

Shkencëtarët e realizuan këtë zbulim duke vendosur disa sonda fibër-optike brenda dhe jashtë kësaj këmbane, me anë të të cilave matën nivelin e oksigjenit. Krahas kësaj, shkencëtarët pohuan se merimangat më të mëdha të ujit realizojnë këmbana më të mëdha zhytjeje, sepse kanë nevojë për më shumë oksigjen për të përmbushur aktivitetet e tyre jetësore. Në këtë mënyrë, këto këmbana mbajnë më shumë oksigjen.



Muhsin Kara'ati

Drejtësia sociale në Islam

Abstrakt

Islami është institucion i drejtësisë dhe moderimit. Islami është rruga e drejtë dhe vëllazëria myslimane është vendi që praktikon moderim dhe drejtësi. Sistemi islam mbështetet në drejtësi. Krijimi i drejtësisë është një gjë e natyrshme.

Allahu e ka pajisur njeriun me njohuri të drejta dhe gjëra të gabuara dhe rezultojnë me rezultatet e tyre. Në Kur'anin famëlar të thuhet: "Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Dhe, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E, ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten". (Esh-Shems, 8-10)

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2011

Qëllimi i diskutimit tonë për drejtësinë sociale është për të përmendur ato ajete të Kur'anit dhe traditat nëpërmjet të cilave Kur'ani i Shenjtë dhe Imamët e drejtë kanë dhënë mësimet të barazisë së njerëzimit në sytë e ligjit dhe të ruajtjes së të drejtave të tyre. Ata kanë ndaluar rreptësisht, diskriminimin, mizoritë dhe shfrytëzimin. Përveç kësaj ne kemi cituar shembujt e shpërndarjes së pasurisë, vëllazërisë islame dhe vëllazërisë biologjike të përmendura nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe imamët (paqja qoftë mbi ta!).



Drejtësia në të gjitha Ligjet islame

Islami është institucion i drejtësisë dhe moderimit. Islami është rruga e drejtë dhe vëllazëria myslimane është vendi që praktikon

moderim dhe drejtësi. Sistemi islam është i bazuar në drejtësi. Nëse ka lot për të shtypurit, atëherë do të ketë shpata për shtypësit. Në qoftë se kjo i jep rëndësi për ruajtjen e shëndetit fizik, ajo gjithashtu thekson për sqarimin tonë shpirtëror dhe atë moral. Nëse kjo na urdhëron për namaz, kjo gjithashtu na urdhëron që të paguajmë zekatin (tatimin fetar). Në qoftë se kjo na kërkon që të duam dhe respektojmë njerëzit e devotshëm, kjo gjithashtu këmbëngul për urrejtje kundër armiqve të Allahut. Në qoftë se kjo paraqet stres mbi fitimin e dijeve ajo gjithashtu e konsideron ecurinë e veprave fisnike si të detyrueshme. Në qoftë se kjo na urdhëron që të ketë besim dhe besimi në Allahun, ai gjithashtu i këshillon që të bëjmë përpjekje për të arritur qëllimet tona. Nëse ajo lejon blerjen e pasurisë personale dhe të pasurisë në tërësi, ajo gjithashtu ndalon duke përfutur në mënyrë të padrejtë pronësinë dhe dëmtimin e interesit të njerëzve tjerë. Në qoftë se ajo rekomandon ndalimin e ofendimit ajo gjithashtu ngul këmbë për zbatimin e ligjeve ndëshkuese dhe duke mos bërë asnjë dallim në dënime.

Kur Imam Aliu u kishte thënë njerëzve në lidhje me devotshmërinë dhe përkushtimin e një personi që ofron lutjet e tij, ai pyeti në lidhje me qëllimin dhe karakterin e një personi.

Për këtë arsye kjo do të thotë që nëse një person është një adhurues i devotshëm i Allahut, ne duhet ta gjykojnë atë nga pikëpamjet dhe sjelljet e tij.

Drejtësia sociale dhe pikëpamja e Zotit mbi universin

Motoja e drejtësisë sociale është ngritja nga çdo qeveri, por ju nuk do të gjeni së paku asnjë nuancë të lehtë të drejtësisë sociale aty. Arsyeja është se parulla të tilla nuk janë të bazuara në sinqeritet.

Në lirinë dhe barazinë islame kanë një bazë:

(I) E tërë gjithësia është nën kujdesin e Allahut dhe nuk ka asnjë parregullsi në të. Duke qenë një pjesë e kësaj bote, unë nuk mund të bëj atë që unë dua, si dhe me motive egoiste.



(II) Mënyra jonë për të bërë gjëra dhe vepra dhe madje edhe mënyrën tonë të menduarit janë nën mbikëqyrjen e Zotit tonë, që di gjithçka për ne, pa vetëdijen tonë. Në fund të fundit, ne do të duhet të paraqesim veten para Tij për përgjegjësinë e veprave tona.

(III) Të gjithë ne kemi qenë të ngritur nga dheu dhe ne do të reduktohem në dhe. Nuk ka asnjë ndryshim midis grimcave të dheut, pra, pse duhet të ketë ndonjë dallim në mes të tjerëve dhe meje?

(IV) Gjithkush është shërbëtor i Allahut dhe për të trajtuar të gjithë me dashuri dhe dashuria të bëhet burim i Allahut dhe njeri i mirë është ai që është më i mirë dhe më dashamirës se të tjerët

(V) Krijesat e Allahut nuk mund të tejkalojnë kufijtë dhe të drejtat e paligjshme të cilat Krijuesi i ka caktuar për ta.

(VI) Ne jemi të gjithë pasardhësit e prindërve të njëjtë.

Ky përshkrim dhe botëkuptim mbi botën dhe njeriun është bazë më e fuqishme e pranimi të parimeve të drejtësisë dhe të barazisë, por ambienti i korruptuar dhe koprracia shkatërrojnë themelimin e saj.

Krijimi i drejtësisë është një gjë e natyrshme

Allahu e ka pajisur njeriun me njohuri të drejta dhe gjëra të gabuara dhe rezultojnë me rezultatet e tyre. Në Kur'anin famëlartë thuhet: “Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten”. (Esh-Shems, 91:8-10)

Të marrim një shembull: një fëmijë që ruan mollën e tij me ju. Pas një kohe ai kthehet dhe e gjen që ju keni ngrënë një pjesë të vogël të saj. Ai hidhërohet dhe shikon me një sy akuzues sikur ai është duke thënë se ju jeni fajtor për një shkelje të besimit. Kjo është e sigurt që edhe një fëmijë di në lidhje me padrejtësinë edhe pse ai nuk mund t'ju thotë këtë me gjuhën e tij.



Prandaj, shpërdorimi është një gjë e keqe për të cilën mësuesi nuk duhet ta mësojë një fëmijë. Por është e natyrshme që njeriu e konsideron keqpërdorimin si një gjë e keqe.

Në mënyrë të ngjashme, drejtësia është një gjë që njeriu e konsideron veten atë nga një gjë e mirë dhe dëshmia e tij është se vetë shtypësi justifikon veprimin e tij duke thënë se ai nuk ka qenë i padrejtë. Ka qenë një rregull i përgjithshëm që sa herë një person është vrarë, derisa mbrojtja e të drejtave të tij dhe mbështetja për kauzën e drejtësisë sociale ose marrja e një qëndrimi të fortë kundër tiranëve është vlerësuar nga njerëzit në përgjithësi. Kjo është në natyrën njerëzore që njeriu mbështetet te shkaku i padrejtësisë dhe i pagimit të luftës kundër padrejtësisë

Drejtësia është kusht themelor

Në Islam të gjitha qendrat e rëndësishme dhe instalimet mbeten nën kontrollin e njerëzve të vetëm, reputacioni i të cilit ka qenë i mirë dhe që janë në gjendje të devotshme. Në çështjen e administrimit të drejtësisë, të drejtë nga kuazi (magjistrat) për nëpunës të zakonshëm dhe dëshmitarët, të gjithë duhet të jenë të veçantë në ruajtjen e drejtësisë. Në të gjitha lutjet e xhematit duke përfshirë edhe lutjet e së premtës, njeriu i cili drejton lutjet duhet të jetë i drejtë dhe i sigurtë. Është e nevojshme që muxhtehidi (juristi), të cilin ne e ndjekim, Presidenti, Kryeministri, Ministri i Financave dhe njeriu që shqipton formulën e divorcit janë të gjithë të drejtë dhe të ndershëm. Islami ka vënë theks të madh në drejtësi dhe kjo është baza mbi të cilën të gjitha problemet e shoqërisë, qoftë personale, sociale apo ekonomike janë vendosur.

Rëndësia e drejtësisë në tradita

Profeti i shenjtë i Islamit ka thënë: “Një moment i drejtësisë është më i mirë se shtatëdhjetë vjet adhurim në të cilin ju mbani agjërim dhe kaloni net në afrimin e lutjes dhe adhurimin e Allahut.” (Xhemi’us, Sa’adat vëll. II, f. 223)



Profeti i Shenjtë më tej tha: “Vepra e drejtësisë e bërë nga një udhëheqës për një ditë për popullin e tij është më mirë se veprat e njeriut i cili shpenzon pesëdhjetë apo njëqind vjet në mesin e anëtarëve të familjes së tij në adhurimin e Allahut.”

Imam Xhafer Sadiku ka thënë: “Lutja e një udhëheqësi kurrë nuk është e refuzuar.” (Islami Nizamul si-Sijasi, f. 71)

Imam Aliu tha: “Drejtësia është esenca e mirëqenies së njerëzve, si dhe aderim në rrugën e Zotit”.

Ai më tej tha: “Drejtësia është jeta dhe mizoria është vdekja e shoqërisë”. (Xhumal Kisar).

Për këtë arsye, ata që paraqesin veten para shtypjes janë, në fakt, aq të mirë sa trupat e vdekur.

Rëndësia e Drejtësisë

Imam Musa Kazim në komentin e ajetit ***“Ai lëshon ujë nga qielli dhe gjallëron tokën që kishte vdekur...”*** (Er-Rum, 30:24) thotë: “Toka vjen përsëri në jetë me administrimin e drejtësisë dhe zbatimin e ligjeve e të dënimit”. (Xhumal Kisar)

Themelimi i drejtësisë është synimi i profetëve

Një nga detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë peygamberëve të Allahut që Kur’ani i shenjtë ka përmendur është fillimi i drejtësisë sociale. Ne, prandaj, japim më poshtë një listë të shkurtër të arritjeve të Profetëve të shenjtë:

(I) Duke ftuar njerëzit drejt Allahut dhe parandalimin e tyre nga bindja ndaj despotëve dhe tiranëve për t’u shkëputur prej tyre, Kur’ani i shenjtë thotë: “Për çdo komb Ne dërguam një të Dërguar (duke thënë): ‘Adhurojeni Allahun dhe largohuni nga djalli!’” (En-Nahl, 16:36)

(II) Dhënia e paralajmërimeve, sjellja e lajmeve të reja. Kur’ani i Shenjtë thotë: “Ne të dërguam ty (Muhamed) për një qëllim të vërtetë



për të shpallur përgëzime dhe paralajmërime. Ju nuk do të fajësoheni për djegien e banorëve të Xhehenemit.” (El-Bekare, 2:119)

(III) Mësimdhënia dhe dhënia e udhëzimeve nga Allahu i Madhëruar dërgoi peygamberët ndaj njerëzve në mënyrë që ata të mund t’u tregojnë atyre ato gjëra që ata kishin nevojë. Kur’ani i Shenjtë thotë: “Është Ai që u ka dërguar analfabetëve një të Dërguar në mes të popullit të tyre që u lexon atyre argumentet e Tij dhe pastron ata. Ai do të mësojë Librin për ta dhe të tjerët që nuk iu kanë bashkuar ende dhe Ai do t’u japë atyre urtësi. Para kësaj ata kishin qenë në gabim të qartë.” (El-Xhumua, 62:2)

(IV) Kundërshtimi i Ligjit shtypës për të çrrënjësuar të gjitha llojet e tabuve sociale dhe zakoneve, si dhe paragjykimet fisnore dhe egërsia në bazë të ideve supersticioze. Kur’ani i Shenjtë thotë: “Ai (i Dërguari) urdhëron ata për të bërë mirë dhe i ndalon ata që të bëjnë gjithçka që është e paligjshme, i bën të ligjshëm të gjithë ata që janë të pastër dhe të paligjshëm ata që janë të ndyrë, heq barrën e tyre dhe pengesat në të cilat ata janë të përfshirë.”

(A’raf, 7:157)

(V) Ekspozimi i kotësive të rreme dhe e keqja do të vënë në dukje mënyra të gabuara të perëndive të rreme dhe sundues despotik dhe turpeve të tyre. Kur’ani i Shenjtë thotë: “Kështu, Ne i shpjegojmë argumentet tona në mënyrë që rrugët e mëkatarit mund të jenë qartë të dalluara.” (En’am, 6:55)

(VI) Krijimi i një shoqërie të bazuar në drejtësi. Profetët themeluan një shoqëri në të cilën njerëzit duhet të vendosin drejtësinë dhe të trajtojnë të tjerët pa ndonjë konsideratë të qëllimtë, besim, politik apo dallimet ekonomike. Funkcioni kryesor i profetëve ishte të ngulisin në zemrat e njerëzve një besim të fortë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit dhe për të krijuar në individin dhe në shoqëri të tilla standarde morale, si dhe të ngjallë në ta shpirtin e drejtësisë dhe barazisë ndaj shokëve të tyre. Kur’ani i Shenjtë thotë: “Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata Librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës.



Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t'u ditur tek Allahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të Dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S'ka dyshim se Allahu është i Fuqishëm, Mbizotërues". (57:25)

Që një shoqëri e drejtë varet nga shpirtërorja, si dhe fuqia materiale, pikat e ajetit të mësipërm-përmendin dy fuqitë, që është Libri dhe drejtësia. Dhe secili prej tyre është e nevojshme për vendosjen e drejtësisë.

Vëllazëria në Islam

Islami ka kritikuar shumë fuqishëm diskriminimin në mesin e klasave të ndryshme të njerëzve. Kur'anit i Shenjtë thotë: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëme popuj e fise që të njiheni ndërmjet njëri-tjetrit, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që është ruajtur më tepër (këqijat), e Allahu është hollësisht i Njohur për çdo gjë." (49:13)

Nga argumentet e Tij është krijimi i Qiejve e i Tokës, ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz. (30:22)



Prof. dr. Arqile Boti

Muaji i begative, muaji i shëndetit

Abstrakt

Edhe pse agjërimi nuk ka qenë normë e caktuar vetëm për besimtarët myslimanë, por edhe për besimtarët e të gjitha besimeve të të gjithë librave të Zotit, format dhe koha e agjëritit kanë qenë të ndryshme në periudha të ndryshme të historisë fetare. Me zbritjen e Kur'anit famëlartë, Zoti e përcaktoi dhe e vulosi formën e agjëritit të plotë të të gjithë besimtarëve. Kjo, për arsye se Kur'ani i përmbledh të gjithë Librat e mëparshëm.

Muaji i agjëritit, muaji i shëndetit

Agjërimi, nocioni i të cilit përbën një ndër elementët bazë të detyruar të çdo feje monoteiste, duke pasur disa ndryshime më tepër në formë, në esencën e vet përbën një detyrim të vendosur nga Zoti për çdo besimtar. Po cilat janë mirësitë shëndetësore dhe shpirtërore të agjëritit?

Kjo është ajo që shumë herë diskutohet nga shumica e njerëzve, edhe pse agjërimi nuk ka qenë formë e caktuar vetëm për besimtarët myslimanë, por edhe për besimtarët e të gjitha besimeve të të gjitha librave të Zotit. Format dhe zgjatjet e agjëritit kanë qenë të ndryshme në periudha të ndryshme të historisë fetare, duke arritur pikën kulmore në agjërimet që në dukje janë të vështira, por që kalohen lehtë nga shkallat e besimit të Zotit. Zoti, me zbritjen e Kur'anit famëlartë e përcaktoi dhe e vulosi formën e agjëritit të plotë të të gjithë besimtarëve. Këtë, për arsye se Kur'ani i përmbledh të gjithë librat e mëparshëm. Historiku i agjëritit është mjaft i gjerë, ashtu si edhe format që të parët tanë besimtarë të të gjithë librave të Zotit e kanë praktikuar.

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2011



Agjërimi në aspektin fetar dhe filozofik

Dihet qartë se qenia njerëzore është krijuar prej Zotit dhe përbëhet prej trupit material (krijuar prej balte) dhe shpirtit, ose frymës, që është një element jomaterial dhe përbën elementin jetësor të njeriut dhe që përbën një imazh të largët të vetë natyrës së Zotit. Shpirti manifestohet në këtë botë nëpërmjet trupit, ndërsa pas vdekjes shpirti ndahet prej trupit material, kur ky i fundit kalbet dhe kthehet në tokë, nga e cila është krijuar, ndërsa shpirti, duke qenë i paperceptueshëm nga organet tona të shqisave, kalon në një dimension tjetër hapësinor-kohor. Njeriu përbëhet prej materies dhe frymës dhe nëpërmjet agjërimit, në mënyrë simbolike, kalon drejt spiritualizmit të vullnetshëm duke dobësuar efektet që ushtron trupi material mbi shpirtin. Ky trup e shtyn shpeshherë njeriun drejt instikteve shtazore. Në këtë mënyrë, agjërimi në mënyrë simbolie e largon njeriun, që është krijesa më e lartë e Zotit, nga bota e kafshëve.

Agjërimi në aspektin psikologjik

Njeriu përbëhet prej tre komponentëve kryesorë. I pari është komponenti logjik, i cili kontrollon dëshirat dhe veprimet e njeriut, duke përfshirë emocionet dhe instiktet dhe lidhet me rregullat morale që vendos një shoqëri dhe që përbën sjelljen e individit në raport me shoqërinë.

Komponenti i dytë përbën atë emocional, ku përfshihet edhe ndjenja e dashurisë, e urrejtjes, e frikës etj... Duhet të dimë që emocionet e mirëfillta janë karakteristike vetëm për njeriun duke përfshirë edhe atë të dashurisë. Në fushën e fesë dashuria kapërcen kufirin e një dashurie thjesht midis dy sekseve dhe kalon në dashurinë për të gjithë njerëzit, duke i konsideruar vëllezër të vet, veçanërisht kur njerëzit i bashkon besimi te një Zot i Vetëm i Gjithësisë.

Komponenti i tretë i psikologjisë së njeriut përbëhet nga instiktet, ku hyn agresiviteti, urrejtja dhe instikti seksual, që është edhe karakteristike për kafshët. Kështu, për shembull, kur vjen koha



e riprodhimit, tek kafshët tërheqjen midis femrave dhe meshkujve nuk e bën dashuria, por instikti seksual, i cili shoqërohet nga agresiviteti. Është e qartë, se njeriu veçohet nga bota shtazore nëpërmjet logjikës dhe arsyesimit, me anë të të cilave kontrollojnë instiktet e shfaqura spontanisht te njeriu. Agjërimi, duke ulur shkallën e instikteve agresive ndihmon në ekuilibrimin psikologjik të njeriut, veçanërisht kur kemi çrregullime psikologjike dhe psikike. Me këtë rast, duhet të përmend që në shumë klinika psikiatrike u jepet të sëmurëve psikikë dhe atyre agresivë ushqim i bollshëm, duke përfshirë edhe atë shtazor, si mish, vezë, gjalpë etj..., por në të vërtetë, duhet që të sëmurët psikikë, veçanërisht ato që janë agresivë, të kalojnë në dietë urie që ul agresivitetin, nëpërmjet uljes së shkallës së instikteve agresive. Pra, agjërimi është mjet i fuqishëm për të ulur shkallën e agresivitetit edhe tek të sëmurët psikikë. Në këtë rast, agjërimi e ndan njeriun përfundimisht nga bota e kafshëve, ku në shumicën e tyre drejtojnë instiktet dhe jo logjika. Duhet të shtoj që shumë persona nuk janë të qartë pse feja islame dhe Dhiata e vjetër e ndalojnë përdorimin e mishit të derrit. Nga konsultimi që kam bërë në shumë libra fetarë dhe nga eksperiencia personale, mendoj që shkaku kryesor është se derri përbën një kafshë të papastër, se gjatë një akti seksual shkojnë disa meshkuj njëri pas tjetrit tek një femër, duke u bërë shkas për një papastërti ose miksturë gjenetike tek derrat e vegjël, kështu që përdorimi i këtij mishi të papastër gjenetikisht shton epshet negative seksuale, kështu që është i papërshtatshëm për t'u përdorur nga njeriu.

Agjërimi në aspektin social

Agjërimi duke ekuilibruar çrregullimet emocionale dhe instiktive të njeriut, siç theksuam më lart, çon në uljen e konflikteve familjare dhe shoqërore të shpërthimeve instiktive të pakontrolluara nga logjika, duke ndihmuar në shkallë të ndryshme së bashku me masa të tjera sociale në uljen e kriminalitetit, që sot përbën një problem serioz si brenda familjes, ashtu edhe jashtë saj. Dihet në psikologji se dhuna përbën paradhomën e kriminalitetit.



Agjërimi në aspektin mjekësor

Agjërimi, duke ulur sasinë e kalorive që futen në organizmin e njeriut, duke përfshirë dhe ngarkesën energjetike të lidhur direkt me sasinë e kalorive, ndihmon pozitivisht në uljen e gravitetit të disa sëmundjeve metabolie, si: diabeti, sëmundjet e stomakut (e vë stomakun në çlodhje relative), tensioni i lartë i gjakut dhe indirekt duke ulur sasinë e kalorive që merr në uljen e dhjamosjes, obezitetit, nëse agjërimi do kryhet në bazë të rregullave të vendosura nga feja nëpërmjet librave të shpalljeve. Në rastin e agjërimin të Ramazanit, duhet të theksojmë se agjërimi duhet të shoqërohet patjetër nga namazi, i cili përbën lutjen ndaj Zotit të paktën pesë herë në ditë, siç është shkruar edhe në Kur'an, dhe në bërjen e veprave të mira duke ndihmuar sa më shumë njerëzit e tjerë, vëllezër besimtarë. Nëse dikush agjëron dhe e ka mendjen si të grumbullojë para, ose ka urrejtje për një njeri, ose smirë për të, atëherë agjërimi i tij nuk është i plotë dhe është formal, sepse bëhet për t'u dukur. Pra, si agjërimi dhe namazi duhet të bëhen në emër të Allahut dhe për adhurimin e Tij dhe jo se është ndonjë meritë e personit vetë. Ne kemi nevoja shpirtërore dhe fizike në çdo kohë dhe krahas tyre agjërimi ndikon që jeta jonë e kësaj bote të jetë e suksesshme.



Shiu i mëshirës

Abstrakt

*Në Kur'anin famëlartë dija, udbëzimi dhe mëshira e Allahut i vijnë njeriut falë devotshmërisë së tij. Devotshmëria është fryti ynë gjatë gjithë vitit. Ky fryt mund të kanoset nga rreziqe si vesvesë, zbukurimet e jetës, epshi dhe mëkatet e ndryshme. Shfrytëzoheni devotshmërinë e grumbulluar për t'i luftuar këto rreziqe. Pas ftesës për agjërim, Kur'ani famëlartë e paraqit devotshmërinë si qëllimin kryesor të tij dhe thotë: **“O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë detyrim, sikurse u është bërë detyrim edhe atyre që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm”**. (Bekare, 183) Njerëzit e devotshëm janë si drurët e fuqishëm që rriten midis shkëmbinjve në zemër të maleve dhe të shkretëtirave, degët e të cilëve u rezistojnë tufaneve të fuqishme, diellit përvëlues dhe të ftohtit të dimrit. Edhe agjërimi e forcon shpirtin e njeriut. Përjetimi i urisë dhe etjes dhe heqja dorë nga kënaqësitë për një kohë të caktuar, i fal njeriut fuqinë për të rezistuar përballë vështirësive.*

Një ndër ndikimet psikologjike të agjërimin është fitimi i devotshmërisë dhe i vetëpërmbytjes. Edhe në Kur'anin famëlartë, dija, udhëzimi dhe mëshira e Zotit i vijnë njeriut si pasojë e devotshmërisë së tij. Dhe më e rëndësishmja, devotshmëria njeriut i sjell shpëtimin dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Ky rezervim i devotshmërisë është një dhuratë shumë e çmueshme e muajit të Ramazanit për njeriun. Ashtu si një bujk, i cili bën përpjekje të shumtë, e mbledh grurin e përfituar dhe atë ia dorëzon një personi të besueshëm për ta shfrytëzuar gjatë gjithë vitit, devotshmëria është fryti, rezerva jonë gjatë gjithë vitit.



Kjo rezervë vazhdimisht kanoset nga rreziqe si vesvesi, zbukurimet e jetës, epshi dhe mëkatet e ndryshme Kur'ani famëlartë pas ftesës për agjërim, arritjen e devotshmërisë, e paraqet si qëllimin kryesor të tij dhe thotë:

“O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë detyrim sikurse që ishte detyrim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (“El-Bekare”, 183)

Njerëzit e devotshëm janë si drunjtë e fuqishëm të cilët rriten në mesin e shkëmbinjve në zemër të maleve dhe të shkretëtirave dhe degët e tyre rezistojnë përballë tufaneve të fuqishme, diellit përvëlues dhe të ftohtit të dimrit. Edhe agjërimi forcon shpirtin e njeriut. Përjetimi i urisë dhe i etjes dhe heqja dorë nga kënaqësitë për një periudhë të caktuar, njeriut i fal fuqinë për të rezistuar përballë vështirësive. Një i ri që agjëron dhe heq dorë nga kënaqësitë e kësaj bote, ka vetëpërmbajtje e çon atë drejt rrugës logjike duke i forcuar besimin dhe vullnetin. Në këtë rast, në trupin e tij çlirohen energjitë e brendshme dhe ai shkon vetëm drejt veprave të mira dhe pozitive.

Kur'ani famëlartë, faktorët si, namazi, agjërimi, lutja dhe durimi i cilëson si shumë ndikues në forcimin e lidhjeve të njeriut me gjithësinë duke i rritur potencialin për t'u përballur me vështirësitë e jetës dhe rikujton se dobitë e këtyre veprave i kthehen vetë njeriut. Komentuesi dhe filozofi i madh iranian Al'plameh Tabatabai, thotë: *“Çdo njeri që dëshiron të arrijë në përsosuri duhet të kontrollojë ndjenjat dhe të mos përmbushë kënaqësitë fizike pa asnjë kusht. Rruga më e afërt është përmbajtja e epshit me të cilin njerëzit përballen gjatë gjithë kohës, si: epshi i barkut ku bën pjesë haja dhe pija dhe epshi seksual. Nëse njerëzit për një kohë të caktuar heqin dorë nga këto epshe dhe e praktikojnë këtë për një periudhë, padyshim që tek ata forcohet ndjenja e vetëpërmbajtjes.”*

Nga pikëpamja e profesor Motaharit, realiteti i devotshmërisë është si një mbretëreshë e fuqishme dhe e shenjtë, e cila forcon shpirtin dhe qetëson epshin dhe ndjenjat e tepërta. Ai, vetëpërmbajtjen dhe devotshmërinë i cilëson si nevojë për një jetë të logjikshme dhe thotë: *“Devotshmëria në kuptim të përgjithshëm është nevojë e jetës së çdo personi, i cili dëshiron të jetë njeri dhe të jetojë nën kontrollin e logjikës.”*



Ashtu siç thotë edhe imam Aliu se lënia e çështjeve të jetës në dorën e epshit është sikur të ngjitesh mbi një kalë të ashpër dhe të egër, i cili i merr kontrollin kalorësit duke e rrëzuar mbi tokë. Vetëpërmbajtja dhe devotshmëria janë sikur njeriu të ngjitet mbi një kalë të qetë dhe të edukuar mirë dhe kalorësi të jetë një njeri i shkathët dhe i përgatitur mirë për këtë punë. Ai e urdhëron me fuqi atë kalë dhe kali i bindet plotësisht atij.

Mendjeçelësia apo lehtësimi i punëve dhe çlirimi nga vështirësitë, janë nga efektet e tjera pozitive të devotshmërisë. Nga pikëpamja e Kur'anit, nën hijen e devotshmërisë njeriu i hapen dyert e mëshirës së Zotit duke krijuar kushtet që ai njeri të përfitojë edhe udhëzimin dhe mirësitë e Krijuesit. Ajetet e ndryshme tregojnë se nëse njeriu ka devotshmëri, atij i jepet fuqia për të bërë dallimin e së mirës nga e keqja.

Njeriu i cili nuk përfiton nga devotshmëria, ai është i pafuqishëm përballë dëshirave dhe kërkesave të tij fizike duke mos patur as mendim pozitiv për vetveten. Përballë tyre, njerëzit e devotshëm për shkak të kontrollit të epshit, kanë edhe vullnet të fuqishëm. Ky vullnet i fuqishëm dhe ky kontroll i epshit pengon devijimin e njeriut nga bazat e moralit duke parandaluar edhe mëkatet dhe gabimet në jetë. Kjo çështje sjell shëndetin moral dhe psikik të njeriut. Në një analizë të kryer në Iran mbi nivelin e ndikimit të agjërimit tek vullneti i njeriut, janë zgjedhur 67 studentë. Sipas këtij studimi, vullneti i këtyre studentëve pas agjërimit të muajit të bekuar të Ramazanit është forcuar dukshëm. Gjithashtu, edhe në një studim të kryer në Universitetin Griffith në Australi në vitin 1984 në lidhje me ndikimin e lutjeve dhe agjërimit, u arrit në përfundimin se agjërimit tek këta njerëz ka ndihmuar në reduktimin e pikëpamjeve dhe sjelljeve të tyre negative, ka parandaluar vuajtjet, ka përmirësuar fuqinë e vendimmarrjes dhe ka rritur potencialin e tyre për të krijuar lidhje me Zotin Fuqiplotë.

Njërin prej shokëve të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e pyetën: Çfarë është devotshmëria? Tha: A ke ecur ndonjëherë në ndonjë rrugë plot me gjemba?



U përgjigj: Po! Tha: Si ece? U përgjigj: Aty ku kishte gjemba nuk e vura këmbën. Shoku i Profetit ia ktheu: Atëherë dije se në rrugën e jetës ekzistojnë shumë gjemba. Nëse nuk shkon atje ku e ka ndaluar Zoti, atëherë ajo është devotshmëria.

Ndër vetitë e njerëzve të mirë është respektimi i të drejtave të njerëzve dhe mbrojtja e nderit të tyre. Edhe në Kur'anin famëlartë thuhet se është mirë që njeriu të heq dorë nga gjykimi për të tjerët pa qenë mirë i informuar për ndonjë çështje. Në ajetin 36 të sures Isra lexojmë:

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi”.

Çdokush e ka shijuar se disa gjëra në këtë jetë arrihen shumë me vështirësi, mirëpo, humbasin shumë lehtë. Nderi i njerëzve është një ndër këto çështje. Madje, kanë thënë se pas besimit, nuk ka gjë më të vlefshme se nderi i besimtarit. Nderi i njeriut është rezultat i një jetë përpjekjesh dhe që mund të humbasë vetëm në një çast të vetëm. Për këtë arsye, çnderimi i një vëllai mysliman është gjynah shumë i madh. Duke u bazuar në faktin se nderi është mbështetja kryesore e personalitetit të njeriut, mësimet fetare premtojnë se nëse dikush mbron dhe mbështet nderin e një vëllai besimtar, Zoti do ta mbrojë fytyrën e një njeriu të tillë nga zjarri i Xhehenemit. Për fat të keq, përgojimi dhe akuzat bëhen shkak për njollosjen dhe thyerjen e personalitetit të shumë njerëzve dhe për krijimin e pikëpamjeve negative. Këto i dobësojnë lidhjet shoqërore dhe nganjëherë shkaktojnë edhe përleshje që rezultojnë me gjakderdhje dhe vrasje.

Rëndësia e mbrojtjes dhe e mbështetjes së personalitetit të njeriut është aq e madhe, saqë kanë thënë se terrorizimi i personalitetit të një njeriu dhe rrëzimi i pozitës së tij shoqërore është edhe më i rëndë se vrasja e tij. Kjo për faktin se pasuria kryesore e njeriut në jetë është nderi dhe personaliteti i tij.

Imam Sadiku, nderin e njeriut e vlerëson në nivelin i Qabes dhe thotë: **“Nderi i besimtarit është më i lartë se i Qabes”.**

Me siguri, e dini se respektimi i Qabes është detyrim për të gjithë, kurse fyerja e saj është një gjynah shumë i madh. Mirëpo, respektimi i nderit dhe i personalitetit të njerëzve është edhe më i lartë se kjo.



Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Të gjitha gjërat e besimtarit si, nderi, pasuria dhe gjaku i tij, duhet të respektohen”**. I Dërguari i Zotit, në një vend tjetër na rikujton se Zoti Fuqiplotë ka thënë: **“Kush fyen njërin prej shokëve të mi, duhet ta dijë se ka hyrë në luftë me mua”**.

Gjendemi në netët më të vlefshme dhe më të lavdëruara të muajit të bekuar të Ramazanit, netë këto në të cilat fshihet edhe nata e cila konsiderohet si zemra e këtij muaji të bekuar.

Nata e zbritjes së Kur'anit, nata e dritës dhe e mëshirës dhe nata të cilën e kanë quajtur “Nata e Kadrit”. Për të paraqitur më mirë vlerën e kësaj nate, do të kërkojmë sërish ndihmën e fjalës së Zotit në Kur'anin famëlartë në suren “Kadr”:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në natën e Kadrit.

E ç'të bëri ty të dish se ç'është nata e Kadrit?

Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!

Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin melekë dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje.

Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit”.

Në natën e Kadrit, sofrë e mëshirës së Zotit është e gjerë sa e gjithë gjithësia. Në ajetet e sures “Kadr”, Zoti Fuqiplotë na rikujton se nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj. Në këtë natë që është edhe nata e zbritjes së Kur'anit, melekët zbresin në tokë grupe-grupe, vështrojnë tubimet e besimtarëve, lutjeve të tyre u përgjigjen me *amin* dhe kështu qëndrojnë deri në agimin e dritës: *Zoti ynë, me shpresë në mëshirën dhe faljen Tënde në natën e Kadrit, të drejtohem vetëm Ty. Sonte jemi zgjuar deri në mëngjes. Farën e mëshirës Tënde në zemrat tona e ujisim me lotët e pendimit, kurse shpirtin e pastrojmë nën shiun e mëshirës Tënde. O Zot! Natën tonë të errët nga gjynahet na e zbardh me diellin e faljes Tënde dhe na mundëso që edhe ne të jemi prej atyre që qëndrojnë zgjuar deri në agim në këtë natë të bekuar.*



Në lidhje me atë se nata e Kadrit është vetëm njëra prej netëve të vitit dhe se ajo gjendet në muajin e bekuar të ramazanit, nuk ekziston asnjë lloj dyshimi. Zoti fuqiplotë, në ajetin 185 të sures “El-Bekare” thotë se muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbritur Kur’ani, kurse në ajetin e parë të sures “El-Kadr”, Zoti, gjithashtu, thotë se Kur’anin është zbritur në natën e Kadrit. Nga këto dy ajete arrijmë në përfundimin se nata e Kadrit ndodhet në muajin e Ramazanit. Gjithashtu, edhe në thënie të ndryshme fetare është bërë e qartë se nata e Kadrit është njëra prej netëve të muajit të Ramazanit. Atëherë duhet që të mos jemi neglizhentë në këtë natë të shenjtë. Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e pyetën në lidhje me natën e Kadrit. Ai u përgjigj: “Natën e Kadrit kërkojeni në dhjetë netët e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit”.

Kurse në lidhje me arsyen se pse nata e Kadrit është fshehur midis netëve të muajit të Ramazanit, imam Aliu ka thënë:

“Zoti, atë natë (natën e Kadrit) e ka mbajtur të fshehur me qëllim që ju t’i kushtoni më tepër rëndësi asaj. Sikur Zoti t’ua kishte sqaruar dhe përcaktuar natën e Kadrit, ju do të ishit në kërkim të mirësive të vetëm asaj nate, duke barruar netët tjera.”

Imam Sadiku, duke shpjeguar rëndësinë e Natës së Kadrit për njërin prej shokëve të tij me emrin Abu Basir, thotë: “Në Natën e Kadrit caktohen ndodhitë, vdekjet dhe fatet deri në natën e ardhshme të Kadrit. Atëherë, Natën e Kadrit kërkoje në natën e 21-të dhe në natën e 23-të të muajit të Ramazanit. Fal namaz dhe sa të kesh mundësi, gjatë këtyre dy netëve qëndro zgjuar deri në agim”. Gjithashtu, nëse nuk mund të fal namazin duke qëndruar në këmbë, atëherë çfarë të bëj? Imami ia ktheu: “Falu ulur...bëj ibadet në çfarëdo mënyre të mundesh, sepse në këtë natë dyert e qiellit janë të hapura, shejtani është i lidhur me zinxhir dhe veprat e besimtarëve pranohen.” Abu Basiri, ky përcjellës i zgjuar i ngjarjeve, duke shtuar pyetjet dëshironte të arrinte deri tek e vërteta e natës së Kadrit dhe rëndësia e veprave në këtë natë. Kurse Imam Sadiku vazhdoi të këmbëngulte mbi rëndësinë e ibadetit në këtë natë duke thënë se edhe sikur njeriu



të jetë i sëmurë, nuk duhet të privohet nga mirësitë dhe begatitë e Natës së Kadrit.

Njerëzit të cilët përfitojnë nga begatia e informimit dhe dijes, e dinë shumë mirë rolin dhe detyrimin e tyre në natën e Kadrit. Nganjëherë, nata e Kadrit ndikon aq shumë te njeriu, saqë shenjat e këtij ndikimi mund të vërehen deri në natën e Kadrit të vitit të ardhshëm apo edhe deri në fund të jetës së tij. Kurse ata të cilët nuk arrijnë deri në këtë gradë të spiritualitetit, padyshim që në mënyrën e tyre përfitojnë aq sa duhet nga mirësitë e Natës së Kadrit. Rrënjët e kësaj çështjeje kanë të bëjnë me vetë njeriun dhe me atë se sa i përgatitur është shpirtërisht për të përfituar nga begatitë e kësaj nate të bekuar. Theksi që myslimanët të falin namaz dhe të luten gjatë kësaj nate është sepse përfitimi nga mirësitë e natës së Kadrit sërish kanë lidhje me përpjekjet dhe mundin e vetë njeriut. Mëshira dhe falja e Zotit në këtë natë lëshohet për të gjithë, kurse çdokush përfiton nga këto mirësi në bazë të dijes dhe njohurive që ka për Natën e Kadrit dhe në bazë të dosjes së veprave të tij. Çështja më e rëndësishme në Natën e Kadrit është largimi nga përtacia, devijimi dhe meditim i sinqertë.

Në natën e cila është më e mirë se një mijë muaj, a thua ka gjë më të mirë se sa kur njeriu ulet dhe mendon për fatin e tij, rishikon jetën e kaluar dhe gjen pikat e veta negative dhe pozitive. Në natën e Kadrit njeriu mund të programojë jetën e vet me qëllim që të arrijë në rrugën e lumturisë dhe të gëzimit. Në çastet e bekuara të kësaj nate, njeriu mund të ndryshojë pikëpamjen e tij për jetën dhe të arrijë në një horizont të ri. Leximi i Kur'anit dhe i lutjeve të preferuara në këtë natë ndihmon në forcimin e lidhjeve të njeriut me Zotin Fuqiplotë. Në këtë natë, njerëzit duke shkuar nëpër xhami dhe nëpër ambiente të tjera fetare, në një atmosferë përplot me spiritualitet përkrah njëri-tjetrit, madhërojnë dhe përmendin Zotin deri në mëngjes dhe nga Ai kërkojnë falje e mëshirë. Në këto tubime, zëri i lutjeve të besimtarëve ngrihet deri në qiell dhe në të gjitha anët dëgjohet zëri i këndimit të Kur'anit. Një prej traditave në tubimet e Natës së Kadrit është vendosja e Kur'anit mbi kokë. Lutësit në këtë natë, Zotit i betohen në Kur'anin



dhe në emrat e tij të lartësuar që ata t'i vendosë në radhët e atyre që janë falur dhe kanë shpëtuar. Një prej lutjeve të njohura në Natën e Kadrit është lutja “El-Xheushenul Kebir”. Në këtë lutje, e cila ka përmbajtje shumë të vlefshme, ne e madhërojmë Krijuesin e Gjithëditur, e adhurojmë dhe mbështetemi vetëm te mëshira dhe falja e Tij e pafund. Njeriu, duke përmendur këto lutje të ndritura, shpirtin e ngre lart në qiell, kurse i gjithë trupi i përfshihet nga një freski dhe gëzim. Në një pjesë të kësaj lutjeje lexojmë:

“O Udhëzues i të hutuarve; O Dëgjues i thirrjeve të thirrësve; O Ndihmues i ndihmëkërkesve; O Strehues i strehimkërkesve; O Qetësues i atyre që frikësohen; ONdihmues i besimtarëve; O mëshirues i meskinëve; O Strehues dhe o Falës i mëkatarëve; O Pranues i lutjeve të të dobëtëve; Ti je i Pastër, o Krijues që nuk ka Zot tjetër përveç Teje; Na shpëto nga zjarri i Xhehenemit, o Perëndi”.

Muaji i bekuar i Ramazanit është si një shi i pastër dhe i çiltër që bie për banorët e tokës duke i kënaqur njerëzit me begatitë dhe faljen e Zotit. Ditët dhe netët e këtij muaji të bekuar, njeriut i mundësojnë që të gjejë vetveten dhe nën shiun e mëshirës së Zotit të pastrojë dhe të freskojë shpirtin. Besimtarët e dinë se në të gjitha kushtet duhet të mbështeten tek Zoti Fuqiptotë dhe vetëm prej Tij të kërkojnë ndihmë. Strehimi tek madhështia e Zotit në ditët dhe netët e bekuara të muajit të Ramazanit, bëhet shkak për zbritjen e mëshirës dhe faljes së veçantë të Zotit për robtë.

Një prej çasteve më të ëmbla të jetës së çdo njeriu është kur pa asnjë interes, zgjidh ndonjë problem të njerëzve. Kur njeriu nga pasuria e tij ushqen një të varfër apo ndonjë person të mbetur në rrugë, e vesh ndonjë jetim duke i sjellë buzëqeshje në fytyrën e tij, padyshim që ai ka kënaqur edhe Zotin me këto vepra. Ndër rezultatet interesante të agjërimit është ngjallja e ndjenjës së solidaritetit me njerëzit e tjerë dhe në veçanti me nevojtarët dhe të varfërit. Ata të cilët kanë jetë të mirë dhe nuk kanë shijuar varfërinë dhe urinë, ndodh që të mos jenë të njohur me gjendjen



e nevojtarëve. Agjërimi është një mjet i cili njerëzit e pasur i zgjon nga gjumi duke i njohur edhe me dhimbjen e urisë dhe të etjes. Në këtë mënyrë, i pasuri afrohet me të varfrin, atij i ngjallen ndjenjat njerëzore duke i zbutur edhe zemrën. Në këtë rast, ata të cilët kanë përfituar nga begatitë e Zotit i kushtojnë rëndësi ndihmës ndaj nevojtarëve dhe të varfërve dhe mendojnë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Me këtë ndryshim, në shoqëri fillon të përhapet shpirti i mirësisë duke bërë të duken edhe vlerat e pastra morale. Hishami, një prej shokëve të imam Sadikut, e pyeti imamin për shkakun e agjëritimit. Imami tha: **“Zoti e ka caktuar agjërimin që i pasuri dhe i varfri të bëhen të barabartë. I pasuri asnjëherë nuk e ka shijuar urinë që të kuptojë të varfrin dhe sa herë që ka dëshiruar diçka, ka pasur fuqinë për ta arritur atë. Zoti deshi që midis robve të tij të krijohet një ekuilibër dhe deshi që edhe i pasuri ta shijojë urinë. Nëse nuk do të ndodhte kështu, i pasuri nuk do të mëshironte të varfrit dhe nevojtarët.”**

Për këtë arsye, në muajin e bekuar të Ramazanit është porositur shumë për mirësi dhe ndihmë për nevojtarët dhe të varfrit.

Kur një person, një pjesë të pasurisë së tij ua fal nevojtarëve për të fituar kënaqësinë e Zotit, kjo quhet falje. Vlera e faljes në Islam është aq e madhe saqë në mbi 80 ajete të Kur'anit është folur për këtë çështje. Zoti Fuqiplotë, duke shpjeguar imazhin e lutësve dhe besimtarëve të vërtetë, ata i quan falës dhe në ajetet 24 dhe 25 të sures Me'arixh thotë:

“Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë në një pjesë të caktuar për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp.”

Personat që një pjesë të pasurisë së tyre në mënyrë javore, mujore apo vjetore e japin në rrugën e Zotit, ata konsiderohet falës. Është interesant fakti që Zoti këtë vepër të tyre e kompenson duke i dhënë shpërblim të shumëfishtë. Në ajetin 261 të sures “Bekare” lexojmë:

“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej së cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra.



Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”

Ndërsa në suren “Sebe”, falja e pasurisë në rrugën e Zotit është cilësuar si një tregti me Zotin ku në njërën anë qëndron ai që jep, kurse në anën tjetër qëndron Krijuesi Fuqiplotë, i cili nuk ka nevojë për asgjë. Në Kur’an, falësit janë njoftuar se atë që ata e japin në rrugën e Zotit, Zoti atyre atë ua plotëson në një mënyrë edhe më të mirë në jetën e tyre. Pra, ai që fal dhe ndihmon vazhdimisht është në tregti shumë fitimprurëse me Allahun Fuqiplotë. Kjo, për faktin se kjo falje atyre ua fal gjynahet dhe me anë të saj, ai është vazhdimisht në tregti me Zotin, i cili është Shpërblyesi më i Mirë.

Në një studim të gjerë të kryer nga disa psikologë në vitin 1991 për të përcaktuar personat ndihmues, u arritën rezultate shumë interesante. Sipas këtij studimi, ata njerëz të cilët ndihmojnë të tjerët, nga aspekti i psikologjisë sociale, janë shumë solidarë me të tjerët. Ata janë njerëz shoqëror dhe besojnë se duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar të tjerët. Ata besojnë në ekzistencën e drejtësisë në botë dhe botën e vështrojnë në atë mënyrë që njeriu fiton rezultatin e veprave të tij të mira dhe të këqija. Një prej vetive të njerëzve ndihmues është ajo që ata shumë mirë mund ta kontrollojnë brendinë e vet dhe sjelljet e njerëzve të tillë kanë rezultate pozitive maksimale dhe rezultate negative minimale. Tek këta njerëz, niveli i egoizmit është në shkallën më të ulët. Kurse në anën tjetër, njerëzit të cilët nuk ndihmojnë të tjerët janë egoistë dhe mendjemëdhenj.

Për të ndihmuar nevojtarët, padyshim, që ekzistojnë rregulla të caktuara. Duke u bazuar në faktin që Islami është një fe e ekuilibruar, njerëzit i porosit që të mos kalojnë në ekstrem gjatë ndihmave që u japin nevojtarëve. Kur’ani famëlartë, ata që ndihmojnë i tregon si njerëz të ekuilibruar. Ata nuk janë të atillë që të gjithë pasurinë e tyre t’ua japin nevojtarëve, kurse familjen e tyre ta mbajnë të uritur. Mirëpo, ata gjithashtu, nuk janë aq të ngurtë që të tjerët të mos mund të përfitojnë asnjë ndihmë prej tyre.



Padyshim, ndihma dhe falja ka edhe kushte të tjera. Një prej këtyre kushteve është që pasuria e tyre të jetë e fituar në rrugë të lejuar (hallall), të jetë rezultat i mundit dhe i djersës së tyre. Personit që jep ndihma nga pasuria të cilën e ka fituar në mënyrë të paligjshme apo duke konfiskuar pasurinë e ndonjë jetimi apo ndonjë të pambrojturi, kjo ndihmë nuk i ka asnjë vlerë pranë Zotit Fuqiplotë. Kurse një kusht tjetër shumë i rëndësishëm që është përmendur në Kur'an dhe në hadithe të shumta, është që ndihma të kryhet pa asnjë lloj interesi dhe duke mos e fyer apo poshtëruar nevojtarin. Në një hadith të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet:

“Kur ndonjë nevojtar kërkon diçka prej jush, mos ia ndërprisni fjalën, derisa ai të shprehë mendimin dhe qëllimin e tij. Pastaj, atij përgjigjuni me butësi, mëshirë dhe respekt. Ndhimoheni atë në bazë të mundësive tuaja, ose në mënyrë shumë të denjë kërkonti ndjesë për pamundësinë tuaj për ta ndihmuar, sepse nevojtarin mund të jetë një melek që është dërguar për të sprovuar reagimin tuaj ndaj begative që Zoti u ka falur juve.”

Gjithashtu, njerëzit që ndihmojnë janë porositur që të japin nga ajo pasuri të cilën e duan edhe vetë dhe këtë të mos e bëjnë për të fituar emër apo për t'u treguar të mirë përpara të tjerëve.

Imam Aliu ka thënë:

“Sa herë që të përballeni me varfëri, me faljen e asaj që keni dhe me lëmoshë bëni shkëmbim me Zotin në mënyrë që Zoti nëpërmjet kësaj rruge t'ju largojë varfërinë.”

Shpresa në mëshirën dhe faljen e Zotit është një çështje, të cilën agjëruesit në muajin e Ramazanit e ndiejnë më shumë se në kohët tjera. Në ajete të ndryshme të Kur'anit famëlartë, besimtarëve u janë dhënë shpresa të shumta për mëshirën dhe bujarinë e pafund të Zotit duke i ftuar që të largohen nga pesimizmi dhe dëshpërimi.

Në ajetin 87 të sures “Jusuf”, Zoti Fuqiplotë thotë:



“(Jakubi u tha bijëve të tij) O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun.”

Shpresa është si një motor që e çon njeriun drejt ngritjes dhe lumturisë. Për këtë, në mësimet islame, pesimizmi dhe dëshpërimi konsiderohen si mëkate të mëdha. Shkrimtari francez Gustav Lebon, thotë: *“Shërbimin më të madh kësaj bote ia kanë bërë ata persona të cilët kanë mundur t’i mbajnë gjallë shpresat tek njerëzit.”* Nëse i hedhim një vështrim mësimëve fetare, do të arrijmë të kuptojmë se këto mësimë njeriun e çojnë drejt një jete me qëllim të caktuar dhe të mbushur me lëvizje dhe shpresë. Në përgjithësi, mësimet fetare janë faktor për krijimin e vullnetit tek njeriu dhe largimin e faktorëve që sjellin dëshpërimin dhe pesimizmin tek ai. Nga ana tjetër, feja, kujtimin e vazhdueshëm të Zotit dhe shpresën tek mëshira e pafund e Zotit e cilëson si bazë të shëndetit psikik të njeriut dhe të shoqërisë.

Njerëzit, për shkak të disa problemeve dhe humbjes së disa rasteve, ndodh që të ftohen dhe humbin shpresat. Mirëpo, ata të cilët kanë besim të patundur në mëshirën e Zotit nuk mbesin në baltën e dëshpërimit dhe shumë shpejt ngadhënjëjnë dobësinë dhe pesimizmin e tyre. Besimtarët janë të bindur në ndihmën e Zotit. Ai është po Ai, Zoti, i Cili dëgjoji lutjen e Junusit (paqja qoftë mbi të!) nga barku i peshkut në thellësi të detit dhe e pranoi atë në kohën kur shpëtimi i Junusit dukej një punë shumë e vështirë. Padyshim, që Zoti Fuqiplotë dhe i Gjithëditur dëgjon lutjen e një personi, i cili ndodhet në kulmin e dëshpërimit dhe të pesimizmit dhe atë nuk e lë të vetëm në valën dhe tufanet shkatërrimtare të jetës. Ky premtime është dhënë edhe në Kur’anin famëlartë ku në suren “Shura” ajeti 28 thuhet:

“Dhe Ai është që e lëshon shiun, pasi që ata t’i kenë humbur shpresat dhe Ai shtrin mëshirën e Vet; Ai është Mbikëqyrësi i Lavdëruari.”



Sa mirë është kur njeriut në momentet kur të gjitha dyert i ka të mbyllura dhe nuk ka asnjë shpresë për të shpëtuar, mbi të bie shiu i mëshirës së Zotit dhe në zemrën e tij mbijnë gonxhet e shpresës. Për këtë arsye, në mendimet e besimtarëve të drejtë nuk ka vend për pesimizëm dhe ata mendojnë vetëm për shpresë dhe optimizëm.

Në pikëpamjen monoteiste, shpresa është një dhuratë e çmueshme e cila e fut në lëvizje motorin e jetës. Optimizmi dhe shpresa tek njeriu forcojnë mendimet pozitive. Kurse mendimi pozitiv forcon dyfish më tepër vullnetin e njeriut duke i falur energjinë dhe fuqinë e nevojshme për të vazhduar jetën.



Vullnet Merja

Fjalor Kur'anor enciklopedik

Kur'ani është Libri i Allahut të Madhëruar që ia shpalli të Dërguarit të Tij, Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) nëpërmjet melekut të shpalljes, Xhebrailit (*paqja qoftë mbi të!*). Kur'ani ka zbritur në gjuhën e pastër arabe që t'i nxjerrë njerëzit prej errësirave në dritë dhe t'i udhëzojë ata në rrugën e drejtë. Ai është Libër i shenjtë të cilin myslimanët në mbarë botën e mësojnë, e studiojnë, e lexojnë dhe e praktikojnë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nuk ka dyshim se ky (Kur'an) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.”**

Kur'ani fisnik është mrekullia e përjetshme me anë të të cilit Allahu i sfidon dhe do të sfidojë popujt e çdo vendi dhe të çdo kohe. Kur'ani nuk është Libër i posaçëm vetëm për arabët. Ai është Libri i mbarë njerëzimit. Kurani shoqërohet në arabisht nga mbiemri *kerim* (fisnik, i nderuar, me dinjitet).

Që në kohët e shkuara, njerëz të ndryshëm kanë përpiluar ligje të shumta dhe kanë hartuar sisteme teorike dhe morale të shumta duke mëtuar se ato mund të udhëheqin njerëzimin. Por, asnjë nga këto ligje nuk i ka qëndruar rrjedhës së historisë. Ato kanë qenë gjithmonë të ndryshueshme sepse janë përpiluar nga njerëzit. Ndryshe është me ligjet e Kur'anit.



Ato kanë mbetur të qëndrueshëm përgjatë shekujve dhe ashtu do të qëndrojnë përgjithmonë sepse janë ligje të Allahut.

Përmbajtja e Kur'anit është aq e madhërishme, saqë i ka bërë dijetarët dhe intelektualët të meditojnë për madhështinë e këtij Libri epokëbërës.

Kur'ani përmban:

Ajete që flasin për besimin:

Ajete që flasin për monoteizmin; ajete që flasin për Allahun dhe cilësitë e Tij; ajete që flasin për profetësinë, për profetët dhe historitë e tyre; ajete që flasin për Ringjalljen; ajete që flasin për Ditën e Gjykimit; ajete që flasin për Xhenetin; ajete që flasin për Xhehenemin; ajete që flasin melekët; ajete që flasin për Librat e mëparshëm (Teurati, Inxhili, Zeburi, Broshurat e Ibrahimit.); ajete që flasin për xhindet; ajete që flasin për Gajbin (të padukshmen); ajete që flasin për shpirtin; ajete që flasin për çështjet ekonomike; ajete që flasin për drejtësinë; ajete që flasin për jetën e kësaj dynjaje; ajete në të cilat kanë të bëjnë me çështje shkencore (biologjinë, fizikën, astronominë, etj.; ajete që flasin për krijimin e njeriut; ajete që flasin për krijimin e Gjithësisë.

Ajete që flasin për etikën:

Ajete që flasin për adhurimet: për namazin; agjërimin; për haxhin; për zekatin; për urdhërimin në të mira dhe ndalimin nga të këqijat; ajete që flasin për çështjet shoqërore (marrëdhëniet mashkull femër, marrëdhëniet me të tjerët) ajete që tregojnë se cila është rruga e drejtë, e vërtetë dhe e shpëtimit; ajete në të cilat përmenden popujt e shkuar; ajete në të cilët përmendet merimanga, mushkonja, milingona dhe bleta; ajete, në të cilat përmenden disa kafshë si, lopa, dhia, dashi, elefanti, ujku, etj.

Fillimi i shpalljes së Kur'anit është Nata e Kadrit, siç thotë Allahu në suren “Kadr”, ajeti 1: **“Ne e kemi zbritur (Kur'anin) në Natën e Kadrit.”** Dhe në suren “Duhan” ajeti, 3:



“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar...” Sipas komentuesve të shquar të Kur'anit, kuptimi i fjalisë **“në një natë të bekuar”** është për Natën e Kadrit.

Kur'ani i ka zbritur Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) për 23 vjet, 13 vjet në Mekë dhe 10 vjet në Medine. Në Mekë kanë zbritur 86 sure dhe në Medine 28 sure. Kur'ani ka 114 sure me emërtime të veçanta. Suret përbëhen nga një numër i ndryshëm ajetesh, (*āyāt*) gjithsej 6236 ajete.

Çdo sure e Kur'anit fillon me *bi-smi llāhi r-rahmāni r-rahīm* (*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*), përveç të sures “Teube”, e cila nuk fillon me *bi-smi llāhi r-rahmāni r-rahīm*. Kjo thënie, *bi-smi llāhi r-rahmāni r-rahīm*, përsëritet dy herë në suren “Neml”, një here në fillim të sures dhe në ajetin 30. Në këtë mënyrë, *bi-smi llāhi r-rahmāni r-rahīm*, përmendet gjithsej 114 herë, domethënë aq sa është numri i sureve në Kur'an.

Kurani është burimi themelor i ligjshmërisë islame (Sheriati)

Të parat ajete që i kanë zbritur Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) kanë qenë pesë ajete e para të sures “Alak”: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)! E krijoi njeriun nga një droçkë gjaku. Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi; ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”**

Ka shumë ajete të Kur'anit të cilat flasin për njohjen dhe veçoritë e tij.

1 – Kur'ani është shpallje nga Allahu

“...Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet...”¹

“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...”²

1. Sure “En'am”, ajeti 19.

2. Sure “Isra”, ajeti 82.



“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me argumente të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”³

“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët”⁴

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur’anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrënoqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, pastaj qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu...”⁵

2- Kur’ani është dritë dhe mëshirë për mbarë njerëzit

“...Juve ju erdhi prej Allahut dritë dhe Libër i qartë.”⁶

“O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi a.s.) nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kur’ani).”⁷

(Thuaju o Muhamed): “Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj.”⁸

“Natyrisht, Kur’ani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!”⁹

3. Sure “Bekare”, ajeti 185.

4. Sure “Furkan”, ajeti 1.

5. Sure “Zumer”, ajeti 23.

6. Sure “Maide”, ajeti 15.

7. Sure “Nisa”, ajeti 174.

8. Sure “En’am”, ajeti 104.

9. Sure “Hakka”, ajeti 48.



3- Kur'ani është libër i qartë dhe ndarës i së vërtetës nga e pavërteta

“Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të të Denjit për çdo lavd.”¹⁰

“...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë...”¹¹

“Ky është një Kur'an, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”¹²

“Tâ, Sîn. Këto janë ajetet e Kur'anit, të një Libri të qartë, një udhërrëfyesi dhe lajmi të mirë për besimtarët.”¹³

4- Kur'ani është shpjegues i gjithçkaje. Ai është e vërteta dhe thotë vetëm të vërtetën

“...Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.”¹⁴

“...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë...”¹⁵

“Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë...”¹⁶

Ata thonë: “Ai e ka trilluar atë! Jo, ai (Kur'ani) është e Vërteta nga Zoti yt për të paralajmëruar popullin, të cilit nuk i ka ardhur kurrfarë paralajmëruesi para teje...”¹⁷

“Ky është Libri Ynë, që do t'ju tregojë të vërtetën...”¹⁸

10. Sure “Ibrahim”, ajeti 1.

11. Sure “Nahl”, ajeti 89.

12. Sure “Isra”, ajeti 106.

13. Sure “Neml”, ajetet 1 dhe 2.

14. Sure “En'am”, ajeti 38.

15. Sure “Nahl”, ajeti 89.

16. Sure “Kehf”, ajeti 29.

17. Sure “Sexhde”, ajeti 3.

18. Sure “Xhathijeh”, ajeti 29.



5- Kur'ani është udhëzues që udhëzon tek e drejta dhe tek e vërteta

“Elif, Lâm, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të përkushtuarit (të devotshmit).”¹⁹

“Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur’ani). Me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe çon në rrugën e drejtë.”²⁰

“Në të vërtetë, ky Kur’an udhëzon drejt asaj që është më e mira...”²¹

Kur’ani është i begatë dhe vërtetues i librave të mëparshëm

“Ky (Kur’an) është një Libër i bekuar, të cilin ta kemi shpallur ty (o Muhamed), si vërtetues të atij (Teuratit) që gjendet para tij...”²²

Ndërsa ky (Kur’an) është Këshillë e bekuar, të cilën Ne e kemi shpallur, prandaj, si mund ta mohoni ju atë?!²³

“...Ka sjellë të vërtetën dhe ka pohuar atë që thoshin të dërguarit e mëparshëm.”²⁴

Ky (Kur’an) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi ajetet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.”²⁵

“Ata, që e shpallin të Vërtetën dhe që i besojnë asaj, pikërisht ata janë të përkushtuarit.”²⁶

“Kush është më i keq se ai që trillon gënjeshtër për Allahun dhe hedh poshtë të Vërtetën (Kur’anin), kur ajo i vjen atij?! ”²⁷

19. Sure “Bekare”, ajetet 1 dhe 2.

20. Sure “Maide”, ajetet 15 dhe 16.

21. Sure “Isra”, ajeti 9.

22. Sure “En’am”, ajeti 92.

23. Sure “Enbija”, ajeti 50.

24. Sure “Safat”, ajeti 37.

25. Sure “Sad”, ajeti 29.

26. Sure “Zumer”, ajeti 33.

27. Sure “Zumer”, ajeti 32.



6- Kur'ani është fjala më e bukur

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës...”²⁸

“Ndiqni më të mirën e asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj...”²⁹

7- Kur'ani është mrekulli

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit a.s.), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij!...”³⁰

Thuaju (o Muhamed!): “Sillni dhjetë sure të ngjashme (në bukuri dhe elokuencë) të trilluara dhe thirrni në ndihmë kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën!”³¹

Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.”³²

8- Kur'ani është këshillues, përgëzues dhe qortues

“...Në këtë sure të ka ardhur ty e vërteta. Ajo është këshillë dhe kujtesë për besimtarët.”³³

“...(një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij, dënim të ashpër (për jobesimtarët) dhe për t'u dhënë lajmin e mirë besimtarëve...”³⁴

28. Sure “Zumer”, ajeti 23.

29. Sure “Zumer”, ajeti 55.

30. Sure “Bekare”, ajeti 23.

31. Sure “Hud”, ajeti 13.

32. Sure “Isra”, ajeti 88.

33. Sure “Hud”, ajeti 120.

34. Sure “Kehf”, ajeti 2.



“Ne e kemi bërë atë (Kur'anin) të lehtë, në gjuhën tënde, vetëm që nëpërmjet tij ti t'u japësh lajmin e mirë besimtarëve të përkushtuar dhe të paralajmërosh njerëzit kokëfortë.”³⁵

Kur'ani në hadithe

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qoshin mbi të!) ka thënë: *“Kur'ani është sofrë e Allahut, prandaj mësoni sa të mundeni nga kjo sofrë. Vërtet, Kur'ani është litari i Allahut dhe dritë e qartë. Është shërues dhe dobiprurës. Është mbrojtës për atë që e zbaton dhe shpëtues për atë që e pason. Nuk numërohen mrekullitë e tij. Prandaj lexojeni atë sepse Allahu do t'ju shpërblejë me dhjetë të mira për çdo germë...”*³⁶

Dhe: *“Ndriçoni shtëpitë tuaja me këndimin e Kur'anit, sepse asaj shtëpie në të cilën këndohet shpesh Kur'ani, i shtohen mirësitë dhe banorët e saj janë të lumtur. Ata u japin dritë banorëve të qiellit, ashtu siç japin dritë yjet për banorët e kësaj bote.”*³⁷

Dhe: *“Nëse dikush dëshiron të flasë me Zotin e tij, le të lexojë Kur'anin.”*³⁸

Kur'ani sipas dijetarëve jomyslimanë

Dr. E. Marshall Johnson, profesor nderi i anatomisë dhe i biologjisë zhvillimore në universitetin “Thomas Jefferson”, Filadelfia, Pensilvani, SH.B.A, thotë: *“Kur'ani nuk përshkruan vetëm zhvillimet e formës së jashtme, por vë në dukje edhe fazat e brendshme, fazat brenda embrionit, të krijimit dhe të zhvillimit të tij, duke theksuar etapat kryesore të njohura nga shkenca bashkëkohore.”* Ai ka thënë, gjithashtu: *“Si shkencëtar, unë mund të pajtohem vetëm me gjërat të cilat i shoh në mënyrë specifike. Unë mund të kuptoj embriologjinë dhe biologjinë zhvillimore. Unë mund të kuptoj fjalët që më janë përkthyer nga Kur'ani.”*

35. Sure “Merjem”, ajeti 97.

36. Mexhmaul Bejan; vëll. 1, f. 16

37. Ud'etud Da'i, f. 268-269.

38. Kenzul Ummal, hadithi 2257.



Siç dhashë një shembull më parë, duke pasur këto njohuri që kam sot, nuk do të mundesha t'i përshkruaja gjërat që janë përshkruar në Kur'an..."

Dr.Yoshihide Kazai, profesor nderi në universitetin e Tokios thotë: *"Jam shumë i impresionuar që kam gjetur fakte të vërteta astronomike në Kur'an."*

Ne, astronomët modernë, studionim vetëm pjesë të vogla të Gjithësisë dhe i përqendronim përpjekjet tona për të kuptuar vetëm një pjesë shumë të vogël të saj. Duke përdorur teleskopët, ne mund të shohim vetëm disa pjesë të vogla të qiellit, pa menduar tërë universin. Por, duke lexuar Kur'anin dhe duke iu përgjigjur pyetjeve, mendoj se mund të gjej rrugën time të ardhshme për hulumtimin e universit."

Johan Wolfgang von Goethe (Gëte), thotë për Kur'anin: *"Qoftë e lavdëruar nata e bekuar, në të cilën, Pejgamberit të Zotit, iu shpall, nga lart, Kur'ani, me përkryeshmërinë e tij."*

"Sa herë që ne i drejtohemi Kur'anit, në fillim nuk na tërheq, por, ai gjithnjë bëhet edhe më shumë tërheqës, na mallëngjen dhe në fund na detyron ta nderojmë... Stili i tij, në pajtim me kontekstin dhe qëllimin e tij, është madhështor dhe i mrekullueshëm, gjithnjë i lartësuar. Kështu, ky libër, do të ushtrojë ndikim shumë të fuqishëm, gjatë kohës."

"Kur'ani duhet parë si Ligji i Krijuesit dhe jo si ndonjë libër njerëzor, i bërë për edukim apo për argëtim."

"Ndoshta, në asnjë gjuhë tjetër shpirti, fjala dhe shkrimi nuk mund të trupëzohen në mënyrë kaq origjinale."

"Askush nuk duhet të habitet me efektshmërinë e lartë të Librit. Për këtë, ai është cilësuar si fjalë e Zotit nga admiruesit e tij të vërtetë."

"Dhe, do të mbetet ky libër, përjetësisht, me efektshmërinë më të lartë."

SUSEH (orientalist çifut) thotë: *"Kur bën dallimin në mes tekstit kur'anor dhe librave të tjerë qiellorë, vërteton faktin për zëvendësimet dhe ndryshimet që pësuan librat e shenjtë të çifutët dhe tek të krishterët. Kjo është një e vërtetë për të cilën të gjithë mendimtarët e mirëfilltë të feve pajtoben."*³⁹

39. www.dardania.de



NAPOLEONI: Napoleoni i parë (1769-1821), perandor i Francës, kur hyri në Egjipt në vitin 1812, u mahnit pas drejtësisë dhe madhështisë së besimit islam. Rreshtat e mëposhtëm janë marrë nga vepra “Bonaparte et Islam” të Cherfilsit. Napoleoni thoshte: *“Musai e ka lajmëruar popullin e vet, Isai, ithtarët e vet, kurse Muhammedi e ka lajmëruar tërë botën se ekziston Allahu i Madhëruar dhe është vetëm Një. Në Gadishullin Ballkanik mbisundonte paganizmi. Gjashtë shekuj pas Isait, Muhammedi u predikoi arabëve Allahun e Madhëruar, për të cilën u munduan edhe Ibrahim, Isai, Musai. Arianët (të krishterët që i takojnë Ariusit), që iu bashkëngjitën arabëve dhe ata që duke prishur besimin, fenë e Isait dëshirojnë të përhapin një besim të ri me tre zota (d.m.th. Allahu, biri i Allahut, Shpirti i Shenjtë) e prishnin krejtësisht rehatinë dhe paqen e Lindjes. Muhammedi (paqja dhe bekimet e Allahut qoshin mbi të!) u tregoi atyre rrugën e drejtë. U tha arabëve se Allahu i Madhëruar është Një dhe Ai nuk ka as baba e as bir. Besimi në shumë zota është një zëkon i pakuptimtë që ka mbetur nga paganizmi.”*⁴⁰



40. “Bonaparte et Islam” të Cherfilsit.

Prof.dr. HAJRI SHEHU

HAXH, 2010

“I kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut!”

(Sure “Bekare”, 196)

Siç dihet, Islami ngrihet mbi pesë shtylla. Ato janë detyrat e detyrimet fetare themelore të çdo myslimani. Njëra prej tyre është haxhi, vizita e Qabes, e Ndërtesës së Shenjtë në Mekë (arabisht: Ka’ba – Shtëpia e Zotit). Një herë gjatë jetës. Në Kur’an, në suren (kreun) “Ali Imran”, në ajetet 96, 97 thuhet: “Shtëpia e parë, e ndërtuar për njerëz (Qabja) është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë). Aty ka shenja të qarta: Vendi i Ibrahimit (Mekamu Ibrahim). Dhe, kush hyn në të, është i sigurt. Për hir të Allahut, vizita e Shtëpisë është detyrë për atë që ka mundësi”.

Ne, një grupi prej 50 vetash nga Shqipëria, mundësinë për të shkuar në haxh na e dha Mbreti i Arabisë Saudite, Shkëlqesia e Tij, Abdullah bin Abdul Aziz al Saud. E kemi falënderuar dhe uruar nga zemra për të gjitha shpenzimet tona. Na thanë se nga Ballkani ishin mbi 1300 veta të ftuar si ne nga Mbreti për në haxh. Por jo vetëm nga Ballkani. Edhe nga Franca, edhe nga Rusia, Ukraina, Kazakistani, Indonezia, Afrika etj. Nga e tërë bota. Mbreti fton. Mbreti jep. Mbreti shpenzon miliarda rialë për të tjerë (rial – njësia monedhore bazë e Arabisë Saudite). Për hir të Zotit. Dhe, Mbretit i shtohet pasuria.

Haxhi bëhet në ditë të caktuara të muajit Dhul-Hixhxe. Sipas kalendarit islam, ai është muaji i fundit i vitit. Viti është hënor. Ai ka 354 ditë e 12 muaj. Çdo muaj ka 29 ose 30 ditë. Sipas kalendarit tonë, këtë vit haxhi qe nga mesi i nëntorit.



Pjesa më e madhe e të ftuarve në haxh ishin të rinj e të reja. Por jo vetëm e të ftuarve; e të gjithë haxhinjve dhe e të gjitha haxheshave. Besoj, kështu është mirë. Haxhi do fuqi, vullnet, këmbëngulje. Vetë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Shpejtoni për ta bërë haxhin!” Sepse njëhte vlerën e kohës. Vetë Zoti betohet në Kur’an në kohën, në krijesën e vet: “Pafsha kohën!...” Është një betim solemn që flet për vlerën dhe vlerësimin e kohës. Por koha është me rininë e te rinia. E jo vetëm për haxhin. Duket, edhe Shekspiri ka nxjerrë mësim për kohën e ka shkruar sonete (tingëllima) për tiraninë e kohës. Se koha ikën e të lë. Koha nuk të pret.

Ritet kryesore të haxhit bëhen në Qabe. Sipas Islamit, Qaben e kanë ndërtuar e rindërtuar Ademi (Paqja qoftë mbi të!), Shiti (Paqja qoftë mbi të!), el amalikët (fis i vjetër arab), xhurhumët (fis i vjetër arab), Kusej ibn Kilab (katragjyshi i Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kurejshët (fis arab), Abdullah ibn Zubejri, Haxhaxh ibn Jusuf. Më pas, sigurisht është meremetuar e përmirësuar. Brenda Qabes janë tri shtylla druri, rreth 30 cm. të gjera. Ato janë që nga koha e Abdullah ibn Zubejrit, shekulli VII.

Qabja është në mes të Xhamisë së Shenjtë (Mesxhidi Haram). Është një ndërtesë katrore, me një lartësi prej afro 15 metra. Është një kompleks me nëntë elemente, të lidhur ngushtë njëri me tjetrin. Ja disa nga ato:

Porta e Qabes (Babul Ka’be). Është ngritur nga dysHEMEJA afër dy metra. Porta e tanishme është dhuratë e mbretit Khalid ibn Abdul Aziz al Saud, e punuar me ar të pastër, 99.99%. Sasia e arit është afërsisht 280 kg. Ajo ka kushtuar 13 milionë e 420 mijë rialë.

Guri i Zi (Haxherul Esued). Është simboli i përqendrimit të dashurisë për Allahun. Është një gur në qoshen jugore të Qabes, në trajtë vezake, i gjerë rreth 30 cm, i rëndë, i zi në të kuq (thuhet që pjesa e tij e padukshme është e bardhë), i rrethuar me një kornizë argjendi. Thuhet se i pari që e ka rrethuar me argjend ka qenë Abdullah ibn Zubejri.



Origjina e tij është prej gurëve të çmuar të Xhenetit. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Në Tokë, nga Xheneti janë vetëm Guri i Zi dhe Guri i Ibrahimit”.

Guri i Ibrahimit (Mekamu Ibrahim). Është guri ku vinte këmbët Profeti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) kur ndërtonte Qaben. Në të shquhen gjurmët e këmbëve të Ibrahimit: 10 cm të thella, 27 cm të gjata e 14 cm të gjera. Largësia ndërmjet dy gjurmëve është 1 cm. Është i larë në argjend. Ëshë vendosur mbi një pedestal të mermertë, 75 cm i lartë.

Qoshja e Jemenit (Er Ruknul Jemani). Është njëra prej qosheve të Qabes. Quhet kështu sepse është në drejtim të Jemenit. Përshëndetet duke ngritur dorën.

Brezi rrethues (Esh Shedhruuan). Është një brez i pjerrët, ngjitur mureve të Qabes, nga tri anë. Nga ana tjetër, përballë Hixhrul Ismail (zbrazëtira në veri të Qabes) është një shkallë e vogël, e drejtë, ku qëndrohet për të bërë lutje. Brezi rrethues është 13 cm. i lartë dhe 45 cm i gjerë. Thuhet se është ndërtuar për ta mbrojtur Qaben nga depërtimi i ujërave.

Vendqëndrimi për Lutje (El Multezim). Është vendi midis Gurit të Zi dhe Portës së Qabes. Është quajtur kështu sepse aty qëndrojnë njerëzit e luten.

Rreth Qabes, në një sipërfaqe me pllaka të mermerta për mijëra e mijëra veta bëhet një ndër veprimet e Haxhit, tauafi (shtatë ecje rreth e qark saj). Ai fillon dhe mbaron te Guri i Zi. Ballë për ballë me Gurin e Zi janë kodrat Safa e Merue, njëherësh, edhe pjesë e Xhamisë së Shenjtë.

Ritet kryesore të Haxhit kryhen gjatë 12-13 ditëve të para të muajit Dhul-Hixhxe. Haxhiu vesh ihramin – rrobën e bardhë prej dy copash të paqepura, pa hyrë ende në Mekë. Grupi ynë e veshi në Stamboll. Gratë e vajzat mbajnë rrobat e tyre të zakonshme, sigurisht pa shkëlqim e pa ngjyra të ndezura. Simbolika e ihramit është: besimtari mendon tashmë vetëm për Jetën Tjetër. Gjatë gjithë ditëve të Haxhit haxhiu nuk vesh asnjë petk tjetër, nuk shkurton flokët, nuk rruhet, nuk pret thonjtë, nuk vë asnjë erzinë në trup etj.



Simbolika e mbarimit të Haxhit është rruajtja e kokës ose qethja a shkurtimi i flokëve për burrat dhe prerja paksa e flokëve për gratë, heqja e ihramit dhe veshja e rrobave të zakonshme. Është kthimi në jetën e kësaj bote, por një kthim me rilindje, me zemër e me moral shumë të pastër. Lufta me vetveten, xhihadi me veten, përsosja e moralit janë ndër synimet kryesore.

Pasi bëme dush, veshëm ihramin e morën abdes, shkuam në Qabe e bëme tauafin. Kuptimi i tij është i madh: qenia përpara Zotit, ecja përpara Zotit, afrimi te Zoti. Falëm namaz te Mekamu Ibrahim. Bëmë sajin – shtatë vajtje-ardhjet nga kodra Safa te kodra Merue. Veprime të tjera bëme në ditët e mëpasme në Mina, në Muzdelife e si ato të parat, përsëri në Qabe. Të gjitha e gjithçka për Zotin, për hir të Zotit.

Haxhi është i tëri lëvizje: tauafi i përshëndetjes, i haxhit, i lamtumirës, dy saje, hedhja e gurëve kundër Shejtanit, faljet e përditshme dhe fakultative, vizitimi i vendeve të shenjta etj. Por një lëvizje me një unitet të brendshëm tematik, me një strukturë të përcaktuar tematike, me një potencial të fuqishëm për të kuptuar Mesazhin e Kur'anit, konceptet e tij, botëkuptimin e tij - sigurisht, për zemra që ushqehen nga ai.

Haxhinjtë vijnë nga haxhi, vërtet të rilindur, siç thotë një hadith i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kanë tjetër zemër dhe mendojnë e veprojnë me këtë zemër të mirë. Nuk besoj të habitet lexuesi kur them “mendojnë me këtë zemër të mirë” sepse thotë Kur’ani, “zemra me të cilën mendojnë”. Ka disa ajete kur’anore për këtë. Ky është njëri prej tyre: “Pastaj ata do të pendohen për mendimet që fshihnin në zemrat e tyre” (5:52). Dhe mjekët amerikanë kanë zbuluar atë që thotë Kur’ani: njeriu mendon me zemër. Lexuesi mund të shohë për këtë një shkrim të Abd el-Daim el Kehilit në “Drita e Kur’anit”, 2008, 3, f.65-76 (botim i Fondacionit të Kur’anit, Tiranë).

Pse, a nuk rrotullohet zemra kur viziton, p.sh. Arafatin? Arafati është kulmi i Haxhit. Në ditën e nëntë të muajit Dhul-Hixhxe. “Pa Arafat, nuk ka haxh”, – ka thënë Profeti Muhamed



(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në Arafat Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka mbajtur Hytben e njohur të Lamtumirës përpara 140 000 haxhinjve. Ajo është shumë më shumë se hytbe, këshilla, porosi, dashuri për njerëzit. Për njerëzit. Për të gjithë njerëzit. Sepse çdo thënie nis me “o njerëz!”. Ajo është shumë më shumë se një kod i përkryer i sjelljes njerëzore. Ajo është kushtetuta e njerëzimit. Për një jetë dhe jetesë dinjitare. Hytbja është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Në Arafat, Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka qëndruar gjatë Haxhit të Lamtumirës në vitin 633 të erës sonë. Aty ka falur drekën dhe pasdreken. Tani, aty është Xhamia e Nemiresë, me dy kate dhe me gjashtë minare. Gjysma e Xhamisë është në Arafat dhe gjysma tjetër, jashtë Arafatit. Në Arafat ka zbritur Ademi. Në Arafat janë ribashkuar Ademi dhe Havaja.

Pse, a nuk lëviz zemra te kodrat Safa dhe Merue? Siç thuhet në suren “Al Bekare” (ajeti 158), ato janë ndër Shenjat e Allahut. Dihet historia e ecjes së shpejtë e të shqetësuar të Haxheres, së ëmës së foshnjës Ismail për të gjetur ujë për të birin. Largësia nga Safa te Merue është 395 m. Sigurisht, tani, rruga nga njëra kodër tek tjetra është e tëra me pllaka mermeri, por diku, në anë, një fragment i kodrës së zhuritur është i mbuluar me një kupolë qelqi. Për vizitorët. Haxhinjtë e përshkojnë këtë rrugë shtatë herë; në njëfarë vendi, me një ecje të shpejtë. Përkujtohet kështu shqetësimi, por edhe durimi dhe ngulmimi i Haxheres. Simbolikisht, dy kodrat janë dy nga Monumentet që tregojnë për një nga virtytet më të larta të myslimanëve – durimin dhe këmbënguljen.

Pse, a nuk e dëgjon zemrën kur shkon në Mina e në Muzdelife e kur ther kurban?

Në **Mina**, ku është xhamia “El Hif”, ka qëndruar Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjatë Haxhit të Lamtumirës. Në Mina janë tri shtyllat e hedhjes së gurëve (një herë hidhen 7 gurë dhe një herë tjetër, 21 gurë). Simbolika e hedhjes së gurëve ka të bëjë me historinë e Ibrahimit.



Përmbajtja e saj është shumë e madhe: flakja tej e së keqes në mendje, në zemër, në fjalë, në punë, në vepra, në veprime. E keqja është Shejtani.

Në **Muzdelife**, një vend midis Arafatit dhe Minasë, Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë një falje (namaz) të gjatë. Për këtë arsye, haxhinjtë e vizitojnë këtë vend jo vetëm si një tjetër Monument të Shenjtë, por edhe si shembull adhurimi kur të kthehen në vendet e tyre.

Kurbani. Urdhri i drejtpërdrejtë për therjen e kurbanit i erdhi Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me zbritjen e sures “El Keuther”: “Falu dhe bëj kurban për hir të Zotit tënd!”. Allahu e bëri detyrë kurbanin për të rikujtuar ngjarjen e Ibrahimit me të birin – Ismailin. Me dorën e tij, Ibrahim do të flijonte më të dashurin e tij, djalin – Ismailin. Dhe Ismaili i ishte bindur me gjithë zemër urdhrorit të Allahut. Por Ismaili nuk u flijua sepse Allahu dërgoi një kurban të madh. Ky qe shpërblimi për bindjen e Ibrahimit dhe të Ismailit. Ky qe shpërblimi për njerëzimin: njeriu nuk mund të flijohej. Kur’ani e rimerr këtë histori dhe urdhëroi të pritej kurban për hir të Zotit. Dhe kurban ishte kafsha e jo njeriu. Sepse Islami ishte kundër skllavërisë. Islami dha shembullin konkret të luftës kundër skllavërisë. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e bëri skllavin zezak, Bilalin, myezinin e tij.

Në Mina ka thertore ku çdo haxhi pret kurbanin e vet. Vetë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka therur kurban me duart e veta.

I nderuar lexues! Ajo që përcillet në ekranet e televizorëve është, thjesht një shëmbëllesë e asaj që ndodh në Qabe në ditët e haxhit. Madhështia e haxhit shihet vetëm atje – në Qabe, në Xhaminë e Qabes, në portat e Qabes, në shkallët e Qabes, në katet e Xhamisë së Qabes, në Arafat, në Mekë, në Medine, në rrugë – gjithkund. Imagjinoni për një çast një det njerëzish, që lëvizin si valë rrethore në tauaf. Janë valë të qeta njerëzish, që vijnë gjithnjë duke u hapur e duke u zgjeruar mu si rrathët që bëhen kur lëshon një gur në një liqen të qetë.



Imagjinoni dy lumenj të mëdhenj të pandalshëm njerëzish që shkojnë e vijnë te kodrat Safa e Merue. Imagjinoni duart e miliona njerëzve që ngrihen kur luten a kur përshëndesin. Imagjinoni miliona lutje e dua. Miliona e miliona thënie me “Allahu Ekber” (Allahu është më i Madhi). Miliona e miliona thirrje që vijnë si dallgët e detit nga gjokset e njerëzve me “Lebejke Allahume lebejke...” (Të përgjigjem o Allah, të përgjigjem...). Imagjinoni milionat e njerëzve që falën njëherësh xhumanë e haxhit. Imagjinoni zërin e ëmbël e gjëmimtar të imamit të Qabes dhe të myezinëve të saj. Imagjinoni tendat e mëdha të Arafatit. Shkallët elektrike të Qabes e autobusët, mbushur e mbushur. Është një botë që lëviz. Është bota që lëviz.

Në haxh tingëllon më fuqishëm se kurrë “Allahu Ekber” (Allahu është më i Madhi). Ai është një buçimë. Një gjëimim. Kur ngjitesh në Safa, mund të shohësh Qaben. Njerëzit e përshëndesin dhe luten me zë të lartë duke thënë tri herë me zë të lartë “Allahu Ekber”. Edhe përballë Gurit të Zi haxhiu përshëndet me “Allahu Ekber”. Edhe kur gjuhen shejtanët me gurë. Gjithandej buçet thënia “Allahu Ekber”. Edhe në çdo falje përsëritet “Allahu Ekber”. Edhe në ezan (thirrja për falje) thuhet “Allahu Ekber”. Është sinteza e monoteizmit islam: Ka vetëm një Zot.

Haxhi është tubimi më i madh i njerëzve në këtë botë. Ne tubohemi përpara Allahut pesë herë në ditë. Ne tubohemi përpara Allahut çdo të xhuma. Ne tubohemi përpara Allahut në të dy Bajramet. Ne tubohemi përpara Allahut në haxh. Është tubim shumë më i madh se të tjerët. Është tubim që i ngjan Tubimit të Madh, tubimit të fundit përpara Allahut në fushën e Mahsherit (Kur'an: 19:85, 86).

Në haxh janë të gjithë të barabartë. Një vlerë që shihet me sy. Në veshje. Në veprime. Në sjellje. Nuk ka të pasur e të varfër. Nuk ka as rangje detyrash e pushtetesh. Sepse në Islam e në haxh më i miri te Zoti është ai që është më i devotshëm. Sepse më i miri te Zoti është ai që ka moralin më të lartë. Në parantezë: morali është pjesë e fesë; ai shkon paralel me besimin.



Haxhi është tubimi i miliona besimtarëve. Nga të gjitha vendet e botës. Miliona besimtarë në falje. Miliona besimtarë në Qabe, në tauaf, te kodrat e Safa e Merue, te çezmat e Zemzemit. Miliona besimtarë hanë e jetojnë në një hapësirë që quhet Mekë. Miliona besimtarë bëjnë adhurimet e tyre në një hapësirë që quhet Qabe. Ditë e natë. Faljet e detyrueshme, në kohë të caktuar. Në të njëjtën kohë. Pa tejkaluar sekondën. Mendja nuk ta rrok; por, kur e sheh vetë, bindesh. Vërtet, një organizim i përkryer. Në çdo portë, hyrje, shkallë elektrike, kalim, mbikalim, rruginë, kënd etj. ka djem me uniformë që udhëzojnë. Por një me një me organizimin e përsosur është vetorganizimi i përsosur. I haxhinjve. Dhe i haxheshave. Në parantezë: në haxh, në Qabe nuk ka ndarje midis meshkujve e femrave. Çdo adhurim kryhet bashkërisht. Janë vëllezër e motra. Ani se janë nga vende të ndryshme të botës. Sepse çdo haxhi e çdo haxheshë mendon më së pari për të mirën e qetësinë e të tjerëve. Vërtet, një virtyt i lartë. Sepse aty matej hapi. Sepse aty shpejtohej hapi. Një rregullsi që çlodhte trupin dhe mendjen. Sepse vlera e të gjitha veprimeve ishte prekja e zemrës, prekja e shpirtit. Sepse haxhiu e haxheshja e fillojnë haxhin me “Lebejke Allahume lebejke ... (Të përgjigjem o Allah, të përgjigjem ...), që do të thotë se janë gjithnjë përpara syve të Allahut. Madje, një përkthim i afërt i kësaj motoje është: “Jam këtu, ja ku jam o Zot, jam këtu përpara Teje”.

Haxhi është një tubim që përfaqëson bashkimin e më se 1 miliardë e 600 milionë myslimanëve në mbarë botën dhe e qindra mijërave që konvertohen në Islam çdo vit nga fe të tjera. Edhe në grupin tonë kishim disa djem të kthyer në Islam - Levin, Perikliun etj. – shumë të devotshëm në të gjitha ritet e veprimet. Se Islami të rrëmben zemrën.

Në haxh ka rregull e rregullsi. I njëjti rregull kudo. Edhe në vise të tjera jashtë Qabes, ku kryhen rite të tjera të haxhit. Imagjinoni Arafatin. Le ta quajmë “qendër banimi”, por qendër banimi për rreth një ditë sepse sipas rregullave të Haxhit, pa perënduar dielli të gjithë haxhinjtë e të gjitha haxheshat duhej të largoheshin që andej.



Dhe, një qendër banimi rreth njëditëshe në mes të shkretëtirës, me gjithçka për një jetesë shumë normale: tenda të stërmëdha, kondicionerë, dyshekë e çarçafë, çezma për t'u larë e për të marrë abdes, dushe me ujë të ngrohtë, një mori gjellësh e gatesash, mensa e xhami, pije freskuese e fruta gjithfarësh. Imagjinoni Minanë. Me një shërbim të përkryer njëzetekatërorësh, që do ta kishte zili një hotel me pesë yje. Me një shërbim të përkryer mjekësor. Aty gjellët e ëmbëlsirat, frutat e pijet e ftohta freskuese nuk baronin kurrë. As çaji dhe kafja.

Çfarë sheh në haxh? Shumë e shumë. Në Kur'an, fill pas urdhrit për të besuar në një Zot, është urdhri "Dhe të doni prindërit". Në haxh e sheh më shumë se kudo këtë dashuri. Prindërit e moshuar shtyhen me karrocë në tauaf. Më shumë se kaq kam parë djalin që bënte tauaf me të ëmën në krahë. Dashuri e mund fëmije për nënën. Dashuri zemre për nënën. Në haxh sheh shumë, por edhe dëgjon e mëson shumë. Hytbet e vazet në xhami (xhami ka edhe në hotele e në tenda), por edhe bisedat e shpjegimet për çështje të fesë në kohën e lirë e në mjedise të lira plotësonin shumë dijet tona për Kur'anin, për fenë, për historinë e Islamit. Mu për këto e për shumë të tjera si këto, nga haxhi vetëm merr. Nga haxhi vjen me mbresa shumë të mëdha. Nga haxhi vjen me zemër tjetër.

Pastërtia në Qabe, në Xhaminë e Profetit e kudo është një shembull tjetër i madh. Pastrimi bëhej me disiplinë të rreptë. Nga djem të fuqishëm; të pastër vetë si drita. Radha e punës: zgjatej një shirit i kuq në pjesën që do të pastrohej, që do të thoshte që duhej larguar për një çast që andej. Me sekonda vinte makina që e lagte. Me sekonda, makina që e fshinte. Me sekonda tharja.

Po qyteti? Po qytetet? Sa dashamirës e sa miqësorë e mikpritës! Vetëm një fakt mjafton. Rroba e bardhë i dallonte haxhinjtë në qytet. Dhe si të tillë, për ta mjaftonte fjala haxhi. Për ndihmë. Për të të treguar rrugën a hotelin, për të të qerasur, por edhe për të çuar me makinë në hotel a diku tjetër nëse ishte ngatërruar a kishte humbur grupin.



Ndërtimet moderne me arkitekturë arabe ose me elemente arkitekture arabe në Xheddë, Mekë, Medine etj., tendat vigane në Xheddë e Medine, si krahët e fluturave, që janë pjesë çatie e që hapen e mbyllen automatikisht, rrugëkalimi i mbuluar Mina-Mekë mes dy malesh (nuk arrita të pyesja nëse ka qenë luginë apo është çarë mali) – në të vërtetë, një shëtitore çlodhëse në ditët me diell, me bimë zbukurimore, me çizma, me vendqëndrime autobusësh, me pastërtinë shembullore, me ndërtesa shumëkatëshe, kolonat e mermerta e dyshemetë e mermerta në Xhaminë e Qabes dhe në Xhaminë e Profetit në Medine, ushqimet e freskëta në çdo restorant, hoteli “Meridiem”, 22-katësh, me pesë yje, ku rrinim ne shqiptarët e rreth 1300 të tjerë nga Ballkani, janë një tjetër kënaqësi e veçantë e ditëve të haxhit.

Dhe, dhuratat e Mbretit për haxhinjtë e haxheshat. Ato ndiqnin njëra-tjetrën: ihrami (tri palë në pesë ditë, sepse nuk mund të lejohej të mbante vrug petku i bardhë), çanta e shpinës, çadra e kapela për diell, sendet e tualetit, pa harruar as furçën e dhëmbëve dhe as misuakun, krehrin, prerësen e thonjve e erzinat. Një dhuratë surprizë qenë kartat telefonike për çdokënd. Sipas rregullave të haxhit, haxhiu duhet të therë kurban dhe ta japë për të tjerët. Edhe kurban i për të ftuarit e mbretit qe dhuratë. Dhe dhuratat vinin fare natyrshëm; thjesht, me thënie: Dhuratë nga Mbreti. Ashtu siç të presin fare natyrshëm e krejt si mik në ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, kur merr vizën për të vizituar Qaben, Mekën, Medinen, Arabinë Saudite. Por, nëse do të më pyesnit ç’gjë tjetër do të doja, do të kisha thënë diçka. Një ditë ra shi i madh e vendi u fladit vetëm paksa. Shiun e rrëmbeu toka. Sepse i tillë është dheu i atjeshëm. Një grill si i zi. Shumë do të kisha dashur që Meka të kishte dheun e fshatit tim, gjelbërimin e ujërat e fshatit tim, gjelbërimin e ujërat e Shqipërisë. Edhe Medina. Edhe Arafati. Edhe Minaja. Edhe Muzdelifja. Edhe Xhedda. Edhe Al Rub’al Khali. Edhe Nafudi. Edhe Nexhdi. Edhe gurishtet më të skajshme.



Në Mekë ka shumë vende fetare e historike për t'u vizituar. Më së pari, **Qabja** që u përshkrua në fillim.

Xhamia e Shenjtë. Ka një sipërfaqe prej 309.000 m²; 208.000 m² ndërtesa, 61.000 m² për falje, 40.000 m² sheshe jashtë xhamisë. Ka 9 minare 89 m të larta, 11 shkallë të zakonshme e 5 shkallë elektrike. Ka 79 porta e 500 kolona të mermerta. Është me ajër të kondicionuar. Nxë njëherësh 695.000 faltarë në katin përdhes. Është me tri kate. Vetëm në zonën e Tauafit, në katin përdhes të Xhamisë së Shenjtë dhe në hyrjet e saj ka 733 çezma. Për haxhinjtë dhe për të tjerë. Ka sistem spërkatjeje për të larë zonën e Tauafit. Vetëm për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Xhamisë së Shenjtë shpenzohen çdo vit rreth 25 milionë rialë. Xhamia rrethohet nga një kurorë pallatesh, hotelesh e ndërtimesh të tjera, të bukura si vetë ajo.

Shtëpia ku ka lindur Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ka qenë një shtëpi në anën e hyrjes së tuneleve të sotme "Exhjad el Gaze". Në vitin 1370 (hixhri) është rindërtuar dhe është kthyer në bibliotekë. Sot ajo është Biblioteka e Mekës.

Në **Xhebelu en Nur** (Mali i Dritës) është shpella Hira. Shpella është në majë të malit. Mali është 200 m i lartë e shumë i vështirë për t'u ngjitur. Në Kur'an, në suren "Et Teube" përmendet Xhebelu Theur (mali i Theurit). Aty, në shpellë janë strehuar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe shoku i tij i ngushtë, Ebu Bekri para se të emigronin në Medine për t'u shpëtuar përndjekjeve të politeistëve mekas.

Burimi i Zemzemit (Bi'ru Zemzem). Është uji më i nderuar në sipërfaqen e Tokës. Është afër Gurit të Ibrahimit, para Qabes, nga krahu i Gurit të Zi. Gryka e burimit është poshtë sipërfaqes së tauafit, rreth 1.56 metra. Ka edhe një fabrikë ku mbushen e mbyllen shishe plastike për ta transportuar ujin e bekuar. Historia e Zemzemit lidhet me Ibrahimin dhe të birin, Ismailin: Në shkretëtirë, një grua me një foshnjë – e shoqja e Ibrahimit, Haxherja, me të birin – Ismailin. Foshnjën e mori etja. E ëma, shumë e shqetësuar. Djali qante për ujë. Po, ku ta gjente ujin në shkretëtirë e gjora grua!



Filloi të vraponte sa te kodra Safa, sa te kodra Merue. Për ujë, për çfarë tjetër! Foshnja qante e përpushte rërën me këmbë. Dhe, në këto përpushje bufloi uji! Haxherja u gëzua fort, por kishte frikë se mos i ikte uji, prandaj tha disa herë “Zumij, zumij! (Mblidhu, Mblidhu!). Dhe që nga ajo kohë, ky byrim quhet Zemzem (nga “zumij, zumij”). Zemzemi ka edhe historinë e tij të mirëmbajtjes dhe të pastrimit. Sot, Zemzeni funksionon me sistem elektronik kompjuterik.

Zemzemi është ujë i begatë. Është i vetmi ujë në botë ku nuk zhvillohen baktere, ku nuk ka rritje biologjike (alga etj.). Zemzemi ka fluoride (mikrobevrasëse). Zemzemi nuk është klorinuar kurrë.

Meka përmendet në Kur'an disa herë, madje Zoti betohet në emrin e saj, duke i dhënë kështu një status unik, të pashoq në të gjithë botën. Qabja e Shenjtë, që është në Mekë ka ndikuar aq shumë edhe në rritjen dhe zhvillimin e qytetit. Në Mekë, në rrethinat e saj, ka zbritur e para sure e Kur'anit: “*Shpall / Me emrin e Allahut / ... Që krijoi ...*” (Kur'an, 96:1-3).

Qyteti i dytë i shenjtë i Islamit është **Medinia** – rreth 447 km në veri të Mekës, 250 km në lindje të Detit të Kuq. I rrethuar me male, por me më shumë se 60 parqe pushimi e çlodhjeje. Ishte Medina që priti Profetin Muhamed (Pajja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe shokët e tij në vitin 622 të erës sonë, që emigruan nga Meka për t'u shpëtuar agresivitetit dhe përndjekjeve të politeistëve mekas. Nga ky vit fillon edhe kalendari mysliman e që shënohet me shkurtimin *H* (= *Hixhra* emigrimi). Ishte Medina ku nisi epoka islame. Ajo qe qendra e shtetit të parë islam në historinë e njerëzimit. Ajo është qyteti ku prehet Profeti (Pajja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në Medine prehen edhe shokët e Profetit: Ebu Bekri, Umeri, Othmani, Hamzai etj. (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Në Medine është Xhamia e Shenjtë e Profetit: me ajër të kondicionuar; me sipërfaqe 400.500 m²; 67.000 m² për falje; 235.000 m² sheshe jashtë xhamisë; nxë njëherësh 650.000 faltarë; ka 10 minare, 104 m të larta, 6.800 lajtore, 18 shkallë të zakonshme



dhe 4 shkallë vetëlëvizëse. Medina është aeroporti që përcjell haxhinjtë e haxheshat. Përcjell, për të pritur vitin tjetër.

Le të kthehemi përsëri te Qabja. Qabja iu dha Ibrahimit dhe djalit të tij, Ismailit, si një vend adhurimi, që do të ishte pa idhuj, vetëm për Allahun, Zotin që është Një, si një vend adhurimi universal për të gjithë, jo i rezervuar për një popull (si Tempulli i Sulejmanit). Dhe sot, Qabja është e tillë. Shtëpia e Allahut, Qabja, është, siç u përmend, kiblja e myslimanëve të të gjithë botës: sa herë që falen, kudo ku të jenë, kthehen në drejtim të saj, domethënë, me fytyrë nga juglindja. Të tillë i bëri Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Thonë se edhe fizikisht është qendra e botës.

Dhe më në fund, nga moria e vlerësimeve shumë të larta që kanë bërë e bëjnë të tjerët (dhe janë nga jomyslimanët) për atë që e bëri Qaben të tillë, për Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), do të japim vetëm një: “Nëse madhështia e qëllimit, mjetet e pakta dhe rezultatet mahnitëse janë tri kriteret e gjenisë njerëzore, - shkruan Lamartini (*Historie de la Turquie*, Paris, 1854, vëll. II, f. 276-277), - atëherë kush do të guxonte ta krahasonte ndonjë njeri të madh të historisë së sotme me Muhamedin? Njerëzit më të dëgjuar krijuan vetëm armë, ligje dhe perandori. Ata krijuan, nëse krijuan diçka, jo më shumë se fuqi materiale, të cilat shpesh u bënë pluhur e hi përpara syve të tyre. Ky njeri lëvizi jo vetëm armata, legjislacione, perandori, popuj dhe dinasti, por edhe miliona njerëz në një të tretën e popullsisë së atëhershme të botës dhe më shumë se kaq, Ai lëvizi altarët, perënditë, idetë, besimet dhe shpirttrat ... Filozof, orator, apostull, ligjvënës, luftëtar, ngadhënjimtar i ideve, ai që rigjallëroi besime racionale ..., themelues i njëzet perandorive tokësore dhe i një perandorie shpirtërore – ky është MUHAMEDI. Tani, po të kemi parasysh standardet, me të cilat mund të matet madhështia njerëzore, mundet fare mirë të pyesim: A ka ndonjë njeri më të madh se Ai?”.



Veprimtari fetare – kulturore të Fondacionit të Kur'anit në Tiranë gjatë muajit të Ramazanit, 2011

Emisioni radiofonik “*Flladi i Mëshirës*”

Me rastin e muajit të begatë të Ramazanit, Fondacioni i Kur'anit në Tiranë organizoi një varg veprimtarish fetare – kulturore. Ndër to ishte edhe emisioni radiofonik “Flladi i Mëshirës”, çdo ditë, në transmetim të drejtpërdrejtë 120 minuta në frekuencën 93.6 MHz, në valët e radio “Nacional”. Hapja e emisionit është bërë me minirubrikën “Është Ramazan”. Ai është pasuar me rubrikat: Edhe sot jam agjërueshëm; Lexim Kur'ani në arabisht dhe përkthimi i ajeteve në gjuhën shqipe; Kujtesë për agjëruesin dhe dëgjuesin; Leximi i një gjysmë xhuzi të Kur'anit; Krijesa të Mrekullueshme; Mësime morale – edukative në muajin e Ramazanit; Ilahi etj. Përveç këtyre rubrikave, është përcjellë çdo ditë edhe rubrika “Tregime”; “Thënie të urta”; “Zëri juaj në studio” etj. Një rubrikë interesante ka qenë “Le të shtojmë Diturinë”. Në këtë rubrikë, çdo ditë është shtruar një pyetje nga paraqitëset e emisionit dhe dëgjuesit i janë përgjigjur nëpërmjet adresave të kontaktit të vëna në dispozicion.

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2011



Ceremoni kur'anore nga Fondacioni i Kur'anit

Më 05.09.2011, Fondacioni i Kur'anit organizoi ceremoninë kur'anore për ndarjen e çertifikatave mësuesve që morën pjesë në kursin e trajnimit gjatë dy javëve të fundit të muajit të Ramazanit. Në këtë ceremoni ishin të ftuar kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim MUÇA, H. Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve), përfaqësues të institucioneve fetare në Shqipëri etj. Drejtori i Fondacionit të Kur'anit, zoti Muhamed Reza HAJ KHEZR, i falënderoi të ftuarit për pranimin e ftesës dhe bëri një paraqitje të hollësishme të veprimtarive të Fondacionit gjatë muajit të begatë të Ramazanit. Ai u përqendrua më shumë te kursi i trajnimit të mësuesve të Kur'anit. Në fjalën e tij, ai tha ndër të tjera: “Në muajin e begatë të Ramazanit kryem një kurs trajnimi për shtimin e njohurive rreth Kur'anit Famëlartë. Është hera e parë që Fondacioni i Kur'anit merr një nismë të tillë dhe shpresoj të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në këtë kurs morën pjesë mësues të Kur'anit nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Si lëndë kishim tefsirin e Kur'anit (komentimin). Në këtë kurs është zhvilluar metoda e mësimdhënies së Kur'anit dhe rregullat e leximit të tij (texhuidi). Përveç programeve mësimore, kemi pasur edhe programe edukative: është lexuar çdo ditë nga një xhuz Kur'ani. Është falur namazi me xhemat dhe namazi i teravive. Pjesëmarrësit në këtë kurs, pasi kanë dhënë provimin, tashmë do të marrin edhe një çertifikatë. Takimin e përshëndeti edhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim MUÇA. Ai e falënderoi Fondacionin e Kur'anit për punën që po bën për përhapjen e mësimin të Kur'anit dhe për bashkëpunimin me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Ai tha ndër të tjera: “Kam kënaqësinë e madhe të marr pjesë në një aktivitet të tillë ku bëhet fjalë për trajnimin e mësuesëve të Kur'anit. Fondacioni i Kur'anit po luan një rol të rëndësishëm për përgatitjen e mësuesve të Kur'anit dhe për përhapjen e kulturës fetare islame. Leximi i Kur'anit drejt dhe pa gabime ka rëndësi të madhe.



“Lexojeni Kur'anin kuptueshëm”,- kështu urdhërohem nga Allahu. Uroj që edhe në të ardhmen të punojë po në këtë mënyrë e me po këtë vullnet që shqiptarët ta mësojnë leximin e Kur'anit.” Drejtori i Fondacioneve të Kur'anit në botë, në UNIVERSITETIN “AL MUSTAFA” me qendër në KOM – IRAN, H. Hossein ASADI, pasi i përshëndeti të pranishmit në sallë dhe e falënderoi drejtorin e Fondacionit të Kur'anit për ftesën, e vuri theksin te mënyra e komentimit të Kur'anit. Ai tha: “Kam dëgjuar shumë njerëz që thonë se komentimi i Kur'anit për një temë që mund të zgjedhim, nuk bëhet në më pak se një orë. Unë do të doja t'ju thosha se një gjë e tillë është e mundur edhe për pesë minuta. All'llahu i Madhëruar e ka krijuar botën me një sistem të rregullt, me një qëllim. Të gjithë ne në këtë botë duhet të kemi një qëllim dhe një sistem të rregullt. Në ajetin 51 të sures “Mu'minun”, All'llahu i Madhëruar thotë: “Hani dhe bëni vepra të mira”. Në suren “Haxh”, ajeti 28, All'llahu i Madhëruar thotë: “Hani dhe ushqeni të tjerët”. Në suren “Bekare”, në ajetin 172, All'llahu i Madhëruar thotë: “Hani dhe falënderoni All'llahun”. Në suren “Araf”, ajeti 31, All'llahu i Madhëruar thotë: **“Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.”** Pra, këtu dalim në përfundimin që All'llahu i Madhëruar na ka krijuar që të arrijmë në një qëllim dhe jo vetëm për të ngrënë. Në një sure tjetër All'llahu i Madhëruar flet për bletën. Bletën e urdhëron të hajë dhe njëherësh, të japë prodhim të shijshëm për njerëzit, të veprojë sipas urdhrit të All'llahut. Pra, edhe bleta ha dhe na jep mjaltin që është shërues i shumë sëmundjeve për njerëzit. Shpresojmë që edhe ne, me veprat tona të veprojmë ashtu siç duhet dhe të lëmë diçka të mirë në gjithçka.” Duke përfunduar, zoti ASADI përshëndeti të gjithë mësuesit e Kur'anit që morën pjesë në kursin e trajnimit, të gjithë dëgjuesit e programit të radios, pjesëmarrës në konkursin që është zhvilluar gjatë këtij muaji dhe të gjithë ata që bënë të mundur realizimin e këtij programi. Ai falënderoi drejtorin e Fondacionit të Kur'anit që mundësoi këto lloj programesh gjatë këtij Muaji të begatë të Ramazanit.



Ky takim u përshëndet edhe nga H.Edmond BRAHIMAJ, kryegjyshi botëror i bektashinjve. Ai falënderoi Fondacionin e Kur'anit që dha mundësinë për të përgatitur njerëzit me dritën e Zotit, dritën e Kur'anit, i cili është shkencë, art, kulturë për gjithçka. Në fjalën e tij, Xhemal BALLA theksoi vlerësimin që i bën Kur'ani njeriut. Njeriu është objekt dhe subjekt i krijimit të Zotit të Madhëruar dhe për këtë Zoti ka dërguar ligje dhe dispozita për ta mbrojtur njeriun, krijesën më të nderuar nga të gjitha krijesat. Në takim përshëndetën edhe zoti Vullnet MERJA, zoti Kelmend VRAPI, zonja Vera TROPLINI dhe zoti Naim BAJRAMI.

Vjollca KARAJ (FEZA)

U ekspozua Kur'ani më i bukur në botë i punuar dhe i zbukuruar me dru

Kur'ani më i bukur në botë, i punuar dhe i zbukuruar me dru është ekspozuar për të gjithë publikun dhe dashamirësit e Kur'anit në Pallatin e Samitit të Shteteve Islamike gjatë zhvillimit të garave të njëzeteteta ndërkombëtare të Kur'anit në kryqetetin e Iranit, Tehran. Në Kur'an janë përdorur stile të ndryshme arti të gdhendjes në dru. Gjatë punimit të këtij Kur'ani janë përdorur lëndë, si druri, guri, metali dhe penj të mëndafshhtë. Të gjitha stilet artistike të përdorura të punimit të këtij Kur'ani janë marrë nga burime origjinale të artit iranien të zhvilluara gjatë etapave të ndryshme historike.

U zhvilluan garat ndërkombëtare të Kur'anit në Egjipt

Përfaqësuesit e 99 shteteve arabe dhe islame morën pjesë në garat ndërkombëtare për hifz, texhuid dhe komentim të Kur'anit. Garat filluan në ditën e 18-të e muajit të Ramazanit në Kajro dhe përfunduan në ditën e 26-të të Ramazanit. Një ceremoni përmbyllëse u zhvillua për ndarjen e çmimeve për fituesit.



U identifikuan me shumë se 1200 dorëshkrime të përkthimit të Kur'anit në gjuhën perse

Në Iran, deri tani janë identifikuar më shumë se 1200 dorëshkrime të përkthimit të Kur'anit fisnik në gjuhën perse. Sipas raportit të Institutit Kulturor “Tarjuman-e Ēahy” (Përkthyesit e Shpalljes), numri më i madh i dorëshkrimeve të përkthimit të Kur'anit fisnik i përket gjuhës perse, turke dhe urdu.

Ruajtja e dorëshkrimit të parë të Kur'anit në Jemen

Dorëshkrimi i parë i Kur'anit fisnik, 70 vjet pas vdekjes të Hazreti Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ruhet në xhaminë kryesore të Sanës, në Jemen. Dorëshkrimi është gjetur në vitin 1972 në xhaminë e parë të ndërtuar në Jemen.

“Çmimi i Dubait”, garat më të mira kur'anore në botë për vitin 2011

Organizata Botërore për hifzin e Kur'anit fisnik i ka emërtuar garat ndërkombëtare të Kur'anit fisnik si “Çmimi i Dubait” dhe i ka prezantuar ato si garat më të mira kur'anore në botë për vitin 2011. Organizata Botërore për Hifzin e Kur'anit, e cila vepron në kuadër të Organizatës Botërore të Islamit në Mekë ka njoftuar se në bazë të vendimeve të kësaj Organizate, garat ndërkombëtare të Kur'anit këtë vit do të fitojnë çmimin e garave më të mira kur'anore në botë nën kujdesin e mbretit të Arabisë Saudite, në qytetin Xhida.

Në Francë zhvillohet programi “Tridhjetë ditë, tridhjetë xhami”

Programi “Tridhjetë ditë, tridhjetë xhami” u zhvillua gjatë muajit të Ramazanit në qytete të ndryshme të Francës. Programi synonte njohjen e xhamive dhe të qendrave fetare të myslimanëve



në Francë. Realizuesit e këtij programi udhëtuan nëpër qytete të ndryshme të Francës gjatë muajit të Ramazanit për çdo ditë e vizituan xhami të ndryshme. Ata e kanë quajtur “Shëtitje nëpër xhami të ndryshme të Francës” meqë ky program zhvillohet për herë të parë në Francë.

Në Suedi zhvillohet java e parë kur'anore me rastin e muajit të Ramazanit

Bahman Mazemi, zyrtar për çështje kulturore të Iranit në Suedi, duke shpjeguar programet kulturore gjatë kësaj jave kur'anore, ka thënë se programet e javës kur'anore u zhvilluan me tema të ndryshme, siç ishte “Kur'ani dhe familja”. Gjatë kësaj jave u organizuan edhe garat kur'anore. Ato u zhvilluan në dy degë: hifz dhe lexim i Kur'anit fisnik.

Në Arabinë Saudite mbledhen kur'anët elektronikë që kanë gabime teknike

Sekretari i përgjithshëm i Asamblesë për Botimin dhe Publikimin e Kur'anit “Mbreti Fahd” në Arabinë Saudite, Muhamed bin Salim Shedid Al-Aufi ka njoftuar për mbledhjen e Kur'anëve elektronikë që kanë gabime teknike në tërë shtetin e Arabisë Saudite. Ai ka thënë se ky institucion do të marrë vendimin për mbledhjen e Kur'anëve të publikuar në mënyrë elektronike në këtë vend, të cilët kanë gabime teknike. Përgjegjësia për mbledhjen e këtyre kur'anëve është e Ministrisë së Kulturës dhe të Informacionit të Arabisë Saudite, ndërsa organet kompetente të doganës të këtij vendi janë përgjegjëse për ndalimin e hyrjes së këtyre Kur'anëve në vend. Asambleja për Publikim dhe Botimin e Kur'anit “Mbreti Fahd” në Medine ka një program të veçantë për të zëvendësuar këto programe kompjuterike që kanë gabime.



Summaries

Yassin T. al – XHIBURI

Qur'an, the Greatest Miracle

Most Muslim scholars are of the view that the Holy Qur'an in its entirety, in the orders, rules and regulations it contains, in its sequence and the way it is organized, in its wisdom, eloquence and its clarity, the Shari'ah it contains, in the information for the imperceptible and other considerations is, indeed, a miracle. The mankind can never make a similar one. There is much evidence and many aspects of the miraculous nature of the Holy Qur'an, embodied in the Book itself.

Such a miraculous aspect is its logic and eloquence. It talks about the invisible and the imperceptible, legal miracle, scientific miracles in their various forms - medical, space and cosmic, geographical, physical, numerical, informative and many others.

Qur'an is a Unique Book

Qur'an is not a "religious" book, as it is usually implied by this word. Even when the reader takes up the Qur'an, thinking of it as a common book, he is amazed by the style and manner of presentation. He notices that in many places, there are not mentioned additional data, nor the circumstances in which



a particular passage is proclaimed. Thus, the ordinary reader is not able to fully benefit from the precious treasures contained in the Qur'an. The reader will get rid of all these difficulties if we make it known to them in advance. It is the only book of its kind in the whole world. Its literary style is quite different from that of the other books. Only then, the reader can understand it.

Abduldaem Al – Kahiil

Magnificent Scientific Arguments in the History of Prophet Noah

Qur'an is not like any other book. People draw lessons from it. One of these lessons is: As Allah Almighty saved Noah and his faithful people, He, the Almighty will save all believers without exception. Allah says: **“And then, we save our messengers and those who believed. It is our duty, to save the believers.”** (Yunus, 103)

For many years, people have tried to reveal the mechanism of raining. It is discovered the secret of rain: the atoms of water vapors from the oceans and seas that rise to great heights, where the temperature is around zero degrees Celsius, which condenses to form clouds and then the rains. At the time when the Qur'an descended, nobody knew the reality. In the history of Prophet Noah there are many arguments. The Heaven is a testimony for the infinite power of Allah. The Prophet Noah used a scientific technique to invite his people believe in God, when he ordered them to survey the skies, the moon and the sun. Allah says: **“Don't you see how Allah has created seven heavens one over the other? (Don't you see that Allah) has made the Moon light and the Sun a bulb?”** (Noah, 15-16) Today's science has proven that the Moon reflects sunlight because it is not able to shine like the Sun, which has the ability to shine because of its prodigious heat and its inner nuclear eruption.



Dr. M. Nurbaki

Delicate Equilibrium of Life on Earth

"We have spread out the Earth and we have established strong, motionless mountains on it and everything we have produced there is in a harmonious equilibrium". (Al-Hijr, 9). There should exist a computer of Allah that might determine the amount of plants needed for the absorption of the chimneys smoke and the production of enough oxygen that is consumed by people and for providing the necessary oxygen in the air. This incredible calculation belongs only to Allah. The Qur'an declares: *"What is created on the Earth, has been subjected to a precise equilibrium."* This message of knowledge has come to us since 14 centuries ago, when none of these facts were known.

Prof. Hani Al-Mubarak

Dr. Abu Halil Sheuki

Astronomy

Ancient Arabs, who lived in the areas of Mesopotamia (the rivers Tigris and Euphrates) and the River Nile, are among the most ancient peoples, which were popularized with cosmic knowledge. The Indians and the Greeks got the knowledge from them. Will Durant says: *"Astronomy was the science through which the Babylonians were distinguished and were popularized throughout the old world."* However, the Babylonians studied the goal and were interested in it, to become astrologers, in order to predict the future through the movement of stars. As a result of their studies, experiences and observations, they reached a lot of astronomical cognition. So that, since 2000 years BC they have exactly marked the rise and the decline of the morning star in relation to the Sun. They defined the positions of many stars. Babylonians were the first who clearly distinguished the static stars from the mobile ones. They defined the date of the Tropic of Caprice (winter) and the Tropic of Cancer (summer) and vernal and autumnal equinoxes. They divided the year into 12 months.



Dr. Hussein Riduan Al-Lubaidy

The Structure of the Brain According to the Noble Qur'an

The world has not been conscious of anything related to the complete and the complex structure of the brain. Recently they have begun to study the human brain areas responsible for hearing, seeing, senses and for determination. This has happened more than a thousand years after the death of the Prophet (peace and blessings be upon him!). There are areas in the human brain related to the emotions and senses. He listens and understands what he can hear and acts or operates. He uses the power of seeing and understands what he sees and acts. Hearing and vision are guided or orientated through this action. This profound understanding does not exist in the advanced machines that are held with great input and output potentials, incoming and outgoing records and data. Although these machines are sophisticated, they still remain lifeless bodies deprived of emotions, feelings and responsibilities.

Muhsin Kara'ati

Social Justice in Islam

Islam is an institution of justice and moderation. Islam is the right way and the Muslim Brotherhood is the place to practice moderation and justice. Islamic system is based on righteousness. Establishment of justice is something natural. God has endowed man with the right knowledge and wrong things and their resulting outcomes. In the Holy Qur'an it is said:

"And taught them which are his right and bad things. And, has succeeded he who purified himself, or has failed he who humiliated himself."

(Ash-Shams, 8-10)



Prof. dr. Arqile Boti

The Month of Blessings, the Month of Health

Although fasting has not been a particular and set norm only for Muslim believers, but for believers of all faiths throughout the books of God. The forms, ways and fasting time were different in different periods of religious history. With the descent of the Holy Qur'an, God defined and sealed the form of complete fasting for all believers. This is because the Qur'an encompasses and summarizes all the previous Books.

The Rain of Mercy and Compassion

In the Holy Qur'an knowledge, guidance and compassion of Allah come to man thanks to his devotion and piety.

Our devotion and piety is our fruit throughout the year. This product may be threatened by dangers as vice, adornments and trappings of life, lust and various sins. Use the accumulated piety to combat these risks.

After the invitation for fasting, the Holy Qur'an presents the devotion and piety as its main goal, and says: **"O you who believed, fasting (Sawm) is an obligation for you, as it was an obligation to those before you, so that you will become devotional."** (Baqarah, 183)

Pious people are like the strong trees that grow among the rocks in the heart of the mountains and deserts, whose branches resist the powerful droughts, the scorching sun and the winter cold. Even fasting strengthens the soul of man. Experiencing of hunger and thirst and the renunciation of the pleasures for a certain time, give the man the power to resist and endure the hardships in life.

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2011



ملخصات

القرآن أعظم معجزة

ياسين ت. الجبوري

معظم العلماء المسلمين يرون أن القرآن الكريم معجزة بمجمله، في الأوامر والقواعد التي يتضمنها، في تسلسله وتنظيمه، في حكمته و في بلاغته و وضوحه، والشريعة التي يحتويها، في إخباره عن الغيب وغيرها من الاعتبارات، إنه في الواقع معجزة و إن البشرية لا يمكن أن تأتي بشيء مماثل. هناك أدلة و جوانب كثيرة من طبيعة القرآن الكريم الإعجازية التي تتجسد في هذا الكتاب، فأحد جوانبه الإعجازية منطقته وبلاغته. إنه يتحدث عن الغيب، و المعجزة التشريعية، و المعجزات العلمية بأشكالها المختلفة كالمعجزة الطبية، والفضائية، والجغرافية، والفيزيائية، و العددية، و الإخبارية، و معجزات أخرى كثيرة.

القرآن الكريم هو كتاب فريد من نوعه

القرآن ليس كتاباً دينياً كما نفهم عادةً هذه الكلمة. حتى عندما يتناول القارئ القرآن بيده معتقداً إياه كتاباً عادياً، فإنه يندش من أسلوبه وطريقة الإيداع فيه و يرى أنه في كثير من الأماكن لا تُذكر بيانات إضافية، و لا الظروف التي كانت سبباً لنزول آياتٍ معينة. وبالتالي، فإن القارئ العادي غير قادر على الاستفادة الكاملة من الكنوز الثمينة الواردة في القرآن الكريم، إنما يتمّ تخليص القارئ من كل هذه الصعوبات فقط إذا كانت معلومة لديه من قبل. إنه الكتاب الوحيد من نوعه في العالم؛ أسلوبه الأدبي مختلفٌ تماماً عن غيره من الكتب. ثم وبعد ذلك فقط، يمكن للقارئ فهمه.

أدلة علمية رائعة في قصة النبي نوح

عبدالدائم الكحيل

القرآن الكريم ليس كأى كتاب آخر. يستخلص الناس منه دروساً و إحدى هذه الدروس: كما أنقذ الله سبحانه وتعالى نوح وقومه المؤمنين، فإنه تعالى سوف ينجي جميع المؤمنين دون استثناء. قال الله تعالى: **ثُمَّ نُنَجِّي رُسُلَنَا وَالَّذِينَ ءَامَنُوا كَذَلِكَ حَقًّا عَلَيْنَا نَجِ الْمُؤْمِنِينَ** (سورة يونس،

(103)

قد حاول الناس لسنوات عديدة أن يكشفوا آلية سقوط المطر. و قد اكتشف سر الأمطار: ترتفع ذرات بخار الماء من البحار و المحيطات إلى مستويات علوٍ كبيرة، حيث تكون درجة الحرارة حوالي الصفر، و تتكثف هذه الذرات لتُشكّل الغيوم ومن ثم المطر. لكن أثناء نزول القرآن لم يكن يعرف هذه الحقيقة أحد. في قصة النبي نوح عليه السلام حُجِّجَ كثيرة. السماء هي شهادة و برهان على قدرة الله اللامتناهية. قد استخدم النبي نوح تقنيّة علمية لدعوة قومه إلى الإيمان بالله، و ذلك عندما أمرتهم أن ينظروا إلى السماء، و القمر و الشمس.





قال الله تعالى: أَلَمْ تَرَوْا كَيْفَ خَلَقَ اللَّهُ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا ﴿١٥﴾ وَجَعَلَ الْقَمَرَ فِيهِنَّ نُورًا وَجَعَلَ

الْشَّمْسَ سِرَاجًا ﴿١٦﴾ (سورة نوح، 15-16) ولقد أثبت العلم اليوم أن القمر يعكس ضوء الشمس لعدم قدرته المضئ مثل الشمس، و الشمس هي التي لديها قدرة الإضاءة بسبب حرارتها الداخلية الهائلة والانفجار النووي الداخلي.

التوازن الدقيق للحياة على الأرض

الدكتور م. نورباقي

وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ مَوْزُونٍ ﴿١٩﴾ (سورة الحجر، 19)

يُفَضِّلُ أن يكون هناك جهاز كمبيوتر لله قادر أن يحدد كمية النباتات اللازمة لامتصاص دخان المداخن وأن ينتج الأوكسجين الذي تستهلكه الإنسانية و أن يوفر الأوكسجين الضروري في الهواء. فهذه العملية الحسابية الدقيقة والعجيبة لله وحده. القرآن يعلن أن ما خُلق على وجه الأرض يخضع لتحقيق توازنٍ صحيحٍ ومناسبٍ. هذه الرسالة العلمية تأتينا من قبل 14 قرناً، عندما لم يكن يُعرف أي من هذه الحقائق.

علم الفلك

الأستاذ هاني المبارك و د. شوقي أبو خليل

العرب القدماء الذين عاشوا في مناطق البلاد ما بين النهرين (دجلة والفرات) ونهر النيل هم من بين معظم الشعوب القديمة التي شاعت بينهم المعارف الكونية. ثم أخذ الهنود واليونانيون تلك المعارف منهم. يقول ول ديورانت: "علم الفلك هو العلم الذي تميّز به البابليون واشتهروا به في جميع أنحاء العالم القديم." ومع ذلك، درس البابليون هدفه ونطاقه وتطلعوا إلى أن يصبحوا مُنجمين لأجل التنبؤ بالمستقبل من خلال حركة النجوم. فنتيجة للخبرات والدراسات والملاحظات إنهم وصلوا إلى معارف فلكية عديدة. لذلك، فإنهم سجلوا بالضبط شروق وغروب نجمة الصباح مقارنةً إلى الشمس من 2000 عام قبل الميلاد و حددوا مواقف العديد من النجوم. كان البابليون أول من ميّز بوضوح بين النجوم المتنقلة والنجوم الثابتة، و حددوا تاريخ مدار الجدي (الشتاء) ومدار السرطان (الصيف) و تاريخ تساوي الليل والنهار في فصلي الربيع والخريف و قسّموا السنة إلى 12 شهراً.

بناء الدماغ في ضوء القرآن الكريم

الدكتور حسين رضوان الليبيدي

كان العالم لا يعرف أي شيء ذات الصلة ببناء الدماغ الكامل والمعقد، و قد بدأ مؤخراً دراسة مناطق المخ البشري المسؤولة عن السمع والرؤية والشعور والتصميم. وقد حدث هذا أكثر من ألف سنة بعد وفاة النبي (صلى الله عليه وعلى آله وسلم). ففي الدماغ مناطق مرتبطة بالعواطف والأحاسيس. إنه يسمع ويفهم ما يسمع و يفعل، و إنه يرى ويفهم ما يرى ويفعل. يسترشد السمع والبصر من خلال هذه العملية، و هذا الفهم العميق ليس موجدًا في الآلات المتطورة التي تم عقدها مع امكانيات كبيرة و مدخلات و مخرجات الإنتاج، و

البيانات الصادر والوارد. و على الرغم من أن هذه الآلات منطوقة، فهي لا تزال جثث هامدة محرومة من العواطف والشعور بالمسؤولية.

العدالة الاجتماعية في القرآن

محسن قراءتي

الإسلام هو مؤسسة العدل والاعتدال. الإسلام هو الطريق الصحيح والأخوة الإسلامية هي المكان المناسب لممارسة الاعتدال والعدالة. فالنظام الإسلامي يقوم على العدل وإقامة العدل ميزة طبيعية له. وقد جهز الله الإنسان بمعرفة الأمور صحيحها وخطئها وهي تقوم بنتائجها. يقول الله تعالى في القرآن الكريم: **فَالْهَمُّهَا جُورُهَا وَتَقْوَاهَا ۖ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ رَكَّهَا ۝** وَقَدْ حَآبَ مَنْ دَسَّهَا (سورة الشمس، 8-10)

شهر البركة - شهر الصحة

الأستاذ الدكتور أركله بوتى

على الرغم من أن الصيام لم يُفرض للمؤمنين المسلمين فقط، بل للمؤمنين من جميع الأديان وجميع كتب الله المنزلة، فإن أشكال وتوقيت الصيام قد يختلف في فترات مختلفة من تاريخ الأديان. فمع نزول القرآن قد ختم الله فريضة الصوم بشكله الكامل لجميع المؤمنين، وهذا لأن القرآن الكريم يشمل جميع الكتب السماوية السابقة.

أمطار الرحمة

www.albanian.trib.ir

يُذكر في القرآن أن المعرفة والهداية والرحمة تأتي إلى الإنسان بفضل تقواه. فالتقوى هي ثمرتنا على مدار السنة، وقد تكون هذه الثمرة مهددة بمخاطر كالوسواس، ومغريات الحياة، والشهوات والخطايا المختلفة. فعلى أن نستخدم التقوى المتراكمة لمكافحة هذه المخاطر.

يعرض القرآن التقوى بعد الدعوة إلى الصيام وكهدف رئيسي لها، حيث يقول الله تعالى: **يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ**

ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ (سورة

البقرة، 183)

فأهل التقوى كالأشجار القوية التي تنمو بين الصخور في قلب الجبال والصحارى، وأغصانها هي التي تقاوم الطوفان القوية، وحريق الشمس وبرد الشتاء. كذلك الصيام، إنه يقوي روح الإنسان. وتجربة الجوع والعطش والتخلي عن المتع لفترة زمنية معينة، تُعطي للإنسان القوة لمقاومة ومواجهة الصعوبات.



نور قرآن

فصلنامه علمی قرآنی

صاحب امتیاز: مؤسسه قرآن کریم آلبانی

مدیر مسئول: محمد رضا حاج خضر

سرمدیر: پروفسور دکتر خیری شهو

اعضای هیئت تحریریه:

پروفسور دکتر بدری بولوکو

پروفسور دکتر فتحی مهدیو — استاد دانشگاه پریشتینا (کوزوو)

حاج افندی سلیمان رجبی — رئیس مشیخه اسلامی کشور مقدونیه

حاج سلیم اصطفی

حاج یتمیر چیلا

شیخ ولنت مریا

ویرایش ادبی: خانم لیسیدا رامای

صفحه آرایی: فتمیر شوتینا

شماره 2011/3 (17)



KUJTESE PËR AUTORET

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

- Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.
- Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.
- Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave ë dhe ç me e dhe c.
- Të mos përdoret shkronja e madhe I aty ku nuk duhet.
- Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.
- Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.
- Referencat në tekst të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull citimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.
- Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dorëzohet në CD, USB ose të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail): (f_quran114@yahoo.com).
- Shkrimi nuk duhet të jetë botuar askund tjetër.
- Shkrimi nënshkruhet nga autori dhe jepet adresa e plotë, numri i telefonit dhe e-maili.

